

***“TITULLI”***

**Perdorimi i burimeve natyrore te reja per perfitimin e gurit qelqeror  
per nevojat e sektorit te ndertimit dhe infrastruktures eshte domosdoshmeri  
dhe prioritet per ruajtjen e ambientit**

**Pergatitur nga**

**“QENDRA PER KERKIM DHE ZHVILLIM, TIRANE”**

**Me mbeshtetje financiare nga  
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave**

Tirane, 30.10.2006

## **Rreth autorit**

### **Grupi kryesor i punës:**

Mirlinda Rusi - (Drejtoresha e Projektit) Drejtoresha ekzekutive, QKZH Tiranë, Abedin Xhomo - ekspert, Silvana Rusi – eksperte.

### **Qendra për Kërkim dhe Zhvillim**

QKZH, Tiranë është organizatë jo fitimprurëse e regjistruar në Gjykatën e Tiranës në mars të vitit 2001. Qëllimi i QKZH është të mbledhë, përpunojë dhe analizojë të dhëna mbi ecurinë e sektorit privat dhe publik. Ajo ka si objektive të ndihmojë institucionet publike dhe komunitetin e biznesit në hartimin e politikave të drejta për zhvillimin e biznesit dhe përmirësimin e menaxhimit të buxhetit.

### **Adresa:**

Qendra për Kërkim dhe Zhvillim  
Rr. Luigj Gurakuqi P.15/1, Sh.1, Ap.1  
Tiranë, Shqipëri

### **Adresa postale:**

QKZH  
P.O.Box: 218/1  
Tiranë

Tel&Fax: +355 4 230445

Internet: [www.qkzh.org](http://www.qkzh.org)

E-mail: [info@qkzh.org](mailto:info@qkzh.org)

Permbajtja e lendes  
Lista e tabelave  
Lista e figurave  
Anekse

## **Kapitulli I: Qellimi, objektivat dhe metodologjia e studimit**

- 1.1 Hyrje
- 1.2 Qellimi dhe objektivat
- 1.3 Metoda e punes

## **Kapitulli i II: Karakteristikat e shkembinjve karbonat**

- 2.1 Shkembinjte karbonate perdorimi i tyre ne sektorin e ndertimit
- 2.2 Shfrytezimi i shkembinjve karbonatike dhe ndikimi ne perkeqesimin e situates ekologjike, ambientit dhe prishjen e bukurise natyrore.

## **Kapitulli III: Baseni Drin-Bunes**

- 3.1 Karakteristikat gjeografike dhe gjeomorfologjike te lumenjve te basenit
- 3.2 Perberja granulometrike dhe litologjike e inerteve
- 3.2 Vendburimet, objektet dhe sheshet e inerteve qe shfrytezohen
- 3.3 Vendburimet, objektet dhe sheshet e inerteve qe shfrytezohen nga subjektet
- 3.4 Rezervat dhe kapacitetet e shfrytezimit te inerteve nga subjektet
- 3.5 Impakti mjedisor nga shfrytezimi i inerteve
- 3.6 Vendburimet e shkembinjve karbonate dhe rezervat
- 3.7 Subjektet qe shfrytezojne shkembinjte karbonate
- 3.8 Permbledhje dhe rekomandime

## **Kapitulli IV: Baseni i Matit**

- 4.1 Karakteristikat gjeografike dhe gjeomorfologjike te inerteve
- 4.2 Perberja granulometrike dhe litologjike e inerteve
- 4.3 Vendburimet, objektet dhe sheshet e inerteve qe shfrytezohen nga subjektet
- 4.4 Rezervat dhe kapacitetet e shfrytezimit te inerteve nga subjektet
- 4.5 Impakti mjedisor nga shfrytezimi i inerteve
- 4.6 Vendburimet, objektet e shkembinjve karbonate dhe rezervat
- 4.7 Subjektet qe shfrytezojne shkembinjte karbonate
- 4.8 Permbledhje dhe rekomandime

## **Kapitulli V: Baseni i Ishem-Erzenit**

- 5.1 Karakteristikat gjeografike dhe gjeomorfologjike te lumenjve te basenit
- 5.2 Perberja granulometrike dhe litologjike e inerteve
- 5.3 Vendburimet, objektet dhe sheshet e inerteve qe shfrytezohen nga subjektet

- 5.4 Rezervat dhe kapacitet e shfrytezimit te inerteve nga subjektet
- 5.5 Impakti mjedisor nga shfrytezimi i inerteve
- 5.6 Vendburimet e shkembinjve karbonate dhe rezervat
- 5.7 Subjektet qe shfrytezojne shkembinjte karbonate
- 5.8 Permbledhje dhe rekomandime

## **Kapitulli VI: Baseni i Shkumbinit**

- 6.1 Karakteristikat gjeografike dhe gjeomorfologjike te lumenjve te basenit
- 6.2 Perberja granulometrike dhe litologjike e inerteve
- 6.3 Vendburimet, objektet dhe sheshet e inerteve qe shfrytezohen nga subjektet
- 6.4 Rezervat dhe kapacitetet e shfrytezimit te inerteve nga subjektet
- 6.5 Impakti mjedisor nga shfrytezimi i inerteve
- 6.6 Vendburimet e shkembinjve karbonate dhe rezervat
- 6.7 Subjektet qe shfrytezojne shkembinjte karbonate
- 6.8 Permbledhje dhe rekomandime

## **Kapitulli VII: Baseni i Vjoses**

- 7.1 Karakteristikat gjeografike dhe gjeomorfologjike te lumenjve te basenit
- 7.2 Perberja granulometrike dhe litologjike e inerteve
- 7.3 Vendburimet, objektet dhe sheshet e inerteve qe shfrytezohen nga subjektet
- 7.4 Rezervat dhe kapacitetet e shfrytezimit te inerteve nga subjektet
- 7.5 Impakti mjedisor nga shfrytezimi i inerteve
- 7.6 Vendburimet e objektet e shkembinjve karbonate dhe rezervat
- 7.7 Subjektet qe shfrytezojne shkembinjte karbonate
- 7.8 Permbledhje dhe rekomandime

## **Kapitulli VIII: Baseni i Semanit**

- 8.1 Karakteristikat gjeografike dhe gjeomorfologjike te lumenjve te basenit
- 8.2 Vendburimet, objektet dhe sheshet e inerteve qe shfrytezohen nga subjektet
- 8.3 Rezervat dhe kapacitetet e shfrytezimit te inerteve nga subjektet
- 8.4 Impakti mjedisor nga shfrytezimi i inerteve
- 8.5 Vendburimet e objektet e shkembinjve karbonatike dhe rezervat
- 8.6 Subjektet qe shfrytezojne shkembinjte karbonate
- 8.7 Permbledhje dhe rekomandime

## **Kapitulli IX: Legjislacioni dhe vizioni ekonomik**

- 9.1 Legjislacioni shqiptar dhe identifikimi i boshlleqeve
- 9.2 Rekomandime ligjore institucionale
- 9.3 Percaktimi i pikave te karrierave te gelqeroreve

## **Lista e tabelave**

Tabela 1: Perberja minerale e shkembinjve karbonate

Tabela 2: Klasifikimi i gelqeroreve sipas karakteristikave fizike (sipas ASTM 1992)

Tabela 3: Kapacitet e subjekteve qe shfrytezojne inertet ne basenin e Drin - Bunes

Tabela 4: Vendburimet dhe objektet e shkembinjve karbonate ne basenin e Drin - Bunes

Tabela 5: Subjektet qe shfrytezojne me kariera shkembinjte karbonate ne basenin e Drin - Bunes

Tabela 6: Rezervat gjeologjike te inerteve lumore ne basenin eMatit

Tabela 7: Kapacitet e subjekteve qe shfrytezojne inerte ne basenin e Matitit

Tabela 8: Vendburimet e gelqeroreve ne basenin e Matit

Tabela 9: Vendburimet dhe objektet e shkembinjve karbonate ne basenin e Ishem – Erzenit

Tabela 10: Subjektet qe shfrytezojne me kariera shkembinjte karbonate ne basenin e Ishem Erzenit

Tabela 11: Rezervat gjeologjike te inerteve lumore ne basenit te Shkumbinit

Tabela 12: Kapacitet e subjekteve qe shfrytezojne inerteve lumore në basenin e Shkumbinit

Tabela 13: Vendburimet dhe objektet e shkembinjve karbonate ne basenit të Shkumbinit

Tabela 14: Subjektet qe shfrytezojne me karriera shkembinjte karbonate ne basenin e Shkumbinit

Tabela 15: Rezervat gjeologjike të inerteve lumore në basenin e Vjosës

Tabela 16: Kapacitetet e subjekteve që shfrytezojnë inerte në basenin e Vjosës

Tabela 17: Vendburimet dhe objektet e shkembinjve karbonate në luginën e Vjosës

Tabela 18: Subjektet qe shfrytezojne me karriera shkembinjte karbonate ne rrethin e Vlores

Tabela 19: Subjektet qe shfrytezojne me karriera shkembinjte karbonate ne rrethin e Gjirokastrës

Tabela 20: Subjektet qe shfrytezojne me karriera shkembinjte karbonate ne rrethin e Sarandes

Tabela 21: Subjektet qe shfrytezojne me karriera shkembinjte karbonate ne rrethet e Tepelenës dhe Ersekës

Tabela 22: Rezervat gjeologjike te inerteve lumore në basenin e Semanit

Tabela 23: Kapacitetet e subjekteve që shfrytezojnë inerte lumore në basenin e Semanit

Tabela 24: Vendburimet dhe objektet e shkembinjve karbonate në basenin e Semanit

Tabela 25: Subjektet qe shfrytezojne me karriera shkembinjte karbonate ne rrethet e Beratit dhe Kuçoves

Tabela 26: Subjektet qe shfrytezojne me karriera shkembinjte karbonate ne rrethet e Ballshit, Gramshit dhe Skraparit

Tabela 27: Subjektet qe shfrytezojne me karriera shkembinjte karbonate ne rrethin e Pogradecit

Tabela 28: Subjektet qe shfrytezojne me karriera shkembinjte karbonate ne rrethin e Korçës

# **Kapitulli i I**

## **QELLIMI, OBJEKTIVAT DHE METODOLLOJIA E STUDIMIT**

## 1.1 Hyrje

Në 15 vitet e fundit sektori i ndërtimit është zhvilluar me ritme më të shpejta në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë, duke ju përgjigjur një kërkesë gjithnjë e më të lartë të publikut për më shumë banesa, si dhe rritjes gjithnjë e më të madhe të investimeve në infrastrukturë. Në këto vite të tranzicionit një nga elementet bazë që është përdorur në ndërtim, sidomos në ndërtimet urbane të banesave, kanë qenë materialet e ndërtimit të nxjerra nga franksionimi i inerteve të shtreterve të lumenjve kryesore të vendit.

Përdorimi gjithnjë e më i madh i këtyre materialeve ka ndodhur në kushtet e një vakumi ligjor, sidomos në fushën e mbrojtjes së ambientit dhe mungesës së zbatimit të ligjit kanë favorizuar shfrytëzimin e karrierave të inerteve buzë lumenjve si burimin me kosto më të ulët të sigurimit të tyre. Aktualisht janë hapur një numër i konsiderueshëm karrierash të licensuara, ndërsa funksionojnë një numër disa herë më i madh karrierash të palicensuara. Kjo masakër që shfaqet në prishjen e bukurive natyrore, ka efekte të përtejshme në përkeqësimin e situatës ekologjike dhe mbrojtjes së ambientit.

Shfrytëzimi pa asnjë kriter i agregatëve të shtretërve të lumenjeve dhe anash tyre është i lidhur ngushtë me një dëm të konsiderueshëm në mjedis, dëme këto të cilat po i rendisim si më poshtë:

- Û Shkatërimi i objekteve inxhinierike industriale dhe bujqesore si pritrat, urat, stacionet e pompimit të ujit etj
- Û Erozioni dhe permytja e tokave bujqesore dhe qendrave të banuara
- Û Shkatërimi i bimeve të kultivuara përgjate shtreterve të lumenjeve apo luginave
- Û Ndotja e ujerave sipërfaqesore dhe atyre nëntokesore si rezultat i depozitimit të plehrave përgjate këtyre lumenjve ( lumi i Tiranës dhe Shkumbinit, etj)

Hapat kryesore, të cilat do ndihmonin në parandalimin e këtyre dëmeve konsistojnë në ndalimin e shfrytëzimit të agregatëve nga lumenjtë pa një projekt teknik, si dhe kalimi gradual nga shfrytëzimi i inerteve lumore në shfrytëzimin e gurit gëlqeror.

Nga ana tjetër edhe përdorimi i gurit gëlqeror për nevoja ndërtimi kondicionohet nga rezervat kushtet ambjentale dhe kosto e shfrytëzimit të tij. Pikërisht ky raport do t'i shërbejë Ministrisë së Mjedisit për të analizuar të gjitha aspektet e mundëshme ligjore institucionale, ambjentale dhe gjeologjike për të mundësuar, detyruar apo krijuar iniciativat e mundshme fiskale, që ndërtuesit të shfrytëzojnë gurin gëlqeror për ndërtim, duke prenuar kështu përdorimin e shtreterve të lumenjve.

Në këtë mënyrë do të lehtësohen kushtet për një ruajtje më të mirë të shtretërve të lumenjeve dhe eliminimit të shfaqjeve të korupsionit, për shkak të pamundësisë së ndërtuesve për përdorimin masiv të gurit gëlqeror, për shkak të mungesës së një plani të detajuar institucionalo-ligjor, që do t'i shërbejë këtij qëllimi.

## 1.2 Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i këtij studimi është të përcaktojë instrumenta ligjore dhe institucionale, për të mundësuar që Ministria e Mjedisit të kryejë një politikë proaktive në dobi të biznesit dhe mbrojtjen e mjedisit që vjen nga përdorimi i shtreterve të lumenjeve si baze për të ekstraktuar elemente baze të ndertimit, guri, rera dhe granili. Mosmarrja e masave institucionale dhe ligjore që ndertuesit të kthehen në mënyrë të natyrshme në përdorimin e gurit gelqeror si materiale baze ndertimi do të çojë në një degradim të mëtejshëm të shtreterve të lumenjeve për shkak të pamundësisë për të rritur shkallën e kontrollit/ rrepsionit të firmave që përdorin inertet e lumenjeve për shkak të kërkesës gjithnjë në rritje për materiale ndertimi.

Për të realizuar këto qëllime, projekti do të ketë këto objektiva:

- 1) Evidentimin sa më të saktë të gjithë punës studimore që është kryer deri tani në drejtim të përdorimit të rezervave gjeologjike për gurin gelqeror.
- 2) Evidentimin e saktë të rezervave gjeologjike të gurit gelqeror, vendndodhja e tyre dhe kushtet e shfrytëzimit.
- 3) Përcaktimin e vëllimeve kryesore të materialeve të ndertimit në projekte deri 5 vjeçare, si dhe përcaktimin e kostove të përafërta për përdorimin e tyre nga ndertuesit.
- 4) Përcaktimin e lehtësive fiskale që mund t'ju bëhen ndertuesve që përdorin materiale ndertimore nga guri gelqeror.
- 5) Përcaktimin e nderhyrjeve ligjore dhe institucionale që duhet të realizohen për përdorimin e karrierave të gurit geleqeror.
- 6) Përcaktim i përfarët krahasimor të demtimeve ambientale nga përdorimi i karrierave të hapura të gurit gelqeror.

## 1.4 Metoda e punës

Studimi u realizua në dy faza.

Në *fazën e parë*, u bë një vlerësim i të gjitha materialeve studimore të kryera nga institucionet publike në lidhje me shkallën e demtimit dhe përdorimit të shtreterve të lumenjeve si material ndertimi, si dhe materialet gjeologjike që përcaktojnë shpërndarjen e mineralit të gurit gelqeror. Po në këtë fazë u krye një vlerësim në terren i situatës për burimet me të rëndësishme të gurit geleqeror, duke vlerësuar në mënyrë kushtet e infrastrukturës dhe lidhjes me zonat urbane.

Për këto qëllime po bashkëpunohet me të gjitha institucionet publike dhe gjysem publike si, Ministria e Ekologjisë, Industrisë dhe Energjitikës, Sherbimin Gjeologjik Shqiptar, Shoqatën e Ndertuesve etj.

Studimet empirike të kryera nga sherbimi gjeologjik shqiptar dhe punime të gjeologeve të vecante deshmuan për ekzistencën e rezervave qindra vjeçare të gurit gelqeror. Mbeshtetur në studimet e kryera në fushën përkatëse ky studim paraqet një inventar të plotë të depozitave të inerteve të gurit (gelqeroret) : vendndodhjen e tyre dhe rezervat përkatëse.



Ne fund te kesaj faze u realizua nje liste e seleksionuar e vendburimeve te gelqeroreve, te cilat paraqesin aset natyrore turistike dhe si te tilla nuk duhen prekur ( nese zgavrat e hapura ne shtratet e lumenjve me kalimin e viteve mund te rigjenerohen, zgavrat qe hapen ne shpatet e maleve turistike nuk mbyllen kurre );

Ne *fazen e dyte* puna vijoi me 3 nengrupe, te cilet analizuan problemin ne aspektin gjeologjik te rezervave dhe vendndodhjes, i cili do te shikoje aspektet e infrastruktures dhe koston e perpunimit dhe transportit, si dhe grupi institucional dhe ligjor, i cili do te perpunojte platformen ligjore dhe institucionale.

*Nengrupi i rezervave gjeologjike* pergatiti listen me vendburime te rekomandueshme per t'u shfrytezuar nga pikpamja e lehtesise se shfrytezimit (largetesia nga rruga, kushtet specifike gjeologjike te shtresave etj.).

*Nengrupi ekonomik* realizoi nje analize standrate te koston dhe te ardhurave qe realizohet nga perdorimi i gurit gelqeror, pa perfshire ketu koston e investimeve qe duhen per hapjen e rruges deri ne karriere. Ne kete kontekst, u krahasuan te dhenat me analizat per koston e ekstradimit te materialeve nga shtresat e brigjeve te lumenjve, duke percaktuar ne kete menyre ndikimin ne rritjen e koston se ndertimit dhe efektet qe do te jape kjo ne oferten e tregut te ndertimeve.

*Nengrupi institucional dhe ligjor* percaktoi nderhyrjet ligjore qe duhet te realizohen per te mundesuar perdorimin e karrerave te gurit gelqeror, si dhe institucionet qe Ministria e Mjedisit duhet te bashkepunoje per realizimin e ketij misioni.

## **Kapitulli i II**

# **KARAKTERISTIKAT E SHKEMBINJVE KARBONATE**

## 2.1 Shkëmbinjtë karbonatë përdorimi i tyre në sektorin e ndërtimit

Rritja e vazhdueshme e sektorit të ndërtimit, si rezultat i kërkesave për zhvillimin e infrastrukurës dhe plotësimin e kërkesave të popullsisë për strehim, në gjithë vendet e zhvilluara, ku rendesi përcësor i kushtohet ruajtjes së ambientit, i ka detyruar me kohë që për sigurimin e materialeve inerte të drejtojnë sytë drejt shfrytëzimit të shkëmbinjve karbonatë e sidomos atyre gelqerorë.

Shkëmbinjtë karbonatë përbëhen kryesisht nga kalciti (gelqerorët)  $\text{CaCO}_3$  dhe dolomite  $\text{Ca, Mg}(\text{CO}_3)_2$ . Në natyrë pothuajse gjithmone kemi të bëjmë me llojet kalimtare të tyre. Në tabelën 1 jepen në mënyrë të përmbledhur përberja minerale dhe kimike e llojeve të ndryshme të shkëmbinjve karbonatë.

Tabela 1: Përberja minerale e shkëmbinjve karbonatë

Emërtimi i shkëmbit	Përberja minerale %		Përberja kimike në %	
	Kalcit	Dolomit	$\text{CaCO}_3$	$\text{MgCO}_3$
Gelqeror	100-195	0-5	100-97.7	0-2.3
Gelqeror dolomit	75-95	5-25	97.7-95.4	2.3-4.6
Gelqeror dolomitik	50-75	25-50	95.4-81.7	4.6-18.3
Dolomit gelqerorik	50-5	50-95	81.7-58.9	18.3-41.1
Dolomit	5-0	95-100	58.9-54.3	41.1-45.7

Përzierje të zakonshme në gelqerorët janë dhe argjilat (5-25%) minerale alumosilikate që përbejnë mbetje të pa tretshme. Si rezultat i rikristalizimit dhe metamorfizmit shkëmbinjtë gelqerorë kalojnë dhe në mermere.

Shkëmbinjtë karbonatë shërbejnë në radhë të parë si lëndë e parë natyrore për ndërtim. Ato kanë një përdorim shumë të gjërë, kanë qëndrueshmëri të madhe dhe mundet të nxirren dhe të përpunohen me një kosto mjaft më të ulët, në krahasim me shkëmbinjtë e tjera magmatike.

Shkëmbinjtë karbonatë dhe sidomos ata gelqerorë përveç si lëndë e parë natyrore për prodhimin e inerteve, përdoren dhe për prodhimin e çimentos dhe gelqerës. Përdorim më të kufizuar shkëmbinjtë karbonatë kanë në industrinë kimike për prodhimin e sodës, qelqit, prodhimin e sheqerit, industrinë e letres, në bujqësi etj.

Gelqerorët dhe përberësit e tyre të këtij grupi, si material ndërtimi në gjendje natyrore përdoren në keto forma:

- Gurë në formë copash për themele, mure, veshje, ndërtime arkitektonike, ndërtime hidroteknike dhe rrugore, etj.

- Gurë në formë çakelli (i copëtuar me permasa të ndryshme) për beton të zakonshëm, ndërtime hidroteknike e rrugore, për mbushjen e traseve të hekurudhave dhe për Qellime të tjera.

- Gurë në formë therimesh, pluhuri, mielli, pudre për përgatitjen e materialeve tëndryshme të ndërtimit dhe arkitekture të jashtme e të brendshme

Për vlerësimin e shkëmbinjve karbonatë rendesi të madhe kanë karakteristikat e tyre fizike të dhëna në tabelën 2, sipas "American Society for Testing and Materials".

Tabela 2: **Klasifikimi i gelqeroreve sipas karakteristikave fizike (sipas ASTM 1992)**

Tipet gelqerore	Densiteti gr/cm <sup>3</sup>	Rezistenca ne shtypje kg/cm <sup>2</sup>	Module elasticiteti kg/cm <sup>2</sup>	Kofecienti I absorbimit
Gjysem qendrueshem	1.76-2.16	>126.3	>28	<12
qendrueshem	2.16-2.56	>281	>35	<7.5
I forte	>2.56	>562	>70	<3
Mermer (kalcit)	>2.6	>1335	>70	<0.75
Mermer (dolomit)	2.8	>1335	>70	<0.75

Shkembijnjte karbonate takohen ne te gjitha basenet ujore te vendit tone. Ata mbulojne siperfaqe te konsiderueshme sidomos ne basenin ujqor te Vjoses (70-75% te siperfaqes se tij) dhe ne basenin ujqor te Drinit (30-35% te siperfaqes se tij). Keta shkembijnj marrin pjese ne ndertimin e shume vargjeve malore ne Shqiperine e mesme e jugore si dhe zonat malore te Alpeve Shqiptare, Pashtrikut, Gjallices, Lures, etj.. Perhapje me te vogel shkembijnjte karbonate kane ne zonen bregdetare (Ultesiren Praneadriatike).

Ne pergjithesi te gjitha shkembijnjte karbonate te Triasikut te siperem, Jurasikut, Kretakut dhe Paleocen-Eocenit ndertohen kryesisht nga gelqerore e dolomite me trashesira te medha (1000-1500 m) vende- vende me paketa relativisht te holla te shkembijnjve silicore ose mergelore.

Shkembijnjte karbonate te Permianit dhe ata te Triasikut te poshtem e te mesem formojne pako me trashesi te konsiderueshme, por nderthuren me paketa shkembijnjsh neogjenike te Ultesires Praneadriatike dhe gropen e Korçes, takohen pako gelqerorësh litotamnike, ne pergjithesi pak argjilore, te nderthurur me sedimente te tjere terrigjene. Sigurisht, qe keta gelqerore jane te nje cilesie pak me te ulet. Shkembijnjte karbonate perbejne nje baze te fuqishme per plotesimin e te gjitha nevojave te sektorit te ndertimit me lendet e para.

Gelqeroret kane prioritet ne ndertim ne vendin tone edhe mbi shkembijnjte e tjere, si magmatike e metamorfike sepse:

- a. Kane qendrueshmeri me te mire, qe provohet çdo dite edhe ne qendrueshmerine e veprave te lashta arkeologjike.
- b. Punohen me lehte se shkembijnjte e tjere per te marre format e deshuruara.

Perdorimi i shkembijnjve karbonate si lende ndertimi eshte nje problem i njohur dhe i zgjidhur. Vetite kryesore qe e justifikojne kete jane:

**Rezistenca e madhe ne shtypje.** Ne pergjithesi pranohet qe ne kete fushe ajo duhet te jete **200-1500kg/cm<sup>2</sup>**

Rezistencen ne shtypje shkembijnjte karbonate triasike te Malit te Thate, Qafe Thanës, Gjurasit, Kovashices, Ostrenit, Kolesianit, Komanit, Qafe Shtames, Derstiles, Mesit, Cekajt, Taraboshit, etj. E kane 887-2080kg/cm<sup>2</sup> Gelqeroret e Jurasikut-Kretakut te sektorit te Lezhes (Spiten, Tresh, manati, etj.) 1100-1600kg/cm<sup>2</sup> Gelqerore e Kretakut te zones se Krujes

(Milot, Lezhe, Mamurras, Krujes, Dajtit, etj.) 1100kg/cm<sup>2</sup>. Gelqeroret e mbuleses kretake te zones Mirdita (Burgajet, Lis, Mali i Shejte, Mali i Polisit, Polene, Vithkuq, etj.) 800-1040kg/cm<sup>2</sup>. Gelqeroret Paleocenik-Eocenike te zones Jonike (m. i Dajtit, m. i Tomorit, Zhitom, Drashovice, Jergucat etj.) 980-1470kg/cm<sup>2</sup>. Gelqeroret litotamnike ne Ferraj 216-1274kg/cm<sup>2</sup>.

**Qendrushmeri ndaj ngricave shume te larte.** Te gjithë shkëmbinjtë karbonatike të vendit tone kanë një koeficient thithje shume të vogël (0.1-0.2%) dhe dendësi mbi 2.6 gr/cm<sup>2</sup>. Me këto karakteristika kontrolli për qendrushmerinë ndaj ngricave nuk është i nevojshëm.

**Moduli i elasticitetit** i gelqeroreve është mbi 70kg/cm<sup>2</sup>, kurse **koeficienti i absorbimit** gjithmone është me i vogël se 3.

Sipas karakteristikave fizike, të përmendura në bazë të klasifikimit (tabela 2) gjithë shkëmbinjtë karbonate futen në grupin e shkëmbinjve gelqerorë të fortë. Të gjitha këto çilesi i kanë bërë shkëmbinjtë karbonate si një lëndë e parë për ndërtim të pazvendësueshëm nga shkëmbinjtë e tjerë.

Këto vitet e fundit edhe në vendin tone vihet re tendenca e disa firmave për përdorimin e shkëmbinjve gelqerorë në formë guresh, çakelli, mbushës në përgatitjen e betonit, si dhe në formë grimcash e pluhuri duke zëvendësuar në këto mënyrë zhavorret e rerrat e lumenjve.

## **2.2 Shfrytëzimi i shkëmbinjve karbonatike dhe ndikimi në përkeqësimin e situatës ekologjike, ambientit dhe prishjen e bukurisë natyrore.**

Shfrytëzimi i shkëmbinjve karbonatike si lëndë e parë për ndërtim, në mënyrë sporadike është bërë që në kohët e lashta. Punimet gjeologjike për kërkimin dhe shfrytëzimin e vendburimeve dhe objekteve të gelqeroreve, për nevojat e ndërtimit, në mënyrë të organizuar kanë filluar që nga pesëdhjetë vjet, kur u krijua dhe Sherbimi Gjeologjik Shqiptar.

Me kalimin në ekonomine e tregut, zhvillimi me ritme shume të shpejta i sektorit të ndërtimit, si për plotësimin e nevojave të popullsisë për strehim, ashtu edhe për zhvillimin e infrastrukurës u shoqërua me rritjen e kërkesës për lëndë të inerteve, jo vetëm nga shtreterit e lumenjve, por dhe nga shfrytëzimi i shkëmbinjve karbonatike.

Si rezultat i punimeve gjeologjike të kërkim-zbulimit në vendin tone janë zbuluar dhe vlerësuar një numër i madh i vendburimeve dhe objekteve të shkëmbinjve karbonatike. Rezervat e llogaritur nga studimet e kërkimeve gjeologjike deri tani, me gjithë rritjen e kërkesave, mund të plotësojnë nevojat e ndërtimit për një periudhë 60-70 vjeçare.

Është e madhe e shkëmbinjve karbonatike në vendin tone siguron një prognozë të sigurtë për rritjen e këtyre rezervave dhe hapjen e shume karrierave të tjera.

Për të plotësuar kërkesat për lëndë për ndërtim dhe shkëmbinjtë karbonatike, pas vitit 2000, janë liçensuar 452 karriera nga të cilat sot operojnë vetëm 232 subjekte. Për duhet të përmendim se aktualisht një numër shume i madh objektivësh me karriera të vogla, shfrytëzohen, pa leje dhe pa projekte teknike.

Trashësitë e mëdha të prerjeve të shkëmbinjve karbonatike si dhe relievi i përshtatshëm sigurojnë një shfrytëzim relativisht të lehtë me anën e karrierave. Shfrytëzimi me kriterin e shkëmbinjve gelqerorë në përgjithësi nuk ndot ambientin, mbasi 90% e

prodhimit i klasifikuar sipas permasave gjen perdorim dhe nuk perben ndonje ndotje shqetesuese.

Shfrytezimi i karrierave realizohet nga subjekte e persona privat, ne shume raste pa kualifikimin e duhur dhe pa zbatuar projekte dhe programe qe shoqerojne licensat. Shpesh karrierat perfaqesojne vetem gropa ose germime me konture te pa rregullta, pa shkalle pa ju permbajtur sistemit te shfrytezimit te parashikuar ne projekte dhe c'ka eshte shume shqetesuese pa marre asnje mase per rigjenerimin e ambjentit.

Mangesite e permendura me larte per karrierat e licensuara sigurisht qe jane edhe me te theksuara me shfrytezimin e karrierave te vogla, te hapuara pa leje dhe pa respektuar asnje kriter teknik te ruajtjes se ambjentit.

Vendosja e karrierave ne shume raste eshte pa kriter dhe sidomos pa marre pasrasysh situaten ekologjike dhe rregullat per mbrojtjen e ambjentit. Ajo eshte mbeshtetur me shume ne interesat e ngushta te firmave ose personave private te licensuar. Per kete ka influencuar dhe vakumi ligjor ne fushen e mbrojtjes se ambjentit. Shperndarja e tyre sot perben nje shqetesim serioz ne lidhje me prishjen e ekuilibrave natyror dhe densitetin e pamjeve te natyres se vendit tone. Si shembull ketu mund te permenden karrierat e hapura me shpatin perendimor te parkut kombtar te Dajtit, karrierat e hapura ne Tarabosh afer fabrikes se cimentos dhe ne rrugen nga Ura e Bunes ne Shiroke; germimet e bera ne shpatet perendimore te vargjeve te gelqeroreve nga Fushe –kruja ne Milot; karriera ne buze te rruges Ura e Milotit-Rubik, germimet ne Shpirag Pogradec, ne lindje te Sarandes etj.

Megjithese disa karriera jane pezulluar, eshte e domosdoshme qe te kufizohen demtimet e ambjentit nga germimet per shfrytezimin e shkembinjve karbonatike duke marre masa:

1. Ne drejtim te rishikimit te ligjit minerar egzistues, i cili nuk parashikon masa per mbrojtjen e ambjentit dhe sanksione ndaj demtuesve.
2. Ne dhenien e licensave duhet te kihet parasysh qe karrierat per shfrytezimin e shkembinjve karbonatike te jepen per objekte te vendosur ne pozicione qe nuk demtojne ose minimizojne ne maksimum prishjen e ekuilibrit natyror.
3. Te gjitha firmat private qe shfrytezojne karrierat duhet tu permbahen projekteve teknike qysh ne vitet e para te parashikojne investime per regjistrimin e sektoreve te shfrytezuara. Kjo duhet te shoqerohet edhe me nje kontroll rigoroz te zbatimit te projekteve nga institucionet qe japin licensat.

## **Kapitulli i III**

### **BASENI I DRIN - BUNES**

### 3.1 Karakteristikat gjeografike dhe gjeomorfologjike te lumenjve te basenit

Baseni i Drin-Bunes, eshte i dyti persa i perket madhesisse dhe ze nje siperfaqe afersisht 7400km<sup>2</sup>

Ne rrjetin hidrografik te basenit te Drinit bejne pjese lumenjte e Bunes Drinit me dy deget e tij Drinin e Zi e Drinin e Bardhe, Valbones, Shales, Kirit, Vrakes, Rrjollit, Gjadrit dhe liqeni i Shkodres. Drini me liqenin e Shkodres dhe Bunes perbejne nje nyje, kompleks apo teresi ujore qe per veçorite, permasat dhe shkallen e ujeshmerise perfaqeson sistemin me te madh hidrografik te vendit tone. Lumi i Drinit, me i madhi, jo vetem i vendit tone, por i gjithë pjeses perendimore te Ballkanit, nga siperfaqia ujembledhese (14.173 km<sup>2</sup>), gjatesia (285 km) dhe shkalla e ujeshmerise se rrjetit hidrografik te tij. Lartesia mesatare e pellgut te tij eshte 971 m. Formohet nga Drini i Bardhe dhe i Zi.

Lumi i Drinit perbehet nga dy dege kryesore Drini i Zi dhe Drini i Bardhe.

**Drini i Zi** (149 km), me pellg ujembledhes 5885 km<sup>2</sup>, buron nga liqeni i Ohrit (695 m) dhe, pasi pershkron nje rruge te gjate (rreth 40 km) dhe te ngushte midis vargjeve malore Jabllanice-Belice dhe Karaorman, hyn ne Shqiperi, duke u hapur ne vazhdim ne nje shtrat shume te gjere. Ne kete sektor te rrjedhjes se tij merr shume dege te vogla dhe me rrjedhje te paqendrueshme, si Radiken etj. Ne vazhdim lugina dhe shtrati tij here zgjerohet e here ngushtohet deri sa derdhet ne liqenin e hidrocentralit te Fierzes, ku bashkohet edhe me Drinin e Bardhe. Renia e lumit deri ne derdhjen e tij ne liqen eshte afer 3 m/km. Ka pellg ujembledhes shume te thyer me kontraste te medha te relievit, dhe kalon neper formacione terrigjene, karbonate, gipsore, magmatike, etj te moshave te ndryshme.

Deget e tij jane Zalli i Homeshit, perrenjte e Murres, Veleshices, Banjave, Molla e Lures etj. te cilet, kane karakter torrencial.

**Drini i Bardhe** (136 km), me pellg ujembledhes 4975 km<sup>2</sup>, ze fill ne nje burimi te madh karstik, ne rreze te majes Ruseli, te malesise se Zhlebit (Kosove). Pershkron lugun e Dukagjinit, ku merr shume dege: Topluga, Bistrica e Prizrenit, Ereniku, Mirusha etj. Hyn ne territorin e Shqiperise ne gryken e Verbnices, duke u derdhur ne liqenin e Fierzes. Pellgu i tij perbehet kryesisht nga terrigjenet dhe gelqeroret. Ka relief me pak te thyer e te copetuar se ai i Drinit te Zi .

**Drini i Bashkuar**, Mbas bashkimit te dy lumenjve ne rrjedhjen e mesme formon liqenet artificiale te Fierzes, Komanit dhe Vaut te Dejes te ndertuar gjate viteve 1970-1980 me tre hidrocentralet (Fierze, Koman, Vau i Dejes) me fuqi prej 1 350 000 KW. Ne kete sektor, Drini hyn ne disa gryka te ngushta, si ajo ku "Thyen Qafen Drini", Melgunit dhe e Vaut te Dejes, ne te cilat jane ndertuar digat. Atij i bashkohen disa dege: Serriqe, Kruma, Valbona, Nikaj Merturi, Shala, Gomina etj. Relievi i kesaj pjese te pellgut ujembledhes dallohet per kontraste, lartesi e copetim shume te madh. Perbehet kryesisht nga gelqerore (sidomos pjesa veriore etj) dhe magmatiket e larmishem. Ka klime shume te pasur me rreshje, ne te cilat rreshjet e debores zene vend te rendesishem; bimesi te dendur (pjesa jugore) dhe te rralle (pjesa vcriore).

Ne rrjedhen e poshteme nga Vau i Dejes ne Bune, shtrati i lumit zgjerohet deri ne 2-3 km. Relievi tashme eshte fushor dhe perbehet nga molasa kuatemare. Ketu Drini vazhdimisht e ka ndryshuar shtratin e tij. Shqyrtimi i hartave e shenimeve te ndryshme tregon se Drini here eshte drejtuar ne liqenin e Shkodres, here direkt ne detin Adriatik (prane Lezhes) dhe here prane Bunes.



Drini ushqehet nga reshjet e shiut e te debores si dhe nga ujerat nentokesore. Per Drinin e Bardhe ushqimi siperfaqesor perben 70 % dhe ai nentokesor 30 %. Per Drinin e Zi, dhe Drinin ne derdhje ne Bune respektivisht 63 %, 69 % dhe 31 % . Nga sasia e reshjeve, pellgu ujembledhes i Drinit ndahet ne dy sektore: lindor me rreth 900 mm/vit dhe perendimor me rreth 2000 mm/vit. Si rrjedhim i ketyre kushteve fiziko-gjeografike, lumi ka regjim hidrologjik karakteristik: dallohen faza ujeshume me 75-80 % te rrjedhjes vjetore dhe faza ujepak me 20-25 % te saj. Rjedhja e Drinit eshte e çrregullt: ne vitin mesatar, ndryshimi midis prurjeve skajore arrin 4-7 here, ndersa per Drinin e Bardhe deri ne 10 here. Ne vitet jo te zakonshem ky ndryshim arrin 7-12 here. Prurja mesatare vjetore e Drinit te Zi eshte 118 m<sup>3</sup>/sek. dhe e Drinit te Bardhe 68,2 m<sup>3</sup>/sek ; e Drinit ne derdhje ne Bune 352 m<sup>3</sup>/sek.

Volumi mesatar vjetor i rrjedhjes se ngurte tek Drini arin 15 milion ton dhe modul 1160 ton/ km<sup>2</sup>/vit. Mineralizimi i ujerave eshte mesatar (260-280 mgr/lit) dhe mbizoterojne jonet e bikarbonateve (52 % - 62 %), qe lidhet me shkrijen e madhe te gelqeroreve ne pellgun ujembledhes. Rrjedhja mesatare e aluvioneve pezull ne lumin Drin eshte 438 kg/sek, ndersa turbullsira eshte 1250 gr/m<sup>3</sup>.

Ndarja e Drinit ne dy dege permendet per here te pare ne shekullin XV dhc per here te dyte ne mesin e shekullit te XIX. Drinit te Lezhes, megjithese ne vitin 1954 i eshte bere prita per ndarjen me Drinin e Madh qe derdhet ne Bune, duke i nderprere totalisht rrjedhjen siperfaqesore te lumit, ne shtratin e vjeter perseri rrjedh uje, qe furnizohet nga uji nentokesor i zhavoreve aluviale, i cili nderton gjithe fushen e Gjadrit.

Ritja e nivelit ne shtratin e Drinit te Madh rrit sasine e ujit ne shtratin e Drinit te Lezhes, i cili ka shtrat te ngushte dhe pjerresi shume te vogel, duke depozituar vazhdimisht materiale te imta (surera, suargjila) deri sa shpesh mbush pothuajse plotesisht shtratin e tij. Ne kohe rreshjesh te rrembyeshme del nga shtrati dhe permbyt fushat e Barbullushit dhe te Karkariqit. Kjo permbytje ndihmohet shpesh edhe nga prurjet e shumta te lumit Gjader, qe i bashkohet ne afersi te fshatit Balldre dhe te perrenjve te zones se Kallmetit dhe Hajmelit.

Ne afersi te Lezhes, lumi i Drinit tashme edhe i dubluar me ujin e Gjadrit, kalon neper luginen e ngushtuar, me perberje gelqerore ne perendim te Lezhes dhe derdhet ne Adriatik, ne jug te Shengjinit, duke krijuar lagunat piktoreske te Lezhes te emertuara Kenella, Merxhani, Vaini etj., te cilat komunikojne me detin Adriatik nepermjet kanaleve natyrale dhe artificiale. Keto laguna kane nje furnizim me uje te embel si nga Drini, ashtu edhe nga ujerat nentokesore te gelqeroreve te Kretakut, te zones facialo-tektonike Kruja.

**Lumi I Bunes** eshte i vetmi lume fushor i vendit. Buron nga liqeni i Shkodres, ka gjatesi 44 km; disnivel vetem 5 m dhe renie 0.11%. Pellgut ujembledhes ,qe i takon Drinit dhe Liqenit te Shkodres eshte malor i thyer, perbehet kryesisht nga gelerore te karstifikuar, ka reshje te shumta (mbi 1500 -2000 mm/vit) dhe bimesi te varfer. Per shkak te pjerresise shume te vogel dhe prurjeve te ngurta te Drinit, Buna e ka ndryshuar disa here shtratin. Shtrati i saj ka meandre te shumta dhe perfundon ne delten e madhe, ku dallohen dy ishuj aluvilale: Ada (5 km<sup>2</sup>) e Franc Jozefi qe per shkak te erozionit eshte duke humbur.

Regjimi hidrologjik i Bunes percaktohet nga regjimi i liqenit te Shkodres dhe i Drinit, sidomos mbas derdhjes se plote te tij. Kur Drini ka prurje maksimale pengon rrjedhjen e lire te ujerave te Bunes, madje, ne rastet skajore, krijon edhe rrjedhje te kundert. Ne fryrjen e Bunes luajne rol meandrimet dhe ngushtimet e shtratit; ne disa raste rrjedhja e saj bllokohet nga valezimi i fuqishem i detit, baticat dhe era e Shirokut.

Prurja mesatare e Bunes ne dalje nga liqeni eshle 320 m<sup>3</sup>/sek, ndersa moduli i rrjedhjes 61,7 l/sek/km<sup>2</sup>, pasi bashkohet me Drinin 671 m<sup>3</sup>/sek dhe ne grykederdhje 680 m<sup>3</sup>/sek, duke zene keshtu vendin e trete ne Mesdheun Verior. Prurjet maksimale kane aritur 1304 m<sup>3</sup>/sek (janar 1963) dhe minimale 48 m<sup>3</sup>/sek (1948). Ne dalje nga liqeni ujerat jane te kulluara. Buna eshte pjeserisht e lundrueshme. Dikur anijet e tonazhit te vogel vinin deri ne Shkoder, por mbushjet e shtratit te saj nga prurjet e ngurta te Drinit kane hequr mundesine e lundrimit ne pjesen e mesme dhe te sipërme te lumit.

Nga vrojtimit e bera ne sektorin qyteti Lezhe – Kallmet – Gjader, takohen mbi 40 perrenj malor, te cilet aktivizohen kryesisht ne periudha me rreshje, duke grumbulluar te gjithë ujerat e shpatit dhe per t'i derdhur ato ne pjeset me te ulta, siç jane fushat e Merqise, Roboshtes, Kallmetit, Fagu i Madh e Hajmelit etj. Pavaresisht se ata aktivizohen ne kohe rreshjesh, ata kane punuar dhe po punojne shume ne thellimin e shtrëterve te tyre (fale dhe pjerresise se madhe 30% - 70% ), si rezultat i erozioni te fuqishem. Disa ura qe jane ndertuar mbi keta përrenj, ne rrugen automobilistike Lezhe – Shkoder apo Lezhe – Puke, jane demtuar si pasoje e prishjeve te themeleve te tyre, madje njera prej tyre eshte shembur fare (ura mbi perroin e Gjon Zefit ). Keto perrenj, krahas prurjeve te ngurta te bollshme, te cilat perbehen nga rera e zhavorre deri ne popla me permasa 0.5 – 1m<sup>3</sup>, sjellin dhe prurje ujore te medha, qe mbingarkojne lumin e Drinit te Lezhes. Ky i fundit nga gjeomorfologjia e shtratit te tij dhe kapaciteti ujembajtes e ka te pamundur transportimin e ujerave te ketyre perrenjve e te gjitha degeve te tij per t'i derdhur ne detin Adriatik, prandaj dhe historikisht, ne gjithë rajonin ku ai kalon, ne periudha me rreshje te medha kane ndodhur permbytje.

Lumenjte e Basenit te Drin-Bunes nderpresin nje larmi te madhe te formacioneve sedimentare e magmatike:

Ne zonen e Korabit ata nderpresin shkembinjte terrigjene, metamorfike dhe evaporitike te Paleozoit dhe Triasikut te poshtem-te mesem, ata flishore te kretak-Paleogjenit dhe molasat pliocenike.

Ne zonen e Mirdites nderpresin shkembinjte ultrabazike e vullkanogjene te Jurasikut, karbonatet e trisik-jurasikut dhe kretakut, “melanzhet” dhe flishet jurasiko-kretake dhe molasat plio-kuaternare.

Ne zonen e Alpeve Shqiptare shkembinjte terrigjeno-karbonatike te Permianit dhe Triasikut te poshtem-te mesem, formacionet e fuqishme karbonate te Triasikut te siperm, Jurasikut dhe Kretakut, depozitimet neogjenike dhe formimet kuaternare.

Ne ndertimin gjeologjik te pellgjeve ujembajtese te Drinit marrin pjese formacionet magmatike dhe karbonatike te zones Mirdita, formacioni flishor i nenzones Krasta dhe depozitimet kuaternare te ultesires perendimore.

***Formacioni karbonatik i Kretakut te siperm dhe Eocenit*** te zones Kruja nderton malet e Kakariqit dhe te Rencit me mbizoterim gelqeroresh dhe me pak gelqeroresh dolomitike ( Kretaku i Siperm ).

***Formacioni flishor i Mastriktianit – Paleogjenit ( Cr2m – Pg1-2 )***. Ka perhapje me te madhe ne rajon dhe perfaqesohet nga nderthurje e argjila, alevroliteve, ranoreve dhe shtresa te rralla gelqeroresh mergelore. Flishi eshte i tipit ritmik, teper i rrudhosur me mikrorrudha te permbytura.

Depozitimet kuaternare Kane perhapjen mbizoterues ne Ultesiren Perendimore, te rajonit nga Vau i Dejes ne Veliponje – Lezhe per pellgun e Drinit e te Bunes. Depozitimet e Pliocen – Kuaternarit jane takuar ne rajonin e Kashnjetit ne luginen e Gjadrut. Keto

depozitime perfaqesohen nga konglomerate, ranore te shkrifet dhe argjila kafe verdhacuke te tipit liqenoro – lumor.

#### ***Pleistoceni ( Qp )***

Perfaqesohen nga depozitime aluviale qe ndertojne pjesen akumulative te teracave ne lumin Kir ne zonen e ures se Mesit – Shkoder.

#### ***Holoceni ( Qh )***

Depozitimet e Holocenit te perfaqesuara kryesisht nga tipi aluvial, mbulon fushen e mbi Shkodres, Bushat, Bregut te Bunes, Kosmaçit, Zadrimes, Hajmelit, Lezhes. Ato kane trashesi nga disa metra ne 20 – 30m duke u vendosur po mbi depozitime aluviale te Pleistocenit. Depozitimet aluviale te taraces se pare te Kirit dhe ato te Gjadrit e Drinit, qe konsiderohen si te Holocenit te hershem, perfaqesohen nga zhavorre ne pjesen e poshtme dhe alevrite e argjila ne pjesen e sipërme, duke perfaqesuar depozitime aluviale te grykederdheve.

Po te Holocenit te hershem jane depozitimet kenetore, liqenoro – kenetore te Balldrenit te Kakariqit dhe depozitimet lagunore dhe detare, here te facies detare e here kontinentale, pra nderthurje te ujerave te kripura dhe te embla ne disa zona ,te te cilat vazhdojne te depozitohen sedimente edhe sot. Depozitimet aluviale te sotme ( Q4al ) takohen ne gjithë rrjedhjet e sipërme, mesme dhe te poshtem te lumenjve te Drinit, Gjadrit, Kirit. Sedimentimi i tyre eshte i ndryshem ne pjese te ndryshme te luginave, qe ne pergjithesi keto lumenj e kane trashesine e tyre mbi 20 – 30m ne gjithë gjeresine e luginës mbi 100 – 200m deri ne 1200m te saj. Depozitimet proluviale te sotme ( Q4pl ). Keto depozitime perhapen rreze shpateve dhe ne grykederdhjet e perrenjve e proskave. Me te perhapura keto jane ne zonen e kodrave te Hajmelit e Kallmetit qe kane qene edhe shkaku kryesor i zenies se kanaleve kulluese dhe te permbytjes se fushes se Lezhes, se bashku me Drinin (e Lezhes.

### **3.1 Perberja granulometrike dhe litologjike e inerteve**

Granulometria einerteve ndryshon, nga rrjedhja e sipërme drejt rrjedhjes se mesme, deri ne derdhjen ne detin Adriatik. Fraksionet me te trashë takohen ne rrjedhen e sipërme, kurse fraksionet e imta ne rrjedhen e mesme e te poshteme. Por ne disa pjese te shtratit kjo rregullsi prishet, per arsye te prurjeve te perrenjve anesore.

Ne zonen Vau i Dejes - Ura e Baçallekut - jane studjuar objektet :

#### ***Objekti Stajke me perberje granulometrike***

- Zaje mbi 40 mm (Popla) 5 %
- Zaje nga 20-40 mm (zhure) 12.2 %
- Zaje nga 10-20 mm ( zhavor) 29.3 %
- Zaje nga 5-10 mm (zhure) 20.3 %
- Zaje nen 5 mm. (rere) 33.5 %

#### ***Ganjolla me perberje granulometrike***

- Zaje me madhesi mbi 40 mm. (Popla) - 10.6 %
- Zaje me madhesi mbi 20-40 mm. (zhavor) - 17.8 %
- Zaje me madhesi mbi 10-20 mm. (zhavor) - 20 %
- Zaje me madhesi mbi 5-10mm. (zhure) - 15.2 %
- Zaje e grimca me madhesi nen 5 mm. (rere) - 36.4 %

#### ***Sektor i Vukatane me perberje granulometrike***

- Zaje me madhesi mbi 20 mm. (zhavore) - 7.5 %
- Zaje me madhesi mbi 10-20 mm (zhavore) - 12.9 %

- Zaje me madhesi 5-10 mm. - 11.2 %
- Zaje dhe grimca nen 5 mm. - 68.4 %

**Sektori Kuç me perberje granulometrike**

- Zaje me madhesi mbi 20 mm. (zhavore) - 12.3 %
- Zaje me madhesi mbi 10-20 mm (zhavore) - 11.5 %
- Zaje me madhesi 5-10 mm.(zhure) - 7 %
- Zaje dhe grimca me madhesi nen 5 mm.(rere)- 69.2 %

**Sektori Ashte me perberje granulometrike**

- Zaje me madhesi mbi 80 mm. (popla) - 6 %
- Zaje me madhesi nga 40-60 mm (popla) - 14 %
- Zaje me madhesi nga 20-40 mm.(popla) - 21.6 %
- Zaje me madhesi nga 10-20 mm (zhavor) - 26 %
- Zaje me madhesi nga 5-10 mm (zhure) - 11 %
- Zaje dhe rere me madhesi nen 5 mm. (rere)- 21.4 %

Vendburimi i Bahçallekut me perberje granulometrike 7 % rere dhe 30 % zhavore e zhure.

### 3.3 Vendburimet, objektet dhe sheshet e inerteve qe shfrytezohen nga subjektet

Ne basenin e Drin-Bunes nga Sherbimim Gjeologjik jane kryer studime dhe punime kerkim-vleresimi e inerteve te lumenjve ne sektoret: Zalli i Bulqizes – Shupenze – Gjorice, Muhurr, Fushe Alis, Urra e Spathares, Stajke – Baçallek dhe Kir (ne afersi te bashkimit me Drinin). Si rezultat i ketyre punimeve jane evidentuar vendburimet dhe objektet e meposhtem:

Ne zonen Vau i Dejes - **Ura e Bahçallekut** – kemi objektet e meposhtme:

**Objekti Stajke** ndodhet ne veri te fshatit Stajke. Ne kete sektor jane llogaritur brenda nje siperfaqeje prej 0.56 km<sup>2</sup>, vetem duke marre trashesine e lejuar prej 2 m. (mbi nivelin e ujit) nje sasi rezervash prej 1.12 miljon m<sup>3</sup> ngate cilat 20% rere, 79% zaje dhe 1% permbajtje argjilore. Afersisht keto permbajtje kane dhe objektet e tjere te ketij sektori.

**Objekti Ganjolle** ndodhet ne rrjedhjen me te siperme te Drinit, pas daljes nga diga e Hydrocentralit te Vaut te Dejes dhe bashkimit apo derdhjes se Gjadrit (pikerisht) ne Drin, ne perendim te Ures se Spatharit. Ne nje siperfaqe prej 0.112 km<sup>2</sup>. nga punimet e kryera jane llogaritur 2.24 miljon m<sup>3</sup> (duke marre si trashesi minimale perseri 2 m).

**Objekti Vukatane** ndodhet ne krahun e djathte te lumit Drin, prane fshatit Vukatane rreth 1 km larg Ganjollles. Ne kete sektor jane llogaritur 1.1 miljon m<sup>3</sup>, duke marre nje siperfaqe prej 0.55 km<sup>2</sup> dhe nje trashesi 2 m.

**Objekti Kuç** vetem ne nje zone te vogel me permbajtje te mire rere ne nje siperfaqe prej 0.2 km<sup>2</sup> jane llogaritur 400 mije m<sup>3</sup> vetem brenda trashesise (thellesise) 2 m.

**Objekti Ashte** ndodhet ne krahun e majte te lumit te Drinit. Brenda nje siperfaqeje prej 0.56 km<sup>2</sup> jane llogaritur 1320 mije m<sup>3</sup> me kete perberje granulometrike :

**Vendburimi i Bahçallekut** ndodhet poshte, ne perendim te Ures se Bahçallekut ,ne te cilin jane llogaritur 5 miljon m<sup>3</sup> rezerva. Perberja granulometrike mesatarisht eshte 7 % rere dhe 30 % zhavore e zhure.

Ne rrethin e Peshkopise jane evindetuar objektet e meposhtem

**Objekti Vajmedhenj** ndodhet ne Drinin e ZI ne afersi te fshatit Vajmedhenj me rezerva te llogaritura 405,000 m<sup>3</sup>.

**Objekti Fushe Aliaj** ndodhet ne Drinin e Zi, ne afersi te Fushe Aliajt me rezerva te llogaritura rreth 500,000 m<sup>3</sup>.

**Objekti i Gjorices** ndodhet ne Drinin e Zi ndermjet Ures se Çerenecit dhe Gjorices merezervate llogaritura rreth 3,000,000 m<sup>3</sup> ngate cilat 25% rere 74% zaje dhe 1% materil argjilor.

Ne lumin Drin dhe Bune vazhdojne shfrytezimin e inerteve te shtreterve te lumenjve nje numer i konsiderushem subjektesh private te cilet po i mrendisim me poshte:

Subjekti **“DRINI A”** me leje te shfrytezimit date 24.06.2003 me administrator Vehbi Kraja e rinovuar 02.07.2004 Shfrytezon nje siperfaqe 0.32 km<sup>2</sup> ne komunen Baçallek, te rrethit te Shkodres. Rezervat e inerteve rreth 650,000 m<sup>3</sup>, kapacitet vjetor 50,000 m<sup>3</sup>. Nga keto rere 28,000 m<sup>3</sup>, granil (1mm) 14,000 m<sup>3</sup>, granil 2 mm 8,000 m<sup>3</sup>.

Subjekti **“SABINA”** me leje te shfrytezimit date 24.06.2003 me administrator Sami ShoshiN, e rinovuar 02.07.2004, shfrytezon nje siperfaqe 0.415 km<sup>2</sup>, ne komunen e Berdices, te rrethit te Shkodres. Rezervat e inerteve rreth 140,000 m<sup>3</sup>, kapacitet vjetor 15,000 m<sup>3</sup>. Nga keto rere 6,000 m<sup>3</sup>, granil 1mm 2,000 m<sup>3</sup>, granil 2mm 4,000 m<sup>3</sup>.

Subjekti **“BERDICA”** me leje te shfrytezimit date 24.06.2003 me administrator Besim Dema, e rinovuar 02.07.2004 me siperfaqe 0.023 km<sup>2</sup> ndodhet ne komunen Berdices, te rrethit te Shkodres. Rezervat e inerteve rreth 120,000 m<sup>3</sup>, kapacitet vjetor 14,000 m<sup>3</sup>. Nga keto rere 8,000 m<sup>3</sup>, granil 1mm 2,000 m<sup>3</sup>, granil 2mm 4,000m<sup>3</sup>.

Subjekti **“MEKULI”** me leje te shfrytezimit date 24.06.2003 me administrator Ramiz Mekulin shfrytezon nje siperfaqe 0.045 km<sup>2</sup> ne komunen e Baçallekut, te rrethit te Shkodres. Rezervat e inerteve rreth 70,000 m<sup>3</sup>, kapacitet vjetor 24,000 m<sup>3</sup>. Nga keto zhavor 24,000 m<sup>3</sup>.

Subjekti **“DEDIA”** me leje te shfrytezimit date 24.06.2003 me administrator Marin Dedi, e rinovuar 02.07.2004 shfrytezon nje siperfaqe 0.023 km<sup>2</sup>, ne komunen e Bushatit, te rrethit te Shkodres. Rezervat e inerteve rreth 150,000 m<sup>3</sup>, kapacitet vjetor 25,000 m<sup>3</sup>. Nga keto rere 9,000 m<sup>3</sup>, granil 1mm 7,000 m<sup>3</sup>, granil 2mm 9,000 m<sup>3</sup>.

Subjekti **“LUANI”** me leje te shfrytezimit date 27.02.2004 me administrator Musa Heta, shfrytezon nje siperfaqe 0.3 km<sup>2</sup>, ne komunen Rrethina te rrethit te Shkodres. Rezervat e inerteve rreth 150,000 m<sup>3</sup>, kapacitet vjetor 25,000 m<sup>3</sup>. Nga keto rere 5,000 m<sup>3</sup>, granil 1mm 5,000 m<sup>3</sup>, granil 2mm 15,000 m<sup>3</sup>.

Mat	BEATO ANIBALE	Mat	Zejmen	Lezhe	6/27/2003	200000	0.256	2	65000	65000	70000	0
Mat	SUPER BETON	Mat	Zejmen	Lezhe	6/27/2003	42000	0.254	2	14000	8000	8000	0
Mat	GJOKA 02	Mat	Zejmen	Lezhe	6/27/2003	30000	0.15	2	14400	0	7800	0
Mat	JONIX	Mat	Milot	Kurbini	6/27/2003	28800	0.33	3	6000	9000	9000	0
Mat	ADOLFI	Mat	Zejmen	Lezhe	12/19/2003	30000	0.33	3	6000	9000	9000	0
Mat	HALILI	Mat	Milot	Kurbini	12/19/2003	80000	0.36	2.5	30000	41000	9000	0
Mat	PACANI	Mat	Milot	Kurbini	12/19/2003	80000	0.46	1.5	28000	12000	28000	0
Mat	GJELOSHI	Mat	F.Kuqe	Kurbini	12/19/2003	44000	0.3	2.6	4579	1105	38000	0
Mat	ELVISI 03	Mat	F.Kuqe	Kurbini	12/19/2003	46640	0.3	2.6	3572	860	36000	0
Mat	NATOJA	Mat	Shenkoll	Lezhe	5/28/2004	80000	0.307	2.5	6000	16000	18000	0
Mat	SIDRIT	Mat	Zejmen	Lezhe	5/28/2004	20000	0.075	2.8	12800	0	7200	0
Mat	SUKA	Mat	Milot	Kurbini	5/28/2004	50000	0.3	2	4000	0	40000	0
Mat	DOÇI	Mat	Shenkoll	Lezhe	10/22/2004	12000	0.118	2	4200	3600	2200	0
									<b>249851</b>	<b>204965</b>	<b>361800</b>	<b>114400</b>



#### **4.5 Impakti mjedisor nga shfrytezimi i inerteve**

Si rezultat i shfrytezimit te inerteve lumore ne lumenjte Mat e Fan jane vene re demtime ne mjedis. Me poshte ne po rendisim pasojat me te dukshme te ketij shfrytezimi agresiv mund te themi, te basenit te lumit Mat.

##### **1) Demtimi i veprave mbrojtese**

Ne lumenjte e pellgut te Matit (Fan dhe Mat) evidentohen demtime te veprave mbrojtese te tyre. Keto demtime pergjate lumit te Matit jane pasoje e aktivitetit te shfrytezimit te inerteve lumore.

Vepra e marrjes se ujit, te cilat permbushnin kerkesat per vaditjen e Fushes e Bregut te Matit ne rrethin e Lezhes dhe ate te zones Fushe Milot – Gurrez kane pesuar demtime, si rezultat i uljes se shtratit te lumit prej shfrytezimit te paligjshem, apo pa kriter te materialeve inerte.

Jane verejtur prishje argjinature (rreth 200 m. gjatesi te saj) 1000 m. poshte ures se Milotit, ne krahun e djathte te rrjedhjes se lumit si rezultat i thellimit dhe devijimit te shtratit te lumit me ne veri. Kjo, mendojme se eshte shkaktuar nga veprimtaria shfrytezuese e te kater kompanive qe kane instaluar impjantet e fraksjonimit ne kete zone (poshte ures se Milotit) si dhe personave privat pirat ne afersi te kesaj argjinature.

##### **2) Erozioni i tokes**

Ne brigjet e lumit Matit gerryerjet e tokes jane te ndjeshme. Keto fenomene jane me te dukshme ne lumin e Fanit para bashkimit te tij me lumin Mat ne krahun e majte te rrjedhjes dhe ne lumin e Matit ne afersi te fshatit Shenkoll, ne Fushe Milot, ne Gurez si, dhe gjate bregut te djathte te lumit e deri ne derdhjen e tij ne det. Sipas nje studimi te kryer nga Universiteti Bujqesor i Kamzes rezulton se humbja e tokes per basenin e Matit eshte llogaritur ne 11.6 ton/ha/vit

Nga subjektet e licensuara per shfrytezimin e materialeve inerte, nuk zbatohen kushtet e percaktuara ne lejen mjedisore dhe ato te projektit minerar, vecanerisht ne segmentin Ura e Autostrades Milot – Lezhe deri ne Gurez.

Nga shfrytezimi i pa kontrolluar i inerteve te lumit Mat jane vene re ndikime ne ndryshimin e regjimit hidraulik te rrjedhjeve ne disa sektore te ketyre lumenjve, gje e cila ka çuar ne zhvillimin e erozionit anesor dhe ne prishjen e argjinaturave.

##### **3) Shfrytezim intensiv**

Nga krahasimet e vlerave te prurjeve te ngurta fundore qe arrijne ne 80 000 m<sup>3</sup>/vit me ato te shfrytezuar nga subjektet e ndryshme qe dokumentohen me 450 000 m<sup>3</sup>/vit, rezulton se koha e rigjenerimit te shtratit te ketij lumit eshte 4.6 vjet, çka do te thote qe ne shtratin e ketij lumi duhet te minimizohet shfrytezimi i metejshem i materialeve inerte.

Me vendimin e nr.1 date 21.06.2006, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli Kombëtar i Ujit, u vendos reduktimi i shfrytezimit te zhavoreve dhe rerave ne shtratin e lumit Mat dhe konkretisht per segmentet:

- Segmenti nga bashkimi i lumit Mat me lumin e Fanit, deri në 500m mbi Urën e Zogut.

- Segmenti nga Ura e Milotit (500m nën urën e autostradës) deri në fshatin Gurzë.
- Në segmentin 500m nën urën e Rrëshenit deri në bashkimin e tij me lumin Mat.

#### **4) Prishje te ekuilibrave hidrike**

Renia e nivelit ne shtresen ujembajtese te Fushe – Kuqes dhe Riles ne rrethin e Lezhes, per shkak te shfrytezimit pa kriter te materialeve inerte, do te shkaktonte renien e nivelit piezometrik te shtreses ujembajtese, duke ulur keshtu prodhimin e ujerave nentokesore, qe eshte burimi kryesor i furnizimit me uje te pijshem te qytetit te Duresit, Laçit, Fushe Krujes, Mamurrasit, Lezhes dhe te gjithë fshatrave perreth.

#### **5) Rrezik per mjediset urbane**

Si rezultat i veprimtarise eroduese te lumit Mat, ujerat rrjedhese te tij jane afruar shume argjinatures mbrojtese dhe dita dites ai po perparon ne kete drejtim Prandaj ne mendojme se edhe ky segment perben nje rrezik per popullsine e ketij fshati. Edhe kanali i shkarkimeve te ujerave te ndotura te uzines se Laçit eshte shfaqur i rrezikshem, sidomos gjate periudhes se shirave, duke permbytur nje pjese te fshatit Alku dhe Gurre (Kurbin) ku niveli i ujerave ka arritur deri 0.5 – 0.7m neper godinat e banimit. Ne kete rast kanali ka sherbyer si nje kolektor i te gjithë ujerave siperfaqesore te kesaj zone.

#### **6) Permbytje**

Nje nga shkaqet kryesore te permbytjeve nga lumi Mat, eshte akumulimi apo veshja ne menyre te shpejte dhe te vazhdueshme te shtreterve te tyre me lende te ngurte (aluvione) per arsye te zhvillimit te nje erozioni te madh ne rrjedhjet e siperme te tyre. Ne kete menyre profili terthor i shtratit te lumit behet gjithnje e me i vogel me ngritjen e nivelit te shtreterve te tyre dhe meandrimet e shumta. Ky shkak ka shume rendesi mbasi mjafton vetem nje ngritje e vogel e nivelit te ujit qe ai te dale nga shtrati dhe te permbyte fushat me gjithë punimet e argjinatures mbrojtese, per arsye se sedimentet e fushave anesore te lumit Drin, Mat jane aluvionale.

Po keshtu relievi fushor (ultesira bregdetare) ka pjerresi shume te vogel ne drejtim te perendimit. Nje faktor tjetër qe ka ndikuar ne zhvillimin e dukurise se permbytjeve eshte njeriu, duke shfrytezuar pa projekte dhe pa bere studime ne inertet aluviale te lumenjve te trajtuar me siper.

### **4.6 Vendburimet, objektet e shkembinjve karbonate dhe rezervat**

Ne basenin e Matit shkembinjte karbonate kane perhapje te madhe. Ata formojne prerje te fuqishme dhe u perkasin moshave te ndryshme.

Ne zonen Krasta-Cukali gelqeroret triasike, jurasike e kretake perhapen ne fshatrat Lisen, ne Spiten, Manati, Zejmen, Pllane etj., kurse ata pllakore te kretakut te siperme ne Rrasfik dhe perroi e Hurdhes.

Gelqeroret e Kretakut te siperme te zones stukturalo faciale te Krujes takohen ne jug te Milotit dhe ne shtrirjen e tyre ne drejtim te veriperendimit dhe juglindjes, respektivisht ne basenet e Drin-Bunes dhe Ishem-Erzenit. Ne malet e Rencit, Kakarriqit, perfaqesohen nga gelqerore pllake trashe te nderthurur dhe gelqerore dolomitike.

Ne zonen e Mirdites jane mjaft te perhapur gelqeroret dhe gelqeroret dolomitik kryesisht te Triasikut te siperm ne sektoret m. I Veles-Rubik, Shkopet-Vinjolle, Gure e Vogel-Klos dhe ne Malin me Gropa. Gelqeroret kretake te kesaj zone perhapen gjate kufirit lindor te saj nga Xhuxha ne Mbasdeje.

Nga studimet dhe kerkim-vleresimi i bere ne rrethet e basenit te Matit, nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar, jane evidentuar vendburime dhe objekte te shkembinjve karbonate, te cilet mund te shfrytezohen per nxjerezjen e inerteve, per plotesimine nevojave te sektorit te ndertimit. Sikurse shihen nga tabela 8 ketu ndodhen nente vendburime, nga te cilet kater ne gelqeroret e zones Krasta-Cukali (Manati, Spiten, Rasfik dhe Milot), tre ne gelqeroret triasike te zones Mirdita (Lis, Gure e Vogel dhe Klos) dhe dy ne gelqeroret kretake te zones mirdita (Kurbnesh dhe Qafe Kishe). Eshte e nevojshme te theksojme se punimet e kerkim-vleresimit, jane kryer shume kohe me pare dhe nuk kane marre parasysh kerkesat e kohes , per ruajtjen e ambientit dhe bukurise natyrore. Si shembull mund te permendim objektin e Rrasfikut ne buze te rruges nacionale Milot-Rubik

Ne basenin e Matit ekzistojne mundesite per zevendesimin e inerteve lumore, shfrytezimi i te cilave eshte ndaluar me vendimin e KK dhe K KU, me inerte te nxjerre nga shfrytezimi i shkembinjve karbonate me kariera.

Nga objektet e studjuara nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar, jane llogaritur rreth 58,500,000 ton (Tabela 8 e vendburimeve dhe objekteve te gelqeroreve). Por duhet te theksojme se perspektiva per shtimin e rezervave eshte e hapur.

Rezervat e karbonateve ne sheshet e shfrytezimit me siperfaqe te vogla ( 0.01-0.04) me pak me shume investime mund te rrisin kapacitetet e tyre prodhuese. Keshtu rezervat e karbonateve te ndara sipas rretheve po ia japim me poshte :

Rezervat ne m<sup>3</sup> te karbonateve per rrethin e Lezhes jane llogaritur ne 8.429 780 m<sup>3</sup>

Rezervat ne m<sup>3</sup> te karbonateve per rrethin e Kurbinit jane llogaritur ne 2.067.985 m<sup>3</sup>

Rezervat ne m<sup>3</sup> te karbonateve per rrethin e Mirdites jane llogaritur ne 2.756.971 m<sup>3</sup>

Rezervat ne m<sup>3</sup> te karbonateve per rrethin e Matit jane llogaritur ne 5.61890 m<sup>3</sup>

Pamvaresisht se disa nga objektet e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar dhe sheshet e karrierave jane vendosur pa respektuar kushtet per ruajtjen e ambientit mendojme se ekzistojne te gjitha mundesite per shtimin e rezervave ne objekte te vecante dhe ne mjaft sektore te tjere perspektive . kjo mundet te arrihet me studime e shpenzime te vogla.

***Ne basenin e Matit si sheshe perspektive*** rekomandojme sektoret:

- Katundi i Vjeter
- Gallat-Skuraj
- Milot

Tabela 8: Vendburimet dhe objektet e shkembinjve karbonate ne basenin e Matit

Nr	Vendburimi, objekti	Rajoni	Lloji gurit dekorativ	Perberja kimike ne %				Vetite fiziko mekanike		Rezervat Resurset ne m <sup>3</sup>	Perspektiva
				CaO	MgO	SiO <sub>2</sub>	Fe <sub>2</sub> O <sub>3</sub>	Rez.sht kg/cm <sup>2</sup>	P.vol gr/cm <sup>3</sup>		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	Monati	Lezhe	Gelqeror	50.0	0.75		0.6	1 000	2.62	1 722 647	“
2	Spiten	Lezhe	Gelqeror	52.1 6	0.62		0.40	1 350	2.7	4 053 709	“
3	Milot	Kurbin	Gelqeror	34.0	16.6		0.34	1 170	2.6	20 730 769	“
4	Rrasfik	Mirdite	Gelqeror	51.0	0.26	0.95	0.5	1 120	2.57	30 000 000	
5	Kurbnesh	Mirdite	Gelqeror							> 1 000 000	“
6	Qafe Kishe	Mirdite	Gelqeror					570	2.63	>1 000 000	“
7	Lis	Mirdite	Gelqeror	54.6 8	0.65	0.61	0.74	1 205	2.71	2 284 452	“
8	Klos	Burrel	Gelqeror	54.6	0.27	0.4	0.04		“	>10 000 000	
9	Gure e Vogel - Selite	Burrel	Gelqeror							> 1 000 000	“
	TOTAL										

#### 4.7 Subjektet qe shfrytezojne shkembinjte karbonate

Aktualisht ne basenin e Matit shfrytezojne me karriera gelqeroret e kesaj zone 14 subjekte te licensuara. Perhapja e tyre ne hapesine gjeografike eshte e pelqyeshme per sa i perket largesise nga njera -tjetra. Formacionet karbonatike dhe si rrjedhim dhe rezervat e gurit gelqeror jane mjaft te kenaqshme. Sasite e shfrytezuara sot jane te lidhura me nevojat e ndertimit ne kete rajon.

Rrethi i Lezhes eshte qendra e basenit te Matit. Ashtu siç mund te vihet re, numri i subjekteve qe kane karriera per shfrytezimin e shkembinjve karbonatike eshte me i madh ne krahasim me qytetet e tjera te ketij baseni. Ketu jane perfshire dhe subjektet e Lezhes e Shengjinit qe ndodhen ne basenin e Drin-Bunes.

Lista e subjekteve qe operojne ne kete pjese te basenit te Matit jane si me poshte:

Subjekti “**Tulla çimento**” me nr leje 384 date 8 01 1998, me siperfaqe shfrytezimi 0.009 km<sup>2</sup>, i ndodhur ne afersi te Shengjinit. Rezervat e licensuara te ketij subjekti arrijne ne 246,160 m<sup>3</sup>

Subjekti “**Besjona Impekx**” me nr leje 555 date 24 05 2000, me siperfaqe shfrytezimi 0.04 km<sup>2</sup>, i ndodhur afer Ishullit Shengjin. Rezervat e licensuara arrijne ne me shume se 1,012,500 m<sup>3</sup>

Subjekti “**Pacani**” me nr leje 560 date 19 06 2000, me siperfaqe shfrytezimi 0.02 km<sup>2</sup>, afer fshatit Kakarriq. Rezervat e licensuara arrijne ne me shume se 274,595 m<sup>3</sup>

Subjekti “**Donaj**” me nr leje 647 date 07 09 2001, me siperfaqe shfrytezimi 0.054 km<sup>2</sup>, afer fshatit Balldre

Subjekti “**Fba Konstruksion**” me nr leje 679 date 15 10 2002, me siperfaqe shfrytezimi 0.079 km<sup>2</sup>, afer fshatit Kakarriq. Rezervat e licensuara arrijne ne 5,175,987 m<sup>3</sup>

Subjekti **“Rosho Albania”** me nr leje 790 date 18 08 2004, me siperfaqe shfrytezimi 0.01 km<sup>2</sup> afer fshatit Tresh. Rezervat e licensuara arrijne ne me shume se 448,300 m<sup>3</sup>

Subjekti **“Lleshi”** me nr leje 222 date 18 12 1995, me siperfaqe shfrytezimi 0.341 km<sup>2</sup>, i ndodhur ne afersi te fshatit Delbnisht. Rezervat e licensuara arrijne ne me shume se 550,750 m<sup>3</sup>

Subjekti **“Met Hasani”** me nr leje 627 date 28 06 2000, me siperfaqe shfrytezimi 0.0055 km<sup>2</sup>, i ndodhur ne afersi te fshatit Shperdhjet. Rezervat e licensuara arrijne ne me shume se 109,940 m<sup>3</sup>

Subjekti **“Kutica”** me nr leje 904 date 26 08 2005, me siperfaqe shfrytezimi 0.0651 km<sup>2</sup>, i ndodhur ne afersi te fshatit Shperdhjet. Rezervat e licensuara arrijne ne me shume se 1,407,295 m<sup>3</sup>

Subjekti **“Eurogers”** me nr leje 735 date 26 11 2003, me siperfaqe shfrytezimi 0.073 km<sup>2</sup>, i ndodhur ne afersi te fshatit Katud i ri. Rezervat e licensuara arrijne ne me shume se 2,520,749 m<sup>3</sup>.

Subjekti **“Lesi”** me nr leje 765 date 15 06 2004, me siperfaqe shfrytezimi 0.028 km<sup>2</sup>, i ndodhur ne afersi te fshatit Rrasfik. Rezervat e licensuara arrijne ne me shume se 236,222 m<sup>3</sup>

Subjekti **“Komega”** me nr leje 353 date 26 02 1997, me siperfaqe shfrytezimi 0.009 km<sup>2</sup>, i ndodhur ne afersi te fshatit Lis. Rezervat e licensuara arrijne ne 2520749 m<sup>3</sup>

Subjekti **“Komega”** me nr leje 361 date 24 06 1997, me siperfaqe shfrytezimi 0.03 km<sup>2</sup>, i ndodhur ne afersi te fshatit Qafe Shtame. Rezervat e licensuara arrijne ne 69570 m<sup>3</sup>

Subjekti **“Pavlidis Albania”** me nr leje 733 date 17 10 2003, me siperfaqe shfrytezimi 1.15 km<sup>2</sup> e ndodhur ne afersi te fshatit Lis. Rezervat e licensuara arrijne ne 246160 m<sup>3</sup>

Numuri i vogel e karrierve ne kete basen lidhet me kerkesat e vogla te sektorit te ndertimit ne kete zone. Nevojat ketu jane me te kufizuara ne krahasim me metropolet e vendit tone.

Probleme mjedisore te nxehta nuk paraqiten, por problemet kryesore qe takojme ketu si rezultat i shfrytezimit me karriera jane te ngjashme me ato te baseneve te tjera:

- Ne dhenien e lejeve te reja per shfrytezim pervec aspekteve teknike per hapjen dhe sistemin e shfrytezimit duhet te vihen ne plan te pare dhe kerkesat per mbrojtjen e ambientit, ruajtjen e ekuilibrave dhe bukurive natyrore dhe rehabilitimin e sektoreve te shfrytezuara.

- Ne ligjin ekzistues minerar duhet qe te perfshihen patjeter dhe kushtet qe kufizojne hapjen e karrierve ne zonat turistike, parqet kombetare, afer qendrave te banuara.

- Ne bashkepunim institucional ndermjet Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes dhe Ministrise se Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te ujerave duhet te gjendet zgjidhja e duhur ligjore jo vetem per dhenien e licensave dhe lejeve te shfrytezimit por edhe per kontrollin e subjekteve per realizimin e projekteve per zbatimin e sistemeve te shfrytezimit, per rehabilitimin e sektoreve te shfrytezuara, duke parashikuar dhe sanksione per mos respektimin e kerkesave te projekteve.

- Subjektet qe shfrytezojne ne pergjithesi karrierat nuk respektojne projektet e hapjes dhe sistemet e shfrytezimit, pa mare asnje mase per rehabilitimin e sektoreve te shfrytezuara. Shume karriera sot kane pamjen e gropave

#### 4.8 Permbledhje dhe rekomandime

Duke u mbeshtetur ne materialet e siperpermendura per inertet e shtreterve te lumenjeve dhe objektet e shkembinjave karbonat si alternativ per zevendesimin e tyre mundet te nxjerrim keto perfundime:

- 1) Licensimi i subjekteve per shfrytezimin e inerteve lumore ne disa raste ne basenin e Matit eshte bere pa respektuar kushtet teknike per mbrojtjen e veprave publike dhe ambjentit.
- 2) Shfrytezimi shpesh behet pa respektuar projekte teknike dhe sidomos sistemet e shfrytezimit dhe rehabilitimit te ambjentit pas shfrytezimit.
- 3) Per shkak te shfrytezimit relativisht te vonet te inerteve lumore ne basenit te Matit, si dhe karakteristikave gjeologjike te zones ekzistojne rezerva te konsiderueshme te inerteve lumore.
- 4) Mungon koordinimi institucional per ushtrimin e nje kontrolli te specializuar dhe penalizimin e subjekteve qe shfrytezojne per moszbatim te projekteve sidomos persa i perket ruajtjes se amjentit dhe ekosistemit natyror.
- 5) Si rezultat i shfrytezimit intesiv te inerteve lumore ne sektore te kufizuar te shtreterve te lumenjeve verehen keto pasoja :
  - demtime te veprave mbrojtese, ne argjinatura
  - demtime te veprave ujites ( si rezultat i uljes se nivelit te lumenjeve)
  - demtime ne shkalle te ndryshme te veprave inxhinierike (urave, etj . ne disa raste nuk eshte respektuar distanca e lejuar nga kembet e ures)
  - ulje e nivelit te ujerave nentokesore dhe pakesimi i furnizimit me uje te fshatrave perreth.
  - Demtimi i bimesise ne shtratin e lumit
  - Rrezikimi i banesave te fshatrat anash shtratit te lumit Mat si rezultat i permbyjes gjate sezonit te shirave

Shfrytezimi ne karriera te gelqeroreve te basenit te matit siguron mundesine e zevendesimit te perdorimit te inerteve lumore per nje kohe te gjate. ( dhjetra bile dhe qindra vjeçare). Megjithate per te siguruar kete eshte e domosdoshme:

- 1) Duhet bashkepunim institucional dhe angazhimi me i madh i Ministrise se Mjedisit ne percaktimin e kritereve per paisjen me leje te shfrytezimit te karrierave te karbonateve duke nxjerre ne plan te pare ruajtjen e ambjentit dhe bukurive natyrore
- 2) Duhet nje bashkepunim institucional per kontroll rigoroz, nga nje personel i kualifikuar, i zbatimit te projekteve teknike sidomos per hapjen , shfrytezimin dhe rehabilitimin e sektoreve te shfrytezuar

## **Kapitulli i V**

### **BASENI I ISHEM-ERZENIT**

## 5.1 Karakteristikat gjeografike dhe gjeomorfologjike te lumenjve te Basenit


Baseni ujqor Ishem –Erzen, me nje siperfaqe rreth 2200 km<sup>2</sup> ndoshet ne Shqiperine e mesme. Ky basen pershkohet nga lumenjte e erzenit dhe Ishmit me deget e tyre dhe nga lumenjte e Darsit dhe Drojes.

*Lumi Erzen* eshte lumi me i gjate ne kete rajon, me nje gjatesi prej rreth 109 km. Kalon ne pjesen lindore e jug perendimore te rajonit. Buron ne jug - lindje te rajonit nga mali me Gropa, prapa vargmalit te Dajtit, duke prere zonat malore e kodrinore te Shengjergjit e Qaf- Molles dhe duke formuar lugina te thella, sidomos ne pjeset e siperme te rrjedhjes se tij. Prurja mesatare shumevjeçare ne Sallmonaj arrin ne 18 m<sup>3</sup>/sek. Prurja e inerteve 101 kg/sek

Lumi i Erzenit gjate rrjedhes se tij merr me vete nje sere perrenjsh qe derdhen ne shtratin e tij duke filluar nga zona e Shengjergjit e Qaf Molles, e duke vazhduar ne veri te Krrabes, ne zonen e Mulletit, Farkes, Fortuzajt, Arbanes, duke vazhduar drejt Pezes se Vogel, Ndroqit e Shijakut, pershkron neper Ultesiren e Erzenit ne veri te qytetit te Durrësit dhe derdhet ne detin Adriatik ne gjirin e Lalzit.

Gjate rruges se tij te gjate lumi Erzenit nderpret depozitime nga me te ndryshmet si shkembinj efuzive te zones se Shengjergjit, shkembinj karbonatike te vargmalit te Dajtit dhe shkembinj ranore e argjilore ne vazhdim te rrjedhjes se tij.

Nga studimi gjeologjik i kryer ne zonen nga Ura e Farkes deri ne Pellumbas predominojne zaje te shkembinjve efuzive e intruzive, ndersa me poshte zajet gelqerore dhe ato ranore. Studime te detajuara gjeologjike ne shtratin e lumit Erzen jane kryer nga Ura e Beshirit ne Ndroq me nje gjatesi 5.1 km e gjeresi 0.1 km dhe nga varri i Ashikut deri tek ura e fshatit Hardhishte me gjatesi 6 km dhe gjeresi 0.3 km.



### *Pamje satelitore e sektorit te derdhjes te lumit Erzen*

Ne keto pjese shtrati i lumit eshte me i gjere dhe ka me shume materiale inerte se ne



pjeset e tjera. Uji i lumit Erzen ka rrjedhje te shpejte e prurje te madhe dhe ne kohen e reshjeve shtohen shume prurjet e ujit, sa qe shpesh ky lume behet i rrezikshem per zonat e banuara dhe tokat bujqesore, duke shkaktuar permbytje dhe erozion te tokave bujqesore.

Ne te dy anet e lumit jane formuar terraca te vjetra lumore. Ne zonen e Pellumbasit dhe grykes se Skoranes, ku lumi Erzen nderpret shkembinjte karbonatike te Kretakut dhe Paleogjenit, formon nje lugine te thelle e te ngushte me kanione shume te bukura, nje lugine piktoreske dhe me vlera turistike, vlera te cilat shtohen dhe nga prania ne kete zone e shpelles shume te bukur karstike te Pellumbasit me gjatesi rreth 300 m, gjeresi 4 - 6 - 10m, lartesi 2 - 3 - 4 m., vende - vende 6 - 8 - 10m.

Bukuria e kesaj zone shtohet dhe nga diga e ujembledhesit te Skoranes dhe burimi karstik i Pellumbasit qe ndodhet ne lugine ne veri te fshatit Pellumbas. Te gjitha keto formojne nje kompleks me vlera gjeoturistike ne afersi te Tiranës Shfrytezimi i ketij burimi karstik mund te sherbeje dhe per permiresimin e furnizimit me uje te pijshem te qytetit te Tiranës.

Me poshte, ne zonat ku lumi pret depozitimet terrigjene me te buta si ne zonen e Fikasit, Mulletit, Stermasit, Arbanes dhe nga varri i Ashikut deri ne Hardhishte, lumi e nderon shtratin e tij duke depozituar ne shtrat sasi te medha materialesh inerte, ndersa ne zonat ku shkembinjte ranore jane te forte si ne afersi te Ndroqit dhe deri tek Varri i Ashikut, shtrati i tij ngushtohet shume dhe nuk formon terraca te gjera me materiale

**Lumi i Ishmit** eshte bashkim i lumenjeve te Tiranës, Terkuzez, Zezes dhe Drojes. Lumi i Tiranes eshte me i shkurter i ketij rajoni ne krahasim me Erzenin dhe Terkuzen. Ai ka nje gjatesi rreth 35 km dhe buron ne fshatin Hurmeze duke u fumizuar me ujin e Selites dhe te disa perrenjve me te vegjel qe derdhen ne shtratin e tij, te cilet ne stinen e veres pjeserisht thahen. Kalon ne zonen e Shpalit e Zall Dajtit, duke nderprere depozitimet karbonatike e terrigjene te kesaj zone, nderpret depozitimet karbonatike te Kretakut e Paleogjenit ne zonen Zall Dajt - Brar, depozitimet terrigjene e karbonatike te zones Brar - Tufine e Ferraj, çan rrugen neper fushen e Tiranës (ne depresionin Tirane - Ishem) kalon prane fshatit Dome dhe ne afersi te Fush Prezes, bashkohet me lumin Terkuza duke formuar lumin Ishem, i cili vazhdon rrugen per t'u derdhur ne detin Adriatik ne Gjirin e Rodonit.

Pjesa e sipërme e lumit Tirana, nga Zall Dajti deri tek ura e Brarit, ka shtrat te thelle e te ngushte dhe rrjedhje te shpejte te ujit, ndersa me poshte duke rene ne fushe ai ngadaleson shpejtesine dhe fillon te zgjeroje shtratin.

**Lumi i Terkuzes** pershkron pjesen veriore te rajonit dhe ka nje gjatesi rreth 36 km. Buron ne pjesen veri perendimore te Malit me Gropa dhe pasi pershkron depozitimet karbonatike e terrigjene te zones se Bastarit, Vilzes e Bulçeshit, nderpret depozitimet karbonatike te Kretakut te siperm e Paleogjenit te vargmalit Kruje - Dajt ne zonen e Bovilles, duke krijuar nje lugine te thelle me shpate te thepisura dhe duke zbritur ne zonen e Zall Herit, merr drejtim neper depresionin Tirane – Ishem, drejt fushes se Kamzes deri ne afersi te Fush- Prezes ku bashkohet me lumin e Tiranës duke formuar keshtu lumin e Ishmit, i cili derdhet ne detin Adriatik ne gjirin e Rodonit.

Gjate rruges se tij lumi Terkuza nderpret me pak shkembinj intruzive e efuzive dhe me shume shkembinj sedimentare, karbonatike e terrigjene. Keshtu qe dhe materiali qe ka sjelle e depozituar ne shtratin e tij eshte i ndryshem nga pikepamja petrografike dhe mineralogjike.

Nga studimet e kryera rezulton se ne inertet e ketij lumi predominojne zajet gelqerore dhe ato ranore dhe me pak zajet e shkembinjve efuzive e intruzive. Sipas rruges se transportit

dhe madhesia e rrumbullakesia e zajeve eshte e ndryshme. Zajet e shkembinjve intruzive dhe efuzive jane me te rrumbullakosur e me te vegjel se zajet e shkembinjve gelqerore dhe ranore. Keta te fundit shpesh takohen ne forme petash pak te rrumbullakosura. Permbajtja e SiO<sub>2</sub> ne rere lekundet ne kufijte 48 - 57 %. Ndersa ne te kaluaren gjate stineve te dimrit e pranveres shtonte shume rrjedhjen e tij duke permytur sektore te tere tokash bujqesore e zonash te banuara, me vone me sistemimin e tij me prita e argjinatura, me ngritjen e rezervuareve ne deget e tij dhe se fundi ngritjen e rezervuarit te Bovilles, ky lume u kthye me i dobishem per bujqesine dhe per fumizimin me uje te qytetit te Tiranës, por u kufizua shume sjellja e materialeve inerte.

**Lumi i Zezes** ka nje gjatesi qe nga burimi deri ku bashkohet me lumin e Gjoles prej 29 km. Buron nga pjeset jugore e jug - perendimore te masivit ultrabazik te Skenderbeut. Gjate rrjedhjes se tij, ai bashkohet me nje sere perrenjsh qe derdhen ne shtratin e tij, qe nga zona e Qafe Shtames, Kamel, Cullinit, Barkaneshit e Mukjes, duke kaluar neper zonen e Verjonit, Nikles dhe Fushe Krujes e deri sa bashkohet me lumin e Gjoles ne veri perendim te Fushe Krujes. Gjate rruges se tij ai pret depozitime te litologjive te ndryshme duke filluar qe nga formacionet ultrabazike te malit te Skenderbeut, shkembinjte karbonatike te Triasik Jurasikut, depozitimet flishore te Kretak Paleogjenit ne zonen e Kamelit, flishin e Oligocenit te poshtem ne zonen e Cullinit, depozitimet karbonatike te vargmalit Kruje - Dajt dhe depozitimet molasike te zones se Tirane - Fushe Krujes.

Nga studimi gjeologjik i kryer ne lumin e Zezes, ne nje gjatesi shtrati prej 4.65 km, perberja litologjike e formacioneve qe pershkon reflektohet ne sasi te ndryshme ne materialin e shtratit. Kryesisht zajet jane te perberjes terigjene e karbonatike dhe ne sasi te vogel takohet edhe materiali magmatik e silicor. Lumi i Zezes dallohet per regjim torrencial (te rrembyer). Prurjet maksimale shkarkojne ne det vellimin kryesor te ujerave te lumit. Njohja e tyre ka rendesi te madhe pasi me to lidhen masat hidroteknike qe duhen marre per ndalimin e permytjeve, si ndertim kaperderdhesash, projektim kanalesh kulluese, mbrojtja e tokave nga erozioni, etj. Lumi i Zezes si pjese e lumit te Ishmit e ka koeficientin e rrjedhjes 0.68 (68 % e ujit qe bie nga reshjet ne pellgun ujembledhes hyn ne rrjedhje). Ky koeficient i larte ne kohe rrebeshesh shkakton prurje te medha qe zoterojne energji shkaterruese te larte (shembulli i Shtatorit 2002).

Pjesa e sipërme e Zezes deri ne afersi te Mullirit ka shtrat te thelle e te ngushte me nje pjerresi shtrati 79/000, ndersa me poshte deri ne fshatin Verjon ai formon shtrat te gjere deri ne 190 m. ku edhe akumulon materialin inert qe sjell nga pjeset me te sipërme te bazes se erozionit. Pjerresia e shtratit ne kete pjese te lumit zbret ne 16/000 duke krijuar pra kushte te pershtateshme per sedimentim. Me poshte ne nje distance prej rreth 11 km. deri sa bashkohet me lumin e Gjoles, lumi rrjedh qete neper zonen fushore qe perben dhe rrjedhen e poshtme te tij me nje pjerresi shtrati prej 5/000.

Lumi i Zezes dhe lugina e tij nga rrjedhja e sipërme drejt grykes se Zezes eshte rezultat i bashkimit te perrenjve qe jane zhvilluar kryesisht ne perputhje me strukturat flishore duke shfrytezuar shkembinjte me argjilore. Ne gryken e Zezes lugina ng

Mer pamjen e nje kanioni me thellesi deri 250m. Pasi del nga formacionet karbonate lugina fillon te zgjerohet deri ne formacionet e Gelqeroreve litotamnike. Zgjerimi i luginesderi sa arin ne formacionet ranore. Me poshte, shtrati kalon pothuajse paralel strukturave deri sa hyn ne zonen fushore prane Fushe Krujes. Zhvillimi i taracave eshte i kufizuar pra jo tipik. Dallohen:

-Taraca e shtratit me dimensione te kufizuara dhe takohet gjate gjithe lugines me perjashtim te grykave depertuese. Trashesia e saj arrin 4-5 m. Ajo ruan karakteristikat e saj deri ne Fushe Kruje.

- Taraca e pare mbi shtratin. Verehet ne pjesen e poshtme te lugines ne afersi te Fushe Krujes, pikerisht aty ku dhe bashkohet me nivelin e pare te lumit te Terkuzes. Pjesa e siperme e taraces perfaqesohet kryesisht nga alevrite dhe rera te imta (surera). Pjesa e dukeshme e saj arrin 10-12 m, poshte se ciles takohen zhavoret e varrosura te kesaj tarace.

**Lumi i Drojes** eshte lume i shkurter me nje gjatesi rreth 32km. Buron ne perendim te masivit te Skenderbeut ne zonen e Shkretes dhe Nojes ne verilindje te Krujes, zbret ne zonen fushore ne verilindje te Krujes deri ne **Picrage**, ku nderpret gelqeroret dhe dolomitet e zones **Picrage** - Mamuras me nje shtrat te ngushte deri sa del nga karbonatet ne zonen e Shperdhetit afer ish reparit ushtarak te Mamurasit duke zbritur poshte ne drejtim te Fushe Mamurasit ku eshte i sistemuar dhe derdhet ne detin Adriatik ne veri te gryke derdhjes se lumit Ishem

## 5.2 Perberja granulometrike dhe litologjike e inerteve

**Lumi i Erzenit** eshte mjaft i ngushte dhe i rrembyshem, nuk formon terraca te gjera , shtrati ndodhet gjithmone, nen ndikimin e ujerave te tij dhe inertet (zhavorri e rera) jane ne levizje te vazhdueshme. Ky lume eshte ne formim e siper. Nga burimi deri ne afersi te Ures se Mulletit zajet jane te medhenj dhe pak te rumbullakosur dhe transportohen e levizin vazhdimisht. Zajet jane me te vogla dhe me te rumbullakosura afer ures se Farkes, ku ka gene e ngritur nje nyje shfrytezimi. Ne drejtim te ures se Beshirit dhe me poshte materiali rumbullakoset me shume, duke u shtuar perqindja e fraksionit te dobishem rere dhe granil edhe si rezultat i nderprerjes se depozitimeve ranore.

Nga analizat mineralogjike rezulton se ne inertet e ketij lumi kemi edhe minerale te fraksionit te rende si kromit, ilmenit, titano - magnetit etj., te cilet i japin reres ngjyren me te erret se ne lumin Tirana dhe Terkuza. Ne pergjithesi zajet jane gelqerore, ranore dhe me pak shkembinjsh bazike e ultrabazike. Perqindja e SiO<sub>2</sub> eshte rreth 55%. Pakoja produktive eshte nga siperfaqja deri ne horizontin argjilor e subargjilor qe mbulon shtratin e vjeter. Trashesia e inerteve luhetet nga 0.00 - 8.5 m.

Lumi Erzen nga burimi deri ne derdhje paraqitet si lume ne formim. Deri ne afersi te Ibes, ku bashkohet me lumin e Madhorit, rrjedh ne njesine gjeomorfologjike malore me lugine tipike erozionale teper te ngushte me trashesi te depozitimeve te shkriфта deri 2 m. Ne kete pjese, sipas perberjes granulometrike te depozitimeve aluviale, mbizoterojne fraksionet e medha.

Ne vazhdim nga Iba deri tek ura e Beshirit lugina paraqitet e tipit akumulativo - erozional me gjeresi te shtratit nga 600 - 700 m. deri ne 50 - 70 m. Trashesia e depozitimeve te shkriфта arrin 5 - 6 m. Ne kohen e reshjeve te medha lumi permbyt tere gjeresine e shtratit dhe uji pervec materialeve suargjilore ne gjendje suspension, zhvendos dhe materiale te shkriфта, reren si sediment shtrator per nje trashesi 12m. Depozitetet e shkriфта shtretore te kesaj zone jane ujembajtese dhe formojne rezerva te ujrave nentokesore prej te cilave merret uje per perdorim komunal. Granulometria e zhavorr-reres ne kete zone zbret per fraksionin e madh mbi 80mm dhe rritet per fraksionin e reres .

Nga ura e Beshirit deri ne Ndroq lumi nderpret depozitime rrenjesore alevrito ranore me fortessi te dobet deri mesatare dhe kemi proçese te erozionit te shpateve te lugines dhe transport te mases se ngurte ne gjendje suspension dhe zhvendosje zvarritese te shtreses

zhavorr - rere. Ne kete sektor nga ana granulometrike mungon fraksioni i madh mbi 80 mm dhe mbizoteron fraksioni 40 - 20 mm dhe fraksioni i reres nen 5 mm.

Studimi gjeologjik i **lumi Tirana** eshte kryer nga ura e Kamzes deri tek ish Kombinati i Mishit me nje gjatesi prej 4.2 km dhe gjeresi 0.15 km. Nga ana petrografike ne inertet e ketij lumi predominojne zajet gelqerore e ranore (shume me pak ato intruzive e efuzive) permbajtja e SiO<sub>2</sub> ne rerat eshte ne kufijte 47 - 57 %, zajet jane pak te rumbullakosura dhe kokrrizat e reres jane me kende te mprehta.

Lumi i Tiranës nga burimi i tij deri ne afersi te Babruse rrjedh kryesisht ne njesine gjeomorfologjike malore dhe pjeserisht kodrinore. Gjeresia e shtratit nga 15-30 m shkon deri 100 - 300 m. Nga ana granulometrike deri ne afersi te Babruse mbizoterone fraksionet e medha mbi 20 mm. Nga Babruja deri tek ura e Kamzes lumi kalon ne kontakt te zones kodrinore me ate fushore. Shtrati eshte i tipit erozionalo - akumulativ me gjeresi 200 - 500 m. Trashesia e depozitimeve aluviale zhavorr - rere te shtratit te lumi eshte 4 - 6 m. Nga ana e perberjes granulometrike, ne kete sektor, ka renie te fraksioneve te medha ,sidomos atij mbi 80 mm dhe rritje te fraksionit te reres nen 5 mm me mbizoterim te fraksioneve 80 - 20 mm. Depozitimet zhavorore ne kete pjese paraqiten ujembajtese, furnizohen me uje nga mbledhja e lumi dhe niveli i ujerave nentokesore ka qene prane siperfaqes duke u shfrytezuar per fumizim me uje komunal.

Nga ura e Kamzes dhe me poshte lumi kalon ne zonen fushore dhe inertet e kesaj pjese nuk paraqesin interes per t'u perdorur si material inert per llaçe e betone, sepse permbajne shume material argjilor. Ne kete sektor, shtrati i lumi, ne pjesen me te madhe te kohes, permbytet nga rrjedhja e lumi. Edhe depozitimet e inerteve (zhavorr + rere) te shtratit te ketij lumi ,duke qene afer Tiranës, kane terhequr vemendjen per prodhim inertesh edhe para viteve nentehjete.

Deri ne vitin 1992, shfrytezimi i inerteve te ketij lumi kryhej kryesisht me tre linja perpunimi (larje - fraksionim) ne afersi te Tapizes e Çekrezes me prodhim te kufizuar . Ne vitet 1992 - 2002 shfrytezimit te materialit zhavor + rere edhe ne shtratin e ketij lumi i eshte nenshtuar e gjithë shtresa produktive e shtratit ne gjithë gjatesine e lumi nga Zall Herri deri poshte Ures se Tapizes, nepermjet disa impjanteve te perpunimit te ngritur gjate gjithë gjatesise se lumi.

**Ne lumin Terkuza** eshte shfrytezuar pothuajse e gjithë sasia e inerteve ne shtratin e tij, nga Pinari deri poshte Tapizes, me perjashtim te nje sektori te ngushte ngjitur me arat e fshatit Zall Herr ne te majte te rrjedhjes se lumi

**Ne lumin e Zezes** inertet perfaqesojne formime lumore te materialit ranor e te zajeve te madhesive te ndryshme, te perziera ne raporte te caktuara sasiore, te Inansportuara dhe te depozituara ne shtratin e lumi gjate prurjeve ne kohe te ndryshme te periudhes kuaternare. Nga lindja drejt perendimit shtrati shtrihet me Az. 220-225 grade, pastaj ne afersi te malit te Serjanit kthen drejt perendimit me Az 270-280 grade. Pjerresia e shtratit ne zonen e studjuar eshte 18/000. Gjatesia e pjeses se studjuar eshte 4.65 kml. Nga provat e marra ne punimet e kryera ne shtratin e lumi sipas profileve te zbulimit, sasia e reres eshte mesatarisht 26 %, zajet 71 % dhe pluhurat 3 % . Mbizoterone kryesisht kokrrizat me prejardhje karbonatike dhe terigjene, por me te pranishme edhe ato silicore e magmatike (Dhimitri A. 1997).

### 5.3 Vendburimet, objektet dhe sheshet e inerteve qe shfrytezohen nga subjektet

Ne basenin e Ishem –Erzenit inertet e shtreterve te lumenjve prej kohesh kane terhequr vemendjen per tu shfrytezuar si lende e pare per ndertim (Ilaç e beton).

Nga Sherbimi Gjeologjik i vendit tone, ne lumenjte e Erzenit, Tiranes, Terkuzes dhe Zezes, jane kryer punime kerkim-zbulimi per vleresimin cilesor dhe sasior te inerteve inerteve te shtreterve te tyre.

Ne lumin e Erzenit jane studjuar sektoret Ndroq-Ura e Beshirit dhe Varri i Ashikut—Ura e Hardhishtes. Ne lumin e Tiranes sektoret Ura e Kamzes-ish Kombinati i Mishit dhe ndermjet fshatrave Qerek e Zall Herr. Ne lumin e Terkuzes ne sektoret Zall Herr-Ura e Tapizes dhe Ura e Tapizes-Fushe Rinas. Ne lumin e Zezes ne sektorin ndermjet fshatit Verjon dhe zones ne lindje te kodres se Verjonit.

Pershkrimin e subjekteve qe kane shfrytezuar inertet e ketyre lumenjve nuk e shohim te nevojshme ta bejme mbasi jane disavendime te Keshillit te Ministrave dhe Keshillit Kombetar te Ujrave qe kane ndaluar plotesisht shfrytezimin e inerteve ne lumenjte e ketij baseni. Me vendimin nr.1 date 09 01 2003 eshte ndaluar shfrytezimi ne pellgjet e Erzenit dhe Ishmit (me perjashtim te disa sektoreve te lumit Erzen). Duhet te veme ne dukje se dhe mbas ketij vendimi ka vazhduar shfrytezimi intensiv i inerteve ne keta pellgje.

Duke vleresuar gjendjen e rende dhe demtimet e shumta, te shkaktuara nga shfrytezimi intensiv pa kriter i inerteve, Keshilli i Ministrave me vendimin nr.21 date 19 05 2006 ka ndaluar shfrytezimin ne te gjithë gjatesine e lumenjve Ishem e Erzen. Ne kete vazhde ka qene dhe vendimi nr.1 date 21 06 2006 i Keshillit Kombetar te Ujrave.

### 5.4 Rezervat dhe kapacitetet e shfrytezimit te inerteve nga subjektet

Studimet dhe punimet e kerkim-zbulimit te kryera ne lumenjte e basenit te Ishem-Erzenit kane llogaritur rezervat e paraqitura me poshte:

**Ne lumin e Erzenit.** jane kryer punime kerkim - zbulimi ne sektorin ndermjet Ures se Beshirit dhe Ndroqit dhe sektorin Varri i Ashikut - Ura e Hardhishtes, duke llogaritur rezerva inertes 28 milion ton, nga te cilat 5 milion ton rere lumi, 20 milion ton inerte te fraksionit 5 - 40 mm dhe 3 milion ton te fraksionit mbi 40 mm (Leka Y. 1983).

**Ne lumin e Tiranes** jane kryer punime te kerkim zbulimit per inerte (zhavorr + rere) ne sektorin nga Ura e Kamzes deri tek ish Kombinati i Mishit ku jane llogaritur rreth 4.8 milion ton, nga te cilat rreth 1 milion ton rere lumi, 3.3milion ton inerte te fraksioneve 5 - 40 mm dhe 0.5 milion ton inerte te fraksioneve mbi 40 mm. Studimi gjeologjik i inerteve shtratin e ketij lumi eshte kryer ne nje gjatesi prej 11 km nga fshati Qereke deri ne Zall Herr (Leka Y. 1983).

**Ne lumin e Terkuzes.** jane kryer punime kerkim zbulimi per inerte (zhavor + rere) ne sektoret Zall Herr - Ura e Tapizes dhe Ura e Tapizes - Fush Rinas ku jane llogaritur rreth 20 milion ton, nga te cilat rreth 3.4 milion ton rere lumi, 15.0 milion ton inerte te fraksioneve 5 - 40 mm dhe rreth 1.6 milion ton inerte te fraksioneve mbi 80 mm (Leka Y. 1983).

**Ne lumin e Zezes** jane kryer punime kerkim - zbulimi midis fshatit Verjon dhe zones ne lindje te Kodres se Verjonit, duke llogaritur rezerva inertesh rreth 1 457 865m<sup>3</sup> (Dhimitri A. 1997).



***Pamje satelitore e nje subjekti qe operon mbi L.Erze. dallohen qarte gropat e medha krijuar nga shfrytezimi pa kriter***

***Ne lumin e Drojes***, studime gjeologjike per vleresimin e inerteve te ketij lumi, nuk jane kryer sepse ne kete lume nuk ka patur inerte te mirefillta per t'u perdorur ne ndertim.

Keto rezerva, sot ne pergjithesi jane shfrytezuar. Shfrytezimi intensiv ka prekur dhe sheshe te tjere.

***Ne lumin e Erzenit*** deri ne vitin 1992 inertet e ketij lumi shfrytezoreshin nga 3 nje inertesh me kapacitet te vogel (Ura e Farkes, Ura e Beshirit dhe Rumanat) per te plotesuar nevojat e ndertimit dhe ato komunale te qyteteve te Tiranës e Durrës. Ky shfrytezim me keto kapacitete te vogla, duke mos arritur te marre mbi 50% te trashesise se inerteve ne zonat ku shfrytezohej, nuk ka prishur ekuilibrat e proceseve dhe dukurive gjeodinamike reliefformuese ne pellgun e lugines se lumit, ne shtratin e sotem te rrjedhjes dhe te lugines se atij apo ne grykederdhjen ne detin Adriatik.

Ne vitet 1992 - 2002 ne gjithë gjatesine e shtratit te lumit nga Iba deri ne Ndroq e Rumanat, eshte kryer dhe po kryhet aktualisht nje shfrytezim intensiv i gjithë trashesise aluviale te shtratit te lumit (zhavor e rere) me mbi 20 nje te fuqishme thyerje - fraksionimi, duke marre te gjitha rezervat statike dhe dinamike te shtratit te lumit (Lleshi B. 2000, 2001).

Ndertimi i diges se ujembledhesit te Skoranes, ka nderprere sjelljen e materialit te ngurte nga zonat e thella malore te Shengjergjit e Qaf- Mollës, duke prishur ekuilibrat e zhvillimit normal te proceseve gjeodinamike ne lugine. Pasojat e ketij shfrytezimi intensiv dhe pa asnje kriter jane: intensifikimi i procesit te erozionit ne luginen ne teresi dhe ne pjesen e shtratit duke shkaktuar mjaft rreshqitje, zhdukje te tokave bujqesore dhe demtime te tjera te objekteve inxhinierike e bujqesore, ulje te nivelit te ujerave nentokesore, shkaterrimi i bimesise dhe ekologjise ne shtratin dhe luginen e lumit etj.

Kjo veprimtari po ndihet dhe ne zonen e grykederdhjes se lumit ne det dhe ne vijen ujendarese bregdetare te kesaj zone me avancim te detit ne drejtim te kontinentit, perrnbytyjen e zonave bregdetare dhe kthimin e tyre ne moçalishte.

Ne lumin e Erzenit nuk ka pothuajse asnje sektor te pashfrytezuat, perveç nje sektori te ngushte, aty ku nderpritet perroi i Arbanes me lumin e Erzenit, qe nuk eshte shfrytezuat per aresyte te cilesise se dobet te inerteve.

**Ne shtratin e lumit te Tiranes** duke qene me afer Tiranes, per te plotesuar nevojat e sektorit te ndertimit dhe te atij publik me rere e zhavor shfrytezimi ka qene me i madh se ne lumin Erzen dhe sasia e rezervave te zbuluara ka qene me e kufizuar. Megjithate deri ne vitet nentedhjte kane funksionuar 3 nyje perpunimi inertesh (Ura e Kamzes, ish uzina e parafabrikateve, ish ndermarrja komunale) me kapacitet te vogel perpunimi. Duke mos shfrytezuat mbi 50% te trashesise se inerteve ne shtratin e lumit nuk ka patur prishje te ekuilibrit te proçeseve gjeodinamike te shtratit te lumit.

Ne vitet 1992 - 2001 depozitimet inerte te ketij lumi ju nenshtruan nje shfrytezimi teper intensiv gjate gjithe gjatesise se rrjedhjes se lumit nga zona ku buron ne (Shpal) ne drejtim te Brarit, megjithese ne kete zone fraksioni i reres eshte minimal ose mungon fare dhe deri tek ura e Karnzes, duke marre te gjithe trashesine e inerteve te shtratit te lumit (Lleshi B. 2000).

Nje shfrytezim i tille pa kriter teknik, pa projekte teknologjike shfrytezimi te karierave apo normave teknike te shfrytezimit, ka shkaktuar prishjen e ekuilibrit te proçeseve gjeodinamike te shtratit dhe te lugines se lumit. Ne luginen dhe ne shtratin e ketij lumi, duke qene dhe shume prane qytetit te Tiranes, jane kryer ne dhjetevjeçarin e fundit shume ndertime banimi pa asnje kriter dhe studim urbanistik duke e kthyer shtratin e tij nga poshte ures se Kamzes deri tek ura e Brarit, ne venddepozitimi te mbetjeve urbane dhe ujrave te ndotura, te cilat po ndotin mjedisin dhe ujerat siperfaqesore e nentokesore te kesaj zone.

Edhe depozitimet e inerteve (zhavorr + rere) te shtratit te lumit te Tiranes, duke qene afer Tiranes, kane terhequr vemendjen per prodhim inertesh edhe para viteve nentedhjte. Deri ne vitin 1992 shfrytezimi i inerteve te ketij lumi kryhej kryesisht me tre linja perpunimi (larje - fraksionim) ne afersi te Tapizes e Çekrezes me prodhim te kufizuar . Ne vitet 1992 - 2002 shfrytezimit te materialit zhavor + rere edhe ne shtratin e ketij lumi i eshte nenshtruar e gjithe shtresa produktive e shtratit ne gjithe gjatesine e lumit nga Zall Herri deri poshte Ures se Tapizes, nepermjet disa impjanteve te perpunimit te ngritur gjate gjithe gjatesise se lumit.

Ndertimi i ujembledhesit te Bovilles e ka nderprere transportin e materialit inert (zhavor + rere) nga pjesa e siperme e rrjedhjes se lumit, keshtu qe edhe rehabilitimi i shtratit te lumit te boshatisur nga inertet e tij nuk mund te behet. Ky shfrytezim intensiv, jashte çdo rregulli, pa projekt teknologjik shfrytezimi, ashtu si edhe ne dy lumenjt e tjere te pellgut te Tiranes, ka shkaktuar prishjen e ekuilibrave gjeodinamike ne luginen dhe shtratin e lumit, duke shkaktuar erozion dhe permbytje te tokave are, demtime te veprave ujemarrese dhe nxjerrjen jashte perdorimit te rezervave te ujrave nentokesore. Keto progrese te erozionit te lumit zhvillohen deri ne det duke patur ndikim dhe zhvillim qe aktualisht shfaqet me rrembim te tokave te zones se plazhit nga deti.

**Ne lumin e Terkuzes** eshte shfrytezuat pothuajse e gjithe sasia e inerteve ne shtratin e tij, nga Pinari deri ne Tapizes, me perjashtim te nje sektori te ngushte ngjitur me arat e fshatit Zall Herr ne te majte te rrjedhjes se lumit.

**Ne Lumi e Zezes** pa u mbeshtetur ne studime, jane ngritur 2 impiante inertesh, pa llogaritur ketu shfrytezimin sporadik ne te gjithe sektoret e lumit nga makina private, te

cilat marrin zhavorr ku te mundin per qellime vetjake. Ky lum eshte praktikisht nje lume ku baza e erozionit ne rrjedhjen e poshtme te tij jane shume prane dhe çdo nderhyrje shfrytezimi ne kete shtrat inertesh do te rinonte dhe me teper aktivitetin gerryes te lumit duke spostuar buzen e erozionit ne drejtim te rrjedhjes se mesme, pra duke riaktivizuar erozionin ne pjeset me te poshteme te tij. Prandaj, shfrytezimi i inerteve ne te tille shpreter nuk duhet bere ne menyre kategorike.

Ne kundershtrim me kete proces natyror, prane fshatit Verjon, aty ku shtrati ka gjeresi me te madhe thellesia e shfrytezimit ka shkuar rreth 2m, ku pervec pjeses se shfrytezuar prej 3 vjetesh, eshte grumbulluar nje depozite e madhe zhavori me material te marre ne vijushmeri te shtratit te lumit, pra duke e shtrire shfrytezimin edhe ne pjese te tjera te tij

Pasoja te ketij shfrytezimi jane intensifikimi i procesit te erozionit kryesisht te tokave bujqesore dhe prishjeve te objekteve inxhinjrike dhe bujqesore. Po keshtu verehet dhe shkaterrimi i i bimesise dhe varferimi i llojeve te ndryshme te gjallesave ne ekosistem.

Ne lumin e Drojes per vete sasine e vogel te inerteve ne afersi te Shperdhetit dhe cilesine e tyre jo te mire per t'u perdorur ne ndertim, (pothuajse mungesa e fraksionit te reres) nuk eshte ngritur ndonje impjant per larjen dhe fraksionimin e saj. Zhavorri i depozituar ne shtratin e ketij lumi u shfrytezua nga nje firme e huaj ne vitin 1996 per tu hedhur ne bazamentin e autostrades Fushe Kruje - Mamurras. Duke u marre e gjithë sasia e zhavorrit deri ne shkembinjte rrenjesore u krijuan kushte per t'u prishur prita e madhe e Shperdhetit ne dimrin e vitit 1997, duke rrezikuar edhe banesat e lagjes Shperdhet, si dhe uren ne rrugen nacionale Fushe Kruje – Laç

## 5.5 Impakti mjedisor nga shfrytezimi i inerteve

Aktiviteti i shfrytezimit te agregateve lumore ne pellgjet e Erzenit dhe Ishmit eshte intensive, edhe pse shfrytezimi i tyre ne keto shpreter eshte i ndaluar me vendimin Nr. 1 Dt. 09.01.2003. (perjashtim nga ky vendim bejne segmentet e veçanta ne lumin Erzen). Ne lumejnte e ketyre pellgjeve jane demtuar pothuajse te gjitha veprat mbrojtese nga keta lumenj. Demtimet me te rendesishme ambjentale mund te permbliidhen si vijon :

***Demtmet e veprave mbrojtese*** te ketyre lumenjeve (me perjashtim te lumit te Tiranes) jane pasoje e shfrytezimit te tyre per nje kohe te gjate.

***Veprat e marrjes se ujit jane jashte funksionit*** (pervecse asaj te Butacit mbi lumin Erzen, ne Ndroq). Ndikim te konsiderushem ne mosfunksionimin e tyre ka edhe ulja e tabanit ne vendet emarrjes se ujit.

Ne te gjitha ***urat konstatohet demtime dhe depozitime mbeturinash***, te cilat duke ndryshuar rrjedhjen ujore ndikojne negativisht ne pjese te veçanta te kembeve te ures. Pergjithesisht e urave te ndertuara mbi lumin Erzen dhe deget e Ishmit jane jo shqetesuese, me perjashtim te ures se Butacit (Erzen), ne te cilin konstatohet nje gerryerje e tokes ne shpatullen e majte te saj.

***Gerryerja e tokes*** ne brigjet e lumenjeve ne keto pellgje lumore jane te ndjeshme dhe problematike sidomos ne Berzhite, Baldushk, Peze Helmes, Romanat (Erzen) etj, Qerkeze, Kamez, Tapize (Terkuze), Shperdhet (Droje).

Ne erozionin e brigjeve te ketyre lumenjeve, ndikim te madh ka luajtur shfrytezimi i materialeve inerte, demtimi i bimesise ne shtratin e tyre si dhe demtimi dhe mos funksionimi i shume veprave mbrojtese te ndertuara ne shpreterit e tyre.



---

Ne keto pellgje ku perfshihen lumenjte Erzen dhe Ishmi ne deget e tij *shfrytezimi i materialeve ineret eshte bere pa kriter* dhe ne menyre shkaterruese (ne veçanti Terkuza), duke bere qe shtrati i tyre te arrij ne formacionin baze, qe do te thote se koha e rigjenerimit te shtreterve te tyre do te jete e gjate.

## 5.6 Vendburimet e objektet e shkembinjte karbonate dhe rezervat

Ne Basenin e Ishem-Erzenit shkembinjte karbonate jane mjaft te perhapur sidomos e vargmalin Kruje-Dajt, strukturen e Makareshit, strukturat e gelqeroreve pllakore te zones se Krastes, me Malin me gropa dhe ne paketat e gelqeroreve litotamnike ne formacionet neogjenike te ultesires PraneAdriatike.

Ne kete basen shkembinjte karbonatike, qe takohen i perkasin zones se Krujes, zones se Krastes dhe zones se Mirdites. Ne Ultesiren Adriatike takohen paketa te gelqeroreve me litotamnia. Te gjithë gelqeroret takohen ne pjesen veri-lindore te basenit.

Gelqeroret e zones se Mirdites perfaqesohen nga gelqerore triasike ne Malin me Gropa. Ne zonen e Krastes ne trajten e nje brezi te nderprere, gelqeroret ndiqen nga Miloti ne veri deri ne Vakumone ne jug. Ata jane pllakore, ne pergjithesi shume te rrudhosura, dhe i perkasin Kretakut te siperm.

Shkembinjte karbonatike te zones se Krujes, jane me te rendesishmit, ndertojne vargmalin e Dajt-Krujes, qe shtrihet qe nga Miloti ne veri deri ne Letan ne basenin e Shkumbinit ne jug. Keta shkembinje karbonate ndertojne dhe strukturen e Makareshit. Ne pergjithesi kemi te bejme me dolomite e gelqeore shtrese trashe te Kretakut te siperm me trashesi mbi 500-600m, dhe ne pjesen e siperm me gelqeore pllakore te Paleocenit dhe Eocenit.

Gelqeroret litotamnike te perhapur ne trajten e nje brezi te ngushte, nga Kruja deri ne Surrel, jane te nje cilesie me te ulet dhe objektet e vendosura mbi to kane rezerva ne pergjithesi me te vogela. Nga ana tjeter ky brez ndodhet ne shpatin jugperendimor te Malit te Dajtit dhe eshte mire te mos shfrytezohet per te mos demtuar pamjen e parkut te Dajtit.

Nga studimet dhe kerkim-vleresimi i bere ne rrethet e Kurbinit, Krujes, Tiranës te basenit te Ishem-Erzenit, nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar, jane evidentuar vendburime dhe objekte te shkembinjeve karbonate, te cilet mund te shfrytezohen per nxjerrjen e inerteve, per plotesimine nevojave te sektorit te ndertimit. Sikurse shihen nga tabela 9 keta ndodhen, tre ne rrethin e Kurbinit, nje ne rrethin e Krujes dhe tete ne rrethin e Tiranës. Tete objektet jane ne gelqeroret dhe gelqeroret e dolomitizuar te Kretakut e Paleogjenit te zones se Krujes. Ata jane vendosur kryesisht ne vargmaline Dajt-Krujes. Kater objekte i perkasin gelqeroreve litotamnike te Neogjenit te Ultesires PranAdriatike. Eshte e nevojshme te theksojme se punimet e kerkim-vleresimit, jane kryer shume kohe me pare dhe nuk kane marre parasysh kerkesat e kohes , per ruajtjen e ambientit dhe bukurise natyrore sidomos te parkut kombtar te Dajtit. Si shembull me tipik mund te permendim objektin e Qaf- Priskës, Shtish –Tufines, Ferrajt etj. Per keto objekte qe vazhdojne te shfryterzohen ne disa raste dhe intesivisht duhet te mendohet te kalohet ne zona perspektive, qe nuk demtojne ambjentin.

Ne basenin e Tiranës ekzistojne te gjitha mundesite per zevendesimin e inerteve lumore , shfrytezimi i te cilave ne te gjithë rrjetin uJOR eshte ndaluar me vendimin e KK dhe KKU, me inerte te nxjerre nga shfrytezimi i shkembinjeve karbonatike me kariera.

Nga objektet e studjuara nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar, jane llogaritur rreth 216.500.000 ton (Tabela 9 e vendburimeve dhe objekteve te gelqeroreve). Por duhet te theksojme se perspektiva per shtimin e rezervave eshte e hapur.

Ne sheshet e licencuara per shfrytezim sipas llogaritjeve aktuale rezervat e gelqeroreve arrijne ne 211.075.052 m<sup>3</sup> (rreth 844.300.000 ton) nga keto rezervat e gelqeroreve te Kretakut dhe Paleocen Eocenit llogariten rreth 172.921.052 m<sup>3</sup> (750.000.000 ton) kurse ato te gelqeroreve litotamnike ne 38.154.000 m<sup>3</sup> (rreth 94 milion ton). Keta te fundit i perkasin kryesisht rrethit te Tiranës.

Pamvaresisht se disa nga objektet e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar dhe sheshet e karrierave jane vendosur pa respektuar kushtet per ruajtjen e ambientit mendojme se ekzistojne te gjitha mundesite per shtimin e rezervave ne objekte te veçante dhe ne mjaft sektore te tjere perspektive . kjo mundet te arrihet me studime e shpenzime te vogla.

Ne basenin e Ishem-Erzenit sidomos ne rrethet e Krujes e Tiranës si sheshe perspektive per nxjerrjen e inerteve karbonatike, duhet te jene sektoret ne shpatin veri – lindor te vargmalit Kruje-Dajt, ne gelqeroret e zones se Krujes, ne gelqeroret pllakore te zones se Krastes dhe gelqeroret litotamnik , sidomos ne sinklinalin e Vrapit.

Tabela 9: **Vendburimet dhe objektet e shkembinjve karbonate ne basenin Ishem–Erzen**

Nr	Vendburimi, objekti,	Rajoni	Lloji mineralit	Përbërja kimike në %				Rezervat Resurset ton	Perspektiva
				CaO	MgO	SiO <sub>2</sub>	Fe <sub>2</sub> O <sub>3</sub>		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1.	Laçit	Kurbin	Gelqeore	54.8 38.35	0.38 14.69	0.15 0.20	0.03 0.34	8380000	E hapur
2	Mamurras	„	„	55.0	0.30	0.76	0.12	68660800	„
3	Droje	„	„	55.1	0.55	0.29	0.04	45494400	„
4	Zall-Fushe-Kruje	„	„	54.9	0.49	-	0.01	5200000	„
5	Ferraj-Babrru	Tirane	Gel.litotam	47.5	0.82	11.3	1.44	>1000000	„
6	Shtish-Tufine	„	„	54.8	0.61	7.80	1.40	6600000	„
7	Zall-Dajt	„	gelqeore	54.5	0.40	0.95	0.22	2444000	„
8	Qaf-Priske	„	„	53.1	0.70	-	0.20	46800000	„
9	Priske	„	„	55.3	0.62	0.26	0.15	>10000000	„
10	Pellumbas	„	„	55.7	0.38	0.23	0.14	>10000000	„
11	Dorez Kule	„	Gel.litoam	52.4	0.76	1.53	-	5940000	„
12	Vrap	„	„	51.3	1.99	1.62	-	5000000	„
13	Totali							>216519200	

*Ne rrethin e Tiranës si sektoret perspektive*, me rezerva potenciale, ne shpatin lindor te malit te Dajtit, jane veçuar: ne Zallher, ne Prisken e Vogel, ne Pashkashesh, kurse ne gelqeroret pllakore te zones Krasta, ne malin e Fekenit dhe ne Gelqeroret triasike te Malit me Gropa ne sektorin e Burimasit.

*Ne rrethin e Tiranës Si sektor perspektiv* per gelqeroret litotamnike eshte veçuar ai ndermjet fshatrave Dorez- Vrap dhe Shenkoll.

*Ne rrethin e Krujes sektor perspektiv* eshte ai ndermjet Mafsheqit e Cudhinit.

### 5.7 Subjektet qe shfrytezojne shkembinjte karbonate

Ne basenin e Ishem - Erzenit per shfrytezimin e shkembinjve karbonatike per inerte dhe prodhimin e gelqeres e çimentos per nevojat e ndertimit, jane hapur nga subjektet private

65 karriera te licensuara dhe te paisura me leje shfrytezimi, nga persona private ose subjekte te palicensuara.

*Ne rrethin e Kurbin* shfrytezimi i gelqeoreve me kariera ka filluar shume heret, para viteve 80-90. Ai ka ardhur duke u intesikuar sidomos kete 10 vjecarin e fundit. Aktualisht shfrytezojne ne kete rreth tre subjekte:

Subjekti "**Lleshi**" me administrator Mehil Lleshin(1) ne afersi te fshatit Delbnisht, shfrytezon nje sheshe me siperfaqe 0.341 km<sup>2</sup> dhe me rezerva 555,750m<sup>3</sup>.

Subjekti "**Met Hasani**"(2) dhe "**Kotica**" (3) me administrator respektivisht Misir Hasanin dhe Frrok Kotecin, shfrytezojne dy sheshe afer Shperdhetit. Sheshet kane siperfaqe respektivisht 0.0055 km<sup>2</sup> dhe 0.0651 km<sup>2</sup> dhe rezerva 109,140m<sup>3</sup> dhe 1,407,295m<sup>3</sup>.

*Ne rrethin e Krujes* shfrytezimi i gelqeoreve ne kariera ka filluar shume perpara viteve 1990 sidomos per prodhimin e cimentos dhe gelqeres. Aktualisht gelqeroret shfrytezojen nga 36 Subjekte te licensuara:

Subjekti "**Alba Inert**" me administrator Abdurrahim Feten(5) shfrytezon nje sheshe ne jug te Borizanes me siperfaqe 0.253 km<sup>2</sup> dhe me rezerva 6,200,000 m<sup>3</sup>.

Subjekti "**Faktory**"(6) dhe "**Shima**" (7), shfrytezojne dy sheshe me siperfaqe 1.195km<sup>2</sup> dhe 0.068 km<sup>2</sup> dhe me rezerva 43,194,258 dhe 1,047,000 m<sup>3</sup>.

Ne rruget Fushe Kruje –Kruje ne te dy anet ne fshatin Kraste – Pengil, verehet nje perqendrim i jashtezakonshem i karrierave ose gropave te hapura me license, nga subjekte te cilat i kane shfrytezuat sidomos per prodhimin e gelqeres. Ne keta sektore me nje siperfaqe rreth 2km<sup>2</sup> jane dhene licensa per 27 firma.

Ne krahu verilindor te rruges ushtrojne aktivitetin e tyre 17 Subjekte: "**Karaj**" (8) "**Xhuljo**" (9) dhe (10), "**I-K-205**"(11), "**Albo-2004**" (12). "**Construction**" (13), "**Kastrioti**" (14), "**Ndertim**" (15), "**Bubasi**" 2 (16), "**Makaresh**" shpk (17), (18), "**Jona**" (19), "**Kurti**" (20), "**Babasi-2**" (21), "**Salillari**" (22), "**Babaj**" (23), "**Loti**" (24), "**Gezim XX**" (25). Keta Subjekti jane licensuar brenda nje siperfaqeje rreth 1 km<sup>2</sup> dhe kane marre leje shfrytezimi per siperfaqe shume te vogla nga 0.005 km<sup>2</sup> deri ne 0.02 km<sup>2</sup> dhe vetem nje rast eshte me siperfaqe 0.98 km<sup>2</sup>. Siperfaqja e pergjithshme e 17 shesheve te licensuara eshte 0.3356 km<sup>2</sup>, kurse rezervat e llogaritura per keto sheshe arrijne ne 11.622.325 m<sup>3</sup>

Ne krahu jugor te rruges ushtrojne aktivitetin 11 Subjekte te licensuara: "**Puka**"(26), "**Santra**"(27), "**Vogli**"(28), "**Santana**" (29), "**Shala**" (30), "**Inert**"200(31), "**Doku**" (32), "**Shehu**" (33), "**Nadi**" (34), "**Selimi**" (35), "**Bakasi**" C00 (36).Licensimi i tyre eshte bere brenda nje siperfaqe rreth 0.5 km<sup>2</sup>. Sheshte e licensuar ne shumicen e rasteve kane siperfaqe rreth 0.005 km<sup>2</sup> d.mth. jane te madhesive 10x50m. Eshte e qarte se ketu eshte punuar kryesisht per prodhimin e gelqeres dhe shfrytezimi eshte bere me gropa, duke demtuar rende ambientin. Siperfaqja e pergjithshme e licensuar per kete sektor eshte 0.2165 km<sup>2</sup> dhe rezervat e pergjithshme arrijne 6,330,539m<sup>3</sup>.

Perqendrimi i madh i licensave te leshuara (27) ne nje sektor te kufizuar dhe sidomos ne rruget per ne qytetin e Krujes, eshte bere pa respektuar kerkesat e mbrojtjes se ambientit. Rinovimi i lejeve nga institucionet perkatese dhe sidomos nga Ministria e Ambientit duhet te behet me shume kujdes duke marre parasysh si demtimet e ambientit nga gropat e shfrytezimit ashtu edhe ndotjet nga furrat e gelqeres.

Rrethit te Krujes i perkasin edhe karrierat e hapura ne afersi te fshatrave Buran dhe Kurcaj nga:

Subjekti "**Bora**" me administrator Elton Mesin (37), shfrytezon gelqeroret litotamnik, ne sheshin ne Vrijon me siperfaqe 0.02 km<sup>2</sup> dhe rezerva 314,086 m<sup>3</sup>.

Subjekti ”**Igli**” me administrator Shkelqim Ranjen (38) ne afersi te Kurcajit ku shfrytezon gelqeroret e kretakut me nje siperfaqe 0.012 km<sup>2</sup> dhe rezerva 179,900 m<sup>3</sup>.

Gelqeroret kretak shfrytezohen edhe nga subjekti ”**Fat-i-er**” (39) ne Koder Vallez ne nje shesh me siperfaqe 0.004 km<sup>2</sup> me rezerva 85,000 m<sup>3</sup>.

*Ne rrethin e Tiranes* shfrytezimi i gelqeroreve sidomos per gure dhe gelqere ka filluar shume kohe me pare. Per gure eshte shfrytezuar kariera e Linzes (gelqerore litotamnik). Mbas viteve 1993-94 shfrytezimi eshte intesifikuar nga subjektet perkatese. Aktualisht per te mbuluar nevojat e sektorit te ndertimit gjithnje ne rritje per inerte dhe lende te para shfrytezohen 26 kariera. Gjate viteve 1994-2000 kane ushtruar veprimtarine e tyre rreth 35 subjekte te tjera te licensuara te cilat sot e kane mbyllur aktivitetin e tyre.

Horizonti i gelqeroreve litotamnik te Ultesires Adriatike ne shtrirjen e tij nga Qinami ne veri deri ne Surrel ne jug shfrytezohe nga 6 subjekte:

Subjekti ”**MC Inerte**” me administrator Mark Sulin (40) shfrytezon nje shesh afer fshatit Kallmet me siperfaqe 0.236 km<sup>2</sup> dhe rezerva 18,102,280 m<sup>3</sup>.

Subjekti ”**Tirana-2**” dhe ”**Ilsa**” (45,46) me administrator Edmond Tole e Saracini, shfrytezojne ne Ferraj e Brar dy sheshe respektive me siperfaqe 0.014 km<sup>2</sup> e 0.018 km<sup>2</sup> dhe rezerva 279.500 m<sup>3</sup> e 375.412 m<sup>3</sup>.

Ne Shtish Tufine gelqeroret litotamnike shfrytezohen nga Subjektet ”**Minatori**” dhe ”**Albmigros**” (48,50) me administrator Nazmi Islamini dhe Haxhi Krashin me dy shesh te afert, respektivisht me siperfaqe 0.011 km<sup>2</sup> dhe 0.015 km<sup>2</sup> dhe rezerva 158,974 m<sup>3</sup> e 184,000 m<sup>3</sup>.

Ne Lanabregas gelqeroret litotamnik shfrytezohen nga Subjekti ”**Miqesia**” me administrator Velika Memushi (51) ne nje shesh me siperfaqe 0.005 km<sup>2</sup> dhe rezerva 87.000m<sup>3</sup>.

Pervec sektorit Qinam-Surrel gelqeroret litotamnike shfrytezohen ne depozitimet Neogjenike te krahut jugperendimor te sinklinalit te Tiranes si dhe ne sinklinalin e Vrapit.

Subjekti ”**Hamit Dyli**” me administrator Çlirim Bashen(62) shfrytezon nje shesh ne Malin e Cirmes, me siperfaqe 0.0307km<sup>2</sup> dhe rezerva 893.946m<sup>3</sup>.

Subjekti ”**Ismaili**” (63) dhe ”**Rimi**”1 (64) me administrator Qamil Ismailin dhe Shyqyri Cara shfrytezojne ne fshatin Dorez dy sheshe respektivisht , me siperfaqe 0.105 km<sup>2</sup>,0.323 km<sup>2</sup> dhe rezerva 442.000 m<sup>3</sup> e 16.979.900m<sup>3</sup>.

Subjekti ”**El-Te-in**” me administrator Fatbardha Sefa (65) shfrytezon nje shesh ne afersi te Vrapit me siperfaqe 0.028 km<sup>2</sup> dhe rezerva 337.075 m<sup>3</sup>.

Ne rrethin e Tiranes gelqeroret e Kretakut te siperme dhe ate Paleocen-Eocenit, shfrytezohen ne 15 kariera gjate shtrirjes se Malit te Dajtit nga perroi i Zallit deri ne Skuterre. Ne kete sektor ushtrojne veprimtarine keta subjekte.

Ne afersi te Zall Herrit ne kater sheshe shfrytezojne Subjektiet ”**Tirana**” (41), ”**Gega**” (42), ”**G.D.E.**” (43) dhe ”**Construction**” (44) me administrator Refik Allushi, Xhemal Gega, Gani Allushi e Ilir Shtufin. Siperfaqet respektive te shesheve jane 0.26 km<sup>2</sup>, 0.075 km<sup>2</sup>, 0.06 km<sup>2</sup> dhe 0.078 km<sup>2</sup> dhe rezerva e tyre 6.881.432 m<sup>3</sup>, 1.074.576 m<sup>3</sup>, 544,497 m<sup>3</sup> dhe 1,777,000 m<sup>3</sup>. Siperfaqja e pergjithshme ne Zall Herr eshte 1,775 km<sup>2</sup> dhe total i rezervave 10,275,505 m<sup>3</sup>.

Subjekti ”**Universal**” me administrator Besim Kuken (47) shfrytezon afer fshatit Brar nje shesh me siperfaqe 0.032km<sup>2</sup> dhe rezerva 315.000m<sup>3</sup>.

Ne Zall Dajt ka shfrytezuar Subjekti ”**Ani**”, e cila ka nderprere veprimtarine e saj. Shesh i kesaj firme ka patur siperfaqe 0.08km<sup>2</sup> dhe rezerva 3.500.000m<sup>3</sup>.

---

Ne sektorin Qaf - Priske Shkalle shfrytezojne me kariera gjashte Subjekte te licensuara.

Subjekti “**Rekord**” me administrator Pellumb Korfuzin (52) shfrytezon nje shesh me sipërfaqe 0.023km<sup>2</sup> dhe rezerva 1.840.500m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Dealka**” me administrator Pirro Qorin (53) shfrytezon nje shesh me sipërfaqe 0.086km<sup>2</sup> dhe rezerva 3.111.000m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Spartaku**” me administrator Bardhyl Resulin (54) shfrytezon nje shesh me sipërfaqe 0.079km<sup>2</sup> dhe rezerva 10.942.400m<sup>3</sup>.

Firma “**M.I.D.-Al**” me administrator Shyqyri Qokun (55) shfrytezon nje shesh me sipërfaqe 0.022km<sup>2</sup> dhe rezerva 1.012.405m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Sina-98**” me administrator Shaban Sinani (56) shfrytezon nje shesh me sipërfaqe 0.052km<sup>2</sup> dhe rezerva 1.465.900m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Roer-Al**” me administrator Haki Ballen (57) shfrytezon nje shesh me sipërfaqe 0.05km<sup>2</sup> dhe rezerva 1.400.000m<sup>3</sup>.

Ne sektorin Qaf Priske-Shkalle 6 subjektet e siperpermendura shfrytezijne nje sipërfaqe 0.312km<sup>2</sup>. Rezervat e llogaritura arrijne 16.613.706m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Adi**” me administrator Adriatik Poshten (58) shfrytezon nje shesh ne afersi te fshatit Murth me sipërfaqe 0.084km<sup>2</sup> dhe rezerva 1.272.238m<sup>3</sup>.

Ne afersi te fshatit Pellumbas dhe Pashkashesh Subjekti “**Best Star**” me administrator Robert Paskon shfrytezon dy sheshe (60,61) me sipërfaqe 0.024km<sup>2</sup> e 0.31km<sup>2</sup> dhe rezerva 7.407.064 dhe 16.000.000m<sup>3</sup> kurse Subjekti “**Sh**” me administrator Artan Dumin (59) shfrytezon nje shesh me sipërfaqe 0.245km<sup>2</sup> dhe rezerva 21.000.000m<sup>3</sup>. Ne basenin e Ishem –Erzenit perveç firmave te liçensuara qe permendem me lart, gelqeroret shfrytezohen dhe nga mjaft persona dhe subjekte te paliçensuara.

Nga tabela 10 shikohet se ne basenin e Ishem –Erzenit aktualisht shkembijne karbonate, shfrytezohen nga 72 subjekte te liçensuara. Nje pjese e ketyre subjekteve shfrytezojne gelqeroret per prodhimin e gelqeres dhe per fabriken e çimentos ne Fushe –Kruje. Per sasite e shfrytezuara nga subjektet mungojne te dhenat e sakta per te bere nje vleresim te plote. Sipas sondazhve te bera mendojme se gjate nje viti shfrytezohen rreth 650.000-700.000 m<sup>3</sup> shkembinj karbonate per prodhim inertesh, gelqereje dhe çimetoje. Kohet e fundit kapacitete e shfrytezimit jane rritur si rezultat i ndalimit te shfrytezimit ne shtreterit e lumenjeve.

Perdorimi i burimeve natyrore te reja per perfitimin e gurit qelqeror per nevojat e sektorit te ndertimit dhe infrastruktures eshte domosdoshmeri he prioritet per ruajtjen e ambientit

Tabela 10: **Subjektet qe shfrytzojne me kariera shkembinjte karbonate ne basenin Ishem- Erzen**

Nr	Rrethi	Emri i subjektit	Vendburimi	Vendodhja e Objektivit	Leja	Date	Mineralitet	Rezervat licensuara	Siperfaqja	Lloji i lejes
1	Kurbini	LLESHI		Afer fshatit Delbnisht	222	18.12.1995	Gelqeror	555,750	0.341	Shfrytezimi
2	Kurbini	MET HASANI	Shperdhjet	Afer fshatit Shperdhjet	627	28.06.2001	Gelqeror	109,940	0.0055	Shfrytezimi
3	Kurbini	KOTICA	Shuls	Afer fshatit Shperdhjet	904	26.08.2005	Gelqeror	1,407,295	0.0651	Shfrytezimi
4	Kruje	DELIA GROUP	Borizane	Afer fshatit Borizane	794	20.08.2004	Gelqeror	12,346,250	0.185	Shfrytezimi
5	Kruje	ALBA INERT	Kodra e Fezes Borizane	Afer fshatit Borizane	756	16.03.2004	Gelqeror	6,200,000	0.253	Shfrytezimi
6	Kruje	F.K CEMENT FACTORY	Zalle	Afer fshatit Borizane	795	08.09.2004	Gelqeror	43,194,258	1.195	Shfrytezimi
7	Kruje	SHIMA	Borizane	Afer fshatit Borizane	798	22.09.2004	Gelqeror	1,047,000	0.068	Shfrytezimi
8	Kruje	KARAJ	Pengile	Afer fshatit Pengile	708	08.07.2003	Gelqeror	17,000	0.005	Shfrytezimi
9	Kruje	XHULJO	Kraste	Afer qytetit te Krujes	540	17.02.2000	Gelqeror	59,532	0.013	Shfrytezimi
10	Kruje	XHULJO	Kraste, Makaresh	Afer fshatit Makaresh	669	18.07.2002	Gelqeror	59,532	0.005	Shfrytezimi
11	Kruje	I - K - 2005	Kraste	Afer fshatit Kraste	916	09.09.2005	Gelqeror	75,200	0.005	Shfrytezimi
12	Kruje	ALBO - 2004	Kraste	Afer fshatit Kraste	900	08.08.2005	Gelqeror	39,316	0.005	Shfrytezimi
13	Kruje	IL - VE - GA Construction	Makaresh	Afer fshatit Makaresh	851	07.04.2005	Gelqeror	22,598	0.005	Shfrytezimi
14	Kruje	KASTRIOTI	Kraste	Afer Krujes	558	24.05.2000	Gelqeror	78,000	0.005	Shfrytezimi
15	Kruje	ART NDERTIM	Kraste	Afer fshatit Kraste	695	26.02.2003	Gelqeror	3,728,066	0.07	Shfrytezimi
16	Kruje	BABASI - 2	Makaresh	Afer fshatit Makaresh	622	28.05.2001	Gelqeror	389,500	0.01	Shfrytezimi
17	Kruje	MAKARESH	Makaresh	Afer fshatit Makaresh	666	5.07.2002	Gelqeror	1,170,000	0.028	Shfrytezimi
18	Kruje	KASTRIOTI shpk	Makaresh	Afer fshatit Makaresh	936	17.04.2006	Gelqeror	364,840	0.02	Shfrytezimi
19	Kruje	XHEMI & JONA	Kraste	Afer fshatit Kraste	917	09.09.2005	Gelqeror	24,700	0.005	Shfrytezimi
20	Kruje	KURTI - HY	Kraste	Afer fshatit Kraste	702	29.05.2003	Gelqeror	659,960	0.023	Shfrytezimi

Perdorimi i burimeve natyrore te reja per perfitimin e gurit qelqeror per nevojat e sektorit te ndertimit dhe infrastrukturës është domosdoshmeri he prioritet per ruajtjen e ambientit

21	Kruje	BABASI - 2	Kraste	Afer fshatit Kraste	899	08.08.2005	Gelqeror	301,215	0.023	Shfrytezimi
22	Kruje	SALILLARI	Fushe-Kruje	Afer fshatit Zgerdhesh	597	01.02.2001	Gelqeror	4,381,376	0.098	Shfrytezimi
23	Kruje	BABAJ	Makaresh	Afer fshatit Makaresh	648	25.09.2001	Gelqeror	28,096	0.005	Shfrytezimi
24	Kruje	LOTI	Makaresh	Afer fshatit Makaresh	894	03.08.2005	Gelqeror	66,500	0.01	Shfrytezimi
25	Kruje	GEZIMI XX	Kraste	Afer fshatit Kraste	841	26.01.2005	Gelqeror	158,000	0.0056	Shfrytezimi
26	Kruje	PRISKA	Hasmuçaj	Afer fshatit Hasmuçaj	874	23.06.2005	Gelqeror	1,841,665	0.047	Shfrytezimi
27	Kruje	SANTARA	Kodra Kraste-Hasmuçaj	Afer fshatit Kraste-Hasmuçaj	872	22.06.2005	Gelqeror	3,272,950	0.0685	Shfrytezimi
28	Kruje	VOGLI	Kraste	Afer fshatit Kraste	631	10.07.2001	Gelqeror	13,565	0.009	Shfrytezimi
29	Kruje	SANTANA		Afer Krujes	418	06.07.1998	Gelqeror	84,959	0.005	Shfrytezimi
30	Kruje	SHALA	Kraste	Afer Krujes	612	26.03.2001	Gelqeror	42,500	0.005	Shfrytezimi
31	Kruje	INERT 2000	Kraste-Hasmuçaj	Afer fshatit Hasmuçaj	671	25.07.2002	Gelqeror	68,600	0.005	Shfrytezimi
32	Kruje	DOKU	Hasmuçaj	Afer fshatit Kraste	681	26.11.2002	Gelqeror	37,040	0.004	Shfrytezimi
33	Kruje	SHEHU	Kraste	Afer Krujes	614	26.03.2001	Gelqeror	50,000	0.005	Shfrytezimi
34	Kruje	NADI	Zidoll	Afer fshatit Halil	616	02.04.2001	Gelqeror	76,900	0.005	Shfrytezimi
35	Kruje	SELIMI	Kraste	Afer fshatit Kraste	682	26.11.2002	Gelqeror	23,260	0.005	Shfrytezimi
36	Kruje	BABASI COO	Kodra Kraste-Hasmuçaj	Afer fshatit Kraste	782	29.07.2004	Gelqeror	97,000	0.058	Shfrytezimi
36	Kruje	LATOMIA TIRANA	Kraste e Ziltes	Afer fshatit Zgerdhesh	926	19.01.2006	Gelqeror	3,646,674	0.09	Shfrytezimi
37	Kruje	BORA	Verjon	Afer fshatit Nikel	724	08.09.2003	Gelqeror	314,086	0.02	Shfrytezimi
38	Kruje	IGLI	Kurçaj	Afer fshatit Kurçaj	781	26.07.2004	Gelqeror	179,900	0.012	Shfrytezimi
39	Kruje	FAT - I - ER	Koder Vallez	Afer fshatit Mukje	736	26.11.2003	Gelqeror	85,000	0.004	Shfrytezimi
40	Tirane	MC INERTE	Faqja e Tremexhes	Afer fshatit Kallmet	592	28.12.2000	Gelqeror	18,102,280	0.236	Shfrytezimi
41	Tirane	XHAJS TIRANA	Herraj Zall Herr	Afer fshatit Zall-Herr	937	18.04.2006	Gelqeror	6,881,432	0.26	Shfrytezimi

Perdorimi i burimeve natyrore te reja per perfitimin e gurit qelqeror per nevojat e sektorit te ndertimit dhe infrastruktures eshte domosdoshmeri he prioritet per ruajtjen e ambientit

42	Tirane	GEGA	Zall-Herr	Afer fshatit Zall-Herr	848	18.03.2005	Gelqeror	1,074,576	0.075	Shfrytezimi
43	Tirane	G.D.E	Zall-Herr	Afer fshatit Zall-Herr	873	23.06.2005	Gelqeror	544,497	0.06	Shfrytezimi
44	Tirane	F. BETON & CONSTRU	Zall-Herr	Afer fshatit Zall-Herr	749	03.02.2004	Gelqeror	1,777,000	0.078	Shfrytezimi
45	Tirane	TIRANA 2	Feraj	Afer fshatit Feraj	562	19.06.2000	Gelqeror	279,520	0.014	Shfrytezimi
46	Tirane	ILSA	Brrare	Afer fshatit Brare	336	03.12.1996	Gelqeror	375,412	0.018	Shfrytezimi
47	Tirane	BESA UNIVERSAL	Komuna Dajtit Brar	Afer fshatit Brare	596	25.01.2001	Gelqeror	315,000	0.032	Shfrytezimi
48	Tirane	MINATORI	Shtish-Tufine	Afer fshatit Shtish-Tufine	341	03.12.1996	Gelqeror	158,794	0.011	Shfrytezimi
50	Tirane	ALBMIGROS	Shtish-Tufine	Afer fshatit Shtish-Tufine	908	01.09.2005	Gelqeror	184,001	0.015	Shfrytezimi
51	Tirane	MIQESIA	Lanabregas	Afer malit te Dajtit	533	05.01.2000	Gelqeror	87,003	0.005	Shfrytezimi
52	Tirane	REKORD	Qafe Priske	Afer fshatit Shkalle	915	07.09.2005	Gelqeror	1,840,500	0.023	Shfrytezimi
53	Tirane	DEALKA	Qafe Priske	Afer fshatit Shkalle	637	01.08.2001	Gelqeror	3,111,500	0.086	Shfrytezimi
54	Tirane	LIVELAD SPARTAKU	Shkalle, Priske	Afer fshatit Shkalle	638	08.08.2001	Gelqeror	10,942,400	0.079	Shfrytezimi
55	Tirane	M.I.D - AL	Qafe Priske	Afer fshatit Priske	549	27.04.2000	Gelqeror	1,012,405	0.022	Shfrytezimi
56	Tirane	SINA 98	Qafe-Priske	Afer fshatit Qafe-Priske	573	05.09.2000	Gelqeror	1,465,900	0.052	Shfrytezimi
57	Tirane	ROER - HL	Qafe-Priske	Afer fshatit Murth	575	05.09.2000	Gelqeror		0.05	Shfrytezimi
58	Tirane	ADI	Priske, Selbe	Afer fshatit Murth	636	30.07.2001	Gelqeror	1,272,238	0.084	Shfrytezimi
59	Tirane	PASHKASHESH	Pashkashesh, Berzhite	Afer fshatit Pashkashesh	598	02.02.2001	Gelqeror	21,000,000	0.245	Shfrytezimi
60	Tirane	BEST - STAR	Pellumbas	Afer fshatit Pellumbas	546	03.04.2000	Gelqeror	7,407,064	0.24	Shfrytezimi
61	Tirane	BEST - STAR	Mali Peshkasheshit Berzhite	Afer fshatit Pellumbas	580	13.11.2000	Gelqeror	16,000,000	0.31	Shfrytezimi
62	Tirane	HAMIT DYLI	Mali I Cirmes	Afer fshatit Mihajas Cirma	803	24.09.2004	Gelqeror	893,946	0.0307	Shfrytezimi
63	Tirane	ISMAILI	Grece-Karaj, Peze	Afer fshatit Peze	587	26.12.2000	Gelqeror	442,000	0.105	Shfrytezimi



Perdorimi i burimeve natyrore te reja per perfitimin e gurit qelqeror per nevojat e sektorit te ndertimit dhe infrastrukturës është domosdoshmeri he prioritet per ruajtjen e ambientit

64	Tirane	RIMI 1	Peze	Afer fshatit Doriz	657	13.05.2002	Gelqeror	16,979,900	0.323	Shfrytezimi
65	Tirane	EL - TE - IN	Baldushk	Afer fshatit Baldushk	720	01.09.2003	Gelqeror	337,075	0.028	Shfrytezimi
66	Kruje	BABASI COO	Kraste	Afer fshatit Kraste	802	23.09.2004	Gelqeror		0.153	Kerkim Zbulimi
67	Tirane	Bajrami	Shtish-Tufine	Afer fshatit Shtish-Tufine	379	10.11.1997	Gelqeror		0.002	Shfrytezimi
68	Tirane	Kuka		Afer malit te Dajtit	409	21.05.1998	Gelqeror	60,057	0.01	Shfrytezimi
69	Tirane	Rekord		Afer Qafe Priskes	407	19.05.1998	Gelqeror	906,179	0.023	Shfrytezimi
70	Tirane	Ani		Afer fshatit Tujamit	416	06.06.1998	Gelqeror	3,500,000	0.08	Shfrytezimi
71	Tirane	A.T.N.B		Afer fshatit Zall-Herr	451	24.02.1999	Gelqeror	5,806,350	0.092	Shfrytezimi
72	Tirane	Ag- Invest		Afer fshatit Dorez	429	08.10.1998	Gelqeror	2,000,000	0.746	Shfrytezimi
<b>TOTALI i REZERVAVE</b>								<b>211,075,052</b>		

## 5.8 Permbledhje dhe rekomandime

Duke u mbeshtetur ne materialet e siperpermendura per inertet e shtreterve te lumenjeve dhe objektet e shkembinjve karbonat si alternativ per zevendesimin e tyre mundet te nxjerrim keto perfundime:

- 1) Licensimi i subjekteve per shfrytezimin e inerteve ne disa raste eshte bere pa respektuar kushtet teknike per mbrojtjen e veprave publike dhe ambientit si dhe duke e perqendruar ne sektore te kufizuare.
- 2) Shfrytezimi shpesh behet pa respektuar projekte teknike dhe sidomos sistemet e shfrytezimit dhe rehabilitimit te ambientit pas shfrytezimit.
- 3) Mungon koordinimi institucional per ushtrimin e nje kontrolli te specializuar dhe penalizimin e subjekteve qe shfrytezojne per moszbatim te projekteve sidomos persa i perket ruajtjes se amjentit dhe ekosistemit natyror.
- 4) Shfrytezimi i inerteve ne pellgjet Ishem-Erzen vazhdon ende nga disa subjekte megjithese eshte ndaluar me vendimin nr.1 date 09.01.2003 dhe urdherit nr.121 date 19.5.2006 te kryeministrit si dhe vendimi nr 1 date 21.06.2006 i Keshillit Kobmetar te Ujit

Si rezultat i shfrytezimit intesiv te inerteve ne sektore te kufizuar te shtreterve te lumenjeve te basenit Ishem-erzen verehen keto pasoja :

- 1) Demtime te veprave mbrojtese, ne argjinatura
- 2) Demtime te veprave ujtese ( si rezultat i uljes se nivelit te lumenjeve)
- 3) Demtime ne shkalle te ndryshme te veprave inxhinierike (urave, etj . ne disa raste nuk eshte respektuar distanca e lejuar nga kembet e ures)
- 4) ulje e nivelit te ujrave nentokesore dhe pakesimi i furnizimit me uje te fshatrave perreth.
- 5) Demtimi i bimesise ne shtratin e lumit
- 6) Gerryerja e tokave eshte e ndjeshme dhe problematike sidomos ne Berzhite Baldushk Pez, Helmes, Romanat (erzen) Çerkez, Kamez Tapize (Terkuze) dhe Shperdhjet (Droje)

Perhapja e shkembinjve gelqerore ne basenin e Ishem- Erzenit dhe rezervat e siguruara ne objektet dhe karrierat ekzistuese si dhe ne sektoret perspektive, sigurojne bazen te nevojshme per zevendesimin e inerteve te shtratit te lumit me inertet e nxjerra nga karriera. Shfrytezimi ne karriera te gelqeroreve siguron vazhdimesi ne kohe. ( dhjetra vjeçare)

– Duhet bashkepunim institucional dhe angazhimi me i madh i Ministrise se Mjedisit ne percaktimin e kriterave per paisjen me leje te shfrytezimit te karrierave te karbonateve duke njerre ne plan te pare ruajtjen e ambientit dhe bukurive natyrore sidomos ne zonat turistike dhe parqet kombetare.

– Shfrytezimi i nje sektori te kufizuar nga disa subjekte, (27-31) nuk ndihmon ne ruajtjen e ambientit, nuk eshte rentabel dhe pengon futjen e teknikave dhe teknologjive bashkekohore si dhe te nje personeli teknik te kualifikuar, per shfrytezimin e gelqeroreve.

– Duhet nje bashkepunim institucional per kontroll rigoroz, nga nje personel i kualifikuar, i zbatimit te projekteve teknike sidomos per hapjen , shfrytezimin dhe rehabilitimin e sektoreve te shfrytezuar

Objektet ekzistuese te shkembijeve karbonate dhe sektoret prespektive kane rezerva per te perballuar te gjitha nevojat ne rritje te sektorit te ndertimit, me lende inerte karbonatike. Problemin kryesor per sigurimin e inerteve nga shkembinjte karbonatike eshte shperndarja ne hapshire e karrierave dhe punimeve per hapjen e tyre, per te mos shkaktuar probleme ne lidhje me ruajtjen e ambientit dhe bukurise natyrore. Ne keto drejtime mendojme se duhet te merren parasysh keto rekomandime:

2. Duhet te behen nderhyrjet e nevojshme ne ligjin minerar nepermjet bashkepunimit institucional ndermjet Ministrise se ekonomise, Industrise dhe Energjitikes dhe Ministrise se Mjedisit. Keto nderhyrje duhet te kene per qellim sakesimin e kushteve per ruajtjen e ambientit dhe bukurive natyrore, gjate dhenies se lejeve per hapje dhe shfrytezimin e karrierave.
3. Nga harta e Basenit Ishem-Erzen duket qarte qe nje pjese e madhe e lejeve per sheshet e shfrytezimit, jane dhene pa marre parasysh demtimet qe shkaktojne hapjet e karrierave ne ambientet dhe peizazhet natyrore. Sot te bejne pershtypje karrierat e medha te hapura ne Qafe Priske, Shish-Tufine, etj.
4. Lejet kryesisht jane dhene per siperfaqe teper te vogla  $0.001 \text{ km}^2$ , qe e thene ne vlera matematikore jane dhene per sheshe me permasa  $10 \times 50 \text{ m}$ . Eshte e qarte se keto sheshe shfrytezohen me gropa, pa asnje sistem shfrytezimi apo projekt shfrytezimi dhe pa bere asnje plan rehabilitimi mjedisor. Ky perqendrim ka lene gjurme te parikuperueshme mund te themi ne drejtim te ambientit. Keshtu ne sektorin Kraste Pengile, gjate rruges nacionale Fushe-Kruje – Ishem-Kruje, jane dhene licenca per 27 subjekte ne nje siperfaqe  $1.5-2.0 \text{ km}^2$ .
5. Pavaresisht se dhenia e lejeve per sheshet e shfrytezimit, shoqerohet dhe me projektin e sistemit te shfrytezimit dhe masa per rehabilitimin e ambientit mbas nderhyrjes ne te, mund te themi me siguri se jane raste shume te rralla kur firmat u permbahen atyre dhe ne pergjithesi nuk zbatohen.
6. Duhet te ngrihen institucione me personel te kualifikuar per te kontrolluar punimet e shfrytezimit me karriera dhe te sakesohen penalitetet ndeshkuese ne rast moszbatimi te projekteve te shfrytezimit dhe rehabilitim.
7. Ne dhenien e lejeve per shfrytezim Ministria e Mjedisit duhet te luaj nje rol me te madh per mbrojtjen e ambientit dhe duke vene veton e saj ne ato raste kur shfrytezimi i karrierave demton ambientin perreth dhe prish ekuilibrat e ekosistemit.

## **Kapitulli i VI**


### **BASENI I SHKUMBINIT**

## 6.1 Karakteristikat gjeografike dhe gjeomorfologjike te lumenjve te basenit

Baseni i Shkumbinit me nje siperfaqe rreth 2450 km<sup>2</sup> pershkrohet nga lumi i Shkumbinit dhe deget e tij. Lumi i Shkumbinit renditet nder lumenjte me te rendesishem te Shqiperise. Ai ka nje gjatesi te pergjitheshme prej 181 km dhe nje pellg ujembledhes prej 2444 km<sup>2</sup>. Ky lume eshte lumi kryesor qe perben basenin e Shkumbinit.

Shkumbini eshte formuar nga bashkimi i dy perrenjve te vegjel, te cilet rrjedhin nga shpatet lindore te Vallamares dhe shpatet perendimore te maleve te Kamjes. Gjate rrjedhjes se tij ne drejtim te Quksit dhe mandej ne Librazhd, Elbasan, Peqin dhe deri ne afersi te Rogozhines, lumit te Shkumbinit i bashkohen mjaft perrenj te madhesive te ndryshme. Nder me kryesoret do te permendim : perroin e Stravajt, ata qe rrjedhin nga masivi i Shebenikut, perroin e Rrapunit, perroin e Gostimes, perroin e Zaranikes, perroin e Krishes, perroin e Paprit e te tjere, te cilet e ushqejne lumin e Shkumbinit me ujra dhe materiale te shumta inerte.

Pjesa me e madhe e pellgut ujembledhes ka relief malor. Rreshjet vjetore arrijne 900-2200 mm. Prurja mesatare e tij eshte 61m<sup>3</sup>/sek. Ne muajt mars-prill rrjedh rreth 15% e rrjedhes vjetore kurse ne muajt gusht rrjedhja eshte 1.2-1.9 e rrjedhes vjetore. Shkumbini eshte nder lumenjte me gerryes te vendit tone. Prurja e ngurte leviz nga 36kg/sek (Murashe) deri ne 180 kg/sek ne Rogozhine.



### *Pamje e pergjithshme satelitore e rrjedhjes se poshteme te lumit Shkumbin*

Lugina e lumit te Shkumbinit ndryshon konfiguracionin e saj nga burimi deri ne rrjedhjen e tij ne detin Adriatik. Keshtu, ne rrjedhjen e siperme lugina eshte e thelle dhe relativisht e gjere. Ndryshimet e lugines jane rrjedhoje e ndryshimeve litologjike dhe strukture. Lugina ben meandrim te diktuar nga karakteristikat e shkembenjve. Ne zonat ku kane predominuar shkembinjte e shkrifet, lugina eshte me e gjere dhe me e shesht.

Shpesh ne keto zgjerime kemi dhe depozitime te materialeve inerte. Pas kalimit te zones malore te Mokres, lugina e Shkumbinit ngushtohet deri ne rrjedhjen e perroit te Rrapunit ku ajo zgjerohet dhe me pas lugina perseri ngushtohet deri ne hyrje te fushes se Elbasanit ne afersi te Labinotit te poshtem. Gjeresia e lugines nga Labinoti i poshtem e deri ne Paper pothuaj se njesohet me fushen e Elbasanit dhe pothuaj se humbet karakterin e nje lugine. Shtrati i lumit te Shkumbinit ne kete sektor zgjerohet dhe meandron. Nga Papri e deri ne Rrogozhine lumi i Shkumbinit futet perseri ne nje lugine, por tashme pak me te gjere se ato para Elbasanit, e kushtezuar kjo nga prania e formacioneve terigjene relativisht te paqendrueshme. Pas Rrogozhines Shkumbini rrjedh neper Ultesiren Pranebregdetare, duke u shendruar ne nje lum tipik fushor, me shtrat te gjere dhe me meandrim te shumta. Pjesa e sipërme dhe e mesme e pellgut ujembledhes te Shkumbinit ka relief te thyer malor. Rrjedhjet jane rreth mesatares se vendit dhe perfaqesohen nga rreshjet e shiut dhe te debores. Prurja mesatare vjetore e Shkumbinit eshte rreth 61.5 m<sup>3</sup>/sek.

Shkumbini ben pjese ne lumenjte me eroziv te Shqiperise. Prurja mesatare shume vjeçare e aluvioneve pezull eshte 187 kg/sek, kurse tullburira 3040 gr/m<sup>2</sup>. Mineralizimi eshte 317 mg/l i perfaqesuar nga bikarbonatet.

Krijimi dhe zhvillimi i rrjetit hidrografik dhe i lugines se Shkumbinit eshte i lidhur para se gjithash me zhvillimin paleogeografik dhe neotektonik i zonave ku kalon ky lum dhe i perket periudhes se fundit te Pliocenit dhe kryesisht asaj te Kuatemarit. Gjate Pleistocenit dhe ne menyre te veçante gjate Holocenit kemi ngritjen e vazhdueshme te zonave lindore te vendit, krijimin e nje rrjeti te dendur perrenjsh, proskash e rrekesh, te cilat kane zhvilluar nje veprimtari te fuqishme gerryese e transportuese ne rrjedhjen e mesme. Zona nga Labinoti deri ne Paper ka qene zone nje zone akumulimi e perrenjve te lumit Shkumbin, gje qe vertetohet nga trashesia e madhe e depozitimeve aluviale te Kuatemarit (rreth 50-70 m) ne fushen e Bradasheshit. Ndersa nga Papri deri ne Rrogozhine territori eshte i ngritur, duke krijuar nje lugine me te ngushte dhe rreth 4 nivele teracash, te cilat nuk i verejme ne teritorin e fushes se Bradasheshit ku teracat jane te varrosura.

Ne rrjedhjen e sipërme dhe te mesme te lumit Shkumbin, kemi patur dhe vazhdon te kete nje gerryerje te fuqishme, e cila eshte kushtezuar nga faktore te tille si : Prania e shkembinjve lehtesisht te gerryeshem deri dhe ne lartesia mbi 800 m. (zona malore e Mokres. Lugina e lumit te Shkumbinit, e kushtezuar nga ndertimi gjeologjik e neotektonik, ka stade te ndryshme zhvillimi. Keshtu nga burimi ne masivin ultrabazik te Vallamares, nga konglomeratet e Gurit te Kamjes e deri ne Mirake lugina eshte e ngushte dhe e thelle ne trajten e gernes "V" te hapur ose te mbyllur, ose ne trajten e kanioneve (Mirake). Kjo pjese e lugines se Shkumbinit, duke perfshire dhe te gjitha perrenjte qe derdhen ne kete lume jane ne fazen e rinise dhe predominojne proceset e gerryerjes ne thellesi. Nga Miraka e deri ne Rrogozhine luginat jane te gjera, asimetrike dhe shpreterit e rrafshet dhe te mbushur me aluvione. Ne zonen e Paprit dhe te Peqinit ruhen mire deri ne kater nivele teracash. Shkumbini ne kete pjese te rrjedhjes se tij, eshte ne fazen e pjekurise. Nga Rrogozhina e deri ne derdhjen e tij ne detin Adriatik Shkumbini eshte ne fazen e pleqerise dhe karakterizohet nga meandrim te shumta dhe depozitim e materialit relativisht te imet (kryesisht rera te kokrizave mesatare dhe te imta).

Element i rendesishem morfologjik i lugines se Shkumbinit eshte zallishtja, e cila eshte formuar kryesisht gjate Holocenit dhe vazhdon dhe ne ditet e sotme. Ne varesi nga lartesia e zallishteve verehen dy nivele : ajo e shtratit dhe ajo e mbishtratit qe shpesh quhet dhe terraca e shtratit. Ne luginen e lumit te Shkumbinit zallishtet me te rendesishme jane ato

te rrjedhjes se mesme qe fillojne nga Miraka e deri ne Rrogozhine duke perjashtuar gryken e Mirakes, ku lugina eshte e ngushte dhe e inkastruar ne shkembinjte flishore te Oligocenit.

## 6.2 Perberja granulometrike dhe litologjike e inerteve

Perberja granulometrike dhe litologjike te inerteve te basenit te lumit Shkumbin ruan disa ligjeshmeri te pergjitheshme, te cilat ndryshojne shpesh duke u varur nga shkembinjte qe u neshtrohen erozionit, si dhe ardhjeve te bolleshme te perrenjeve, qe sjellin material ne konuset e derdhjes ne shtratin e lumit Shkumbin.

Granulometria e inerteve te lumit Shkumbin ndryshon ne pergjithesi gjate rrjedhjes se lumit. Ne rrjedhjen e sipërme mbizoterojne fraksionet e trasha poplore. Ne rrjedhjen e mesme sidomos ne Fushe Labinoti, ne Peqin dhe ne Rrogozhine pakesohet fraksioni zhavorr dhe shtohet ai ranor. Nga studimet e kryera verehet, ndryshimi i fraksionit zhavorr, i cili pakesohet nga Lindja ne Perendim.

Fushe-Labinot e Kraste	fraksioni mbi 5mm ze	68.3%
Ne Uren e Elbasanit	„ „	67.4%,
Ne Peqin	„ „	63.2%
Rrogozhine	„ „	54.5%

Fraksioni ranor ne te kundert ne drejtim Lindje – Perndim rritet. Megjitate duhet te veme ne dukje se ligjeshmeria nderpritet sidomos ne derdhjet e perrenjeve malore, te cilet sjellin mjaft material te trashë te paperpunuar ne shtratin e Shkumbinit.

Ne Fushe-Labinot e Kraste	fraksioni mbi 5mm ze	31.7%
Ne Peqin	«	32.6%
Ne Rrogozhine	«	43.65%

Perberja litologjike e inerteve te lumit Shkumbin, ndryshon gjate rrejedhjes se tij, ne varesi te shkembinjteve qe ndrperet vete lumi dhe deget kryesore te tij. Per perberjen e inerteve ashtu edhe per granulometrine e tij, jane kryer disa studime dhe vrojtime. Keshtu zajet e shkembinjteve magmatike jane me te shumte, e zoterojne ne sektorin Fushe-Labinot, Ura e Elbasanit. Ne Uren e Elbasanit ata zene 56% dhe ne Kraste 45% te mases se zajeve te shtratit te lumit. Ne drejtim te Peqinit ata perbejne vetem 26% dhe ne Sinaballaj vetem 25% te zajeve.

Zajet e karbonateve jane te shumte ne sektorin e Krastes , ku perbejne 45% te zajeve dhe pakesdohen ne drejtim te perendimit ne 30% ne Elbasan dhe 20%ne sektorin e Peqinit. Zajet e shkembinjteve terigjene shtohen nga Lindja ne Perendim nga 10% ne Kraste ne 22% ne Elbasan dhe 37% ne Peqin. Fraksioni ranor ne shtratin e lumit Shkumbin ne afersi te Elbasanit perbehet:

25%	kokrriza kuarci
9%	„ silicoro- kuarcore
28%	„ karbonatike
33%	„ te shkembinjteve te ndryshem (te padeshifruar) dhe agregate argjilore
2.1%	kokrriza te mineraleve metalore.

### 6.3 Vendburimet, objektet dhe sheshet e inerteve qe shfrytezohen nga Subjektet

Ne basenin e Shkumbinit studimet per vleresimin e inerteve te shtreterve te lumenjve jane kryer ne sektoret nga Rogozhina ne Peqin, nga Krasta tek ura e Shkumbinit, ne Labinot Fushe dhe ne degen e Rapunit ne rrethin e Librazhdit. Si rezultat i ketyre punimeve ne objektet e Sinaballajt, Gjoçajt, Çengelajt dhe Rapunit jane llogaritur dhe rezervat e inerteve.

Ne basenin ujqor te Shkumbinit jane ngritur shume objekte te shfrytezimit dhe perpunimit te inerteve te lumit Shkumbin. Aktivitet per shfrytezimin e lumit Shkumbin kane filluar qe ne vitin 1996 dhe si rezultat i rritjes se kerkersave te sektorit te ndertimit jane intesifikuar sidomos duke filluar nga vitit 2003.

Objektet per shfrytezimin e inerteve lumore jane vendosur ne sektorin nga Ura e Shkumbinit deri ne Fushe Labinot. Ato jane te perqendruar sidomos ne afersi te Peqinit nga Kurtaj (3 km ne lindje te Rogozhines) deri ne Grykesh ku kane ushtruar aktivitetin e shfrytezimit nente subjektet e meposhtem:

Subjekti “**ERGENI**” me administrator Çerçiz Juben, ka shfrytezuar objektin ne Karin 6 km ne lindje te Ures se Rogozhines ne Rrethin e Peqinit. Siperfaqja e objektit  $0.186 \text{ km}^2$ , rezervat per shfrytezim  $231,800 \text{ m}^3$ . Ka filluar shfrytezimin me 16.07.2003. Veprimtaria e saj eshte nderprere.

Subjekti “**EUROTEOREMA**” me administrator Giovanni Pascuale ka ushtruar veprimtarine, ne objektin ne Karine ne Rrethin e Peqinit. Siperfaqja e shfrytezimit  $0.275 \text{ km}^2$  rezervat per shfrytezim  $280,000 \text{ m}^3$  ka filluar shfrytezimin me 23.06.2003.

Subjekti “**RE-AL**” me administrator Hysen Malkja, ka ushtruar veprimtarine ne objektin ne afersi te Pojoves ne Rrethin e Peqinit. Siperfaqja e shfrytezimit  $0.06 \text{ km}^2$ , rezervat  $75,000 \text{ m}^3$  ka filluar shfrytezimin me 20.01.2005.

Subjekti “**BELULI**” me administrator Albert Belulin, ka ushtruar veprimtarine ne objektin ne afersi te Peqinit. Siperfaqja e shfrytezimit  $0.28 \text{ km}^2$  rezervat,  $140,000 \text{ m}^3$  ka filluar shfrytezimin me 23.06.2003

Subjekti “**FEBIUS**” me administrator Diell Çelen, ka ushtruar veprimtarine ne objektin ne afersi te Perparimit ne Rrethin e Peqinit.. Siperfaqja e shfrytezimit  $0.14 \text{ km}^2$ , rezervat  $85,000 \text{ m}^3$  ka filluar shfrytezimin me 15.01.2004.

Subjekti “**ZEN-AST**” me administrator Astrit Ferhatin, ka ushtruar veprimtarine ne objektin ne afersi te Shezes ne Rrethin e Peqinit.. Siperfaqja e shfrytezimit  $0.45 \text{ km}^2$ , rezervat  $120,000 \text{ m}^3$  ka filluar shfrytezimin me 13.05.2005.

Subjekti “**RETO**” me administrator Tomorr Hidrin, ka ushtruar veprimtarine ne objektin ne afersi te Shezes Rrethin e Peqinit.. Siperfaqja e shfrytezimit  $0.5 \text{ km}^2$ , rezervat  $101,600 \text{ m}^3$  ka filluar shfrytezimin me 20.01.2005.

Subjekti “**SINANI**” me administrator Fadil Sinanin, ka ushtruar veprimtarine ne objektin ne afersi te Pojoves Peqinit. Siperfaqja e shfrytezimit  $0.51 \text{ km}^2$ , rezervat  $300,000 \text{ m}^3$  ka filluar shfrytezimin me 23.06.2003.

Duhet te veme ne dukje se ne baze te urdherit Nr. 121 date 19.05.2006 te Kryeministrit, deri ne fund te Tetorit te vitit 2006 veprimtaria e te gjitha firmave ne segmentin nga Ura e Autostrades ne Peqin deri ne derdhjen e Shkumbunit ne det duhet te nderpritet. Sipas vendimit te Keshillit Kombetar te ujit Nr. 1 dt. 21.06.2006 ne lumin e



Shkumbinit lejohet ne segmentin nga 500 m mbi Uren e Autostrades, Peqin deri ne rrjedhjen e siperme, me perjashtim te zones se banuar te qytetit te Elbasanit, segmenti qe perfshin koordinatat:

$$\begin{aligned}x_1=4422000, y_1=4551000; \quad x_2=4422000, y_2=4551700; \\x_3=4426000, y_3=4552100; \quad x_4=4426000, y_4=4553000.\end{aligned}$$

Shfrytezimi i inerteve lejohet vetem per periudhen 1 Qershor-31 Tetor te çdo viti.

Nje sektor tjeter ku jane perqendruar objektet e firmave private te licensuar eshte ai qe shtrihet nga Papri ne Fushe Labinot. Nga perendimi ne lindje ne keta sektore ushtrojne veprimtarine njembedhete subjektet e meposhtem:

Subjekti "**AJEK**" me administrator Themistokli Bebin, ka ushtruar veprimtarine ne objektin ne afersi te Muriqanit, Komuna e Cerrikut Rrethi Elbasan. Siperfaqja e shfrytezimit 0.126 km<sup>2</sup> rezervat 250,000 m<sup>3</sup>. Ka filluar shfrytezimin me 23.07.2003.

Subjekti "**TERZIU**" me administrator Ben Terziu, ka ushtruar veprimtarine ne objektin ne afersi te Bradasheshit, te Rrethit Elbasanit. Siperfaqja e shfrytezimit 0.2 km<sup>2</sup> rezervat 370,000 m<sup>3</sup>. Ka filluar shfrytezimin me 15.01.2004.

Po ne Bradashesh ka ushtruar veprimtarine dhe subjekti "**DOKO**" me administrator Arben Dokon. Siperfaqja e shfrytezimit 0.11 km<sup>2</sup> rezervat 136,850 m<sup>3</sup>. Ka filluar shfrytezimin me 04.09.2003.

Subjekti "**EKOBETON**" me administrator Pellumb Koçiasin, ka ushtruar veprimtarine ne objektin ne afersi te Mjeksit, ne Rrethin e Elbasanit. Siperfaqja e shfrytezimit 0.1 km<sup>2</sup>, rezervat 540,000 m<sup>3</sup>. Ka filluar shfrytezimin me 23.06.2003.

Subjekti "**KONSTRUKTEL AS5**" me administrator Agim Polloshin, ka ushtruar veprimtarine ne objektin ne fushe Labinot ne Rrethin Elbasanit. Siperfaqja e shfrytezimit 0.12 km<sup>2</sup> rezervat 679,000 m<sup>3</sup>. Ka filluar shfrytezimin me 10.07.2003.

Subjekti "**KAROLI BLOK**" me administrator Romeo Karoli, ka ushtruar veprimtarine ne objektin ne Labinot fushe ne Rrethin e Elbasanit. Siperfaqja e shfrytezimit 0.15 km<sup>2</sup>, rezervat 420,000 m<sup>3</sup>. Ka filluar shfrytezimin me 05.06.2006.

Subjekti "**PESHTANJI**" me administrator Flamur Gedajni, ka ushtruar veprimtarine ne objektin ne Labinot fushe ne Rrethin e Elbasanit. Siperfaqja e shfrytezimit 0.15 km<sup>2</sup>, rezervat 441,580 m<sup>3</sup>. Ka filluar shfrytezimin me 05.06.2003.

Subjekti "**KRIVA**" me administrator Vasil Janku, ka ushtruar veprimtarine ne objektin ne Labinot fushe ne Rrethin e Elbasanit. Siperfaqja e shfrytezimit 0.066 km<sup>2</sup> rezervat 57,850 m<sup>3</sup>. Ka filluar shfrytezimin me 13.05.2005.

Subjekti "**BAJRAMI**" me administrator N.Bajramin, ka ushtruar veprimtarine ne objektin ne Labinot fushe ne Rrethin e Elbasanit. Siperfaqja e shfrytezimit 0.4 km<sup>2</sup> rezervat 150,000 m<sup>3</sup>. Ka filluar shfrytezimin me 23.06.2003.

Duke u ngjitur drejt rrjedhjes se lumit sasia e materialeve inerte ne shtratin e Shkumbinit pakesohet dhe cilesia e tyre perkeqesohet, ne kete drejtim shfrytezohen vetem dy objekte. nga subjektet "**GJEOD PO**" dhe "**LO-SHI**"

Subjektet "**GJEOD PO**" me administrator Gjulin Polisin shfrytezon nje shesh me siperfaqe 0.074 km<sup>2</sup> dhe rezerva 147.856 m<sup>3</sup> ne lumin e Rapunit, afer derdhjes ne Shkumbin.

Subjekti "**LO-SHI**" me administrator Bajram Loshin shfrytezon nje shesh me siperfaqe 0.0244 km<sup>2</sup> dhe rezerva 36.600 m<sup>3</sup> ne afersi te Qukesit

---

#### **6.4 Rezervat dhe kapacitetet e shfrytezimit te inerteve nga subjektet**

Ne objektet e studjuara nga Sherbimi Gjeologjik jane llogaritur rezervat e inerteve lumore ne sektoret e me poshte: Sinaballaj 695.430 m<sup>3</sup>, Çengelaj 206.750 m<sup>3</sup>, Tarin-Gjoçaj 3.692.454 m<sup>3</sup> dhe Rapun mbi 1.000.000 m<sup>3</sup>

Ne sheshet qe shfrytezohen nga subjektet e licencuara ne Basenin e lumit te Shkumbinit, jane llogaritur dhe rezervat e inerteve, sipas shesheve te shfrytezimit, te cilat paraqiten ne tabelen 11. Problem per rezervat e llogaritura deri tani perbejne vetem sektoret Ura e Rrozhines-fshati Perparim, sektori ne afersi te Elbasanit dhe sektori ne Labinot Fushe, ku jane perqendruar te gjitha subjektet qe shfrytezojne inertet e lumenjeve, per sigurimin dhe plotesimin e kerkesave te sektorit te ndertimit.

Po ti hidhet nje sy Hartes se Basenit te Shkumbinit Overehet se shfrytezimi i inerteve lumore eshte perqendruar ne disa sektore te kufizuar, ne afersi te qendrave te banuara (sektoret Rrogozhine-Peqin dhe Labinot Fushe). Ai ne pergjithesi ka qene intesiv, mbi kapacitetet rigjeneruese, me efekte demtuese per ambientin.

Pervec shfrytezimit intesiv demtimet serioze ne ambient jane pasoje dhe e mos respektimit dhe moszbatimit te projekteve te shfrytezimit dhe masave rehabilituese nga shumica e subjekteve.

Ne tabelen 12 paraqiten kapacitetet e shfrytezimit te inerteve lumore ne teresi dhe te ndare sipas klasave.

Zbatimi i vendimit nr.121 date 19 05 2006 te KK dhe atij nr.1 date 21 06 2006 te Kku do ndikojne ne permiresimin e gjendjes ne shtratin e shkumbinit dhe ndikimet mjedisore.

Tabela 11: Rezervat gjeologjike te inerteve lumore ne basenin e Shkumbinit

Nr	Baseni	Emertimi i subjekteve	Lumi	Komuna	Rrethi	Dt. Shfrytzi	Sip (km <sup>2</sup> )	H(M)	Rez Gjeo M <sup>3</sup>
1	Shkumbin	ERGEN	Shkumbin	Kanine	Peqin	16.07.03	0.15	2	231 800
2	„	EUROTERMA	„	„	„	23.06.03	0.275	2	280.00
3	„	RE-AL	„	Pajove	„	13.05.05	0.06	1	75 000
4	„	BELULI	„	Peqin	„	23.06.03	0.28	2	140 000
5	„	FEBIUS	„	Perparim	„	15.01.04	0.14	1	85 000
6	„	ZEN-AST	„	Sheze	„	13.05.05	0.45	1	120 000
7	„	RETO	„	„	„	20.01.05	0.5	1	101 600
8	„	SINANI	„	Pajove	„	23.06.03	0.51	2	300 000
9	„	AJEK	„	Murqan	Elbasan	23.07.03	0.126	2	250 000
10	„	TEREZIU	„	Bradashesh	„	15.01.04	0.20	2	370 035
11	„	DOKO	„	„	„	04.09.03	0.11	2	136 850
12	„	EKOBETON	„	Shirgjan	„	23.06.03	0.1	2	539 586
13	„	KONSTR.AS	„	Shushice	„	10.07.03	0.12	2	679 000
14	„	KAROLI BLOK	„	Labinot Fushe	„	23.06.03	0.15	2	420 000
15	„	PESHTANI	„	„	„	05.06.03	0.21	2	441 580
16	„	KRIVA	„	„	„	13.05.05	0.066	1	57 850
17	„	BAJRAMI	„	„	„	23.06.03	0.4	2	150 000
18	„	GJEOD-PO	Rapun	Kom.Qender	Librazhd	04.09.03	0.074	2	147 856
19	„	LOSHI	Shkumbin	Qukes	„	13.05.05	0.0244	1	36 600

Tabela 12: Kapacitet e subjekteve qe shfrytetojne inerte lumore ne basenin e Shkumbinit

Nr	EMERTIMI	LUMI	KOMUNA	RRETHI	L_SHFR_DT	KAP_ M3/VIT	H(M)	RERE M3	GRANIL1_ M3	GRANIL2_ M3	ÇAKULL_ M3	ZHAVOR
1	ERGEN	Shkumbin	Karine	Peqin	6/16/2004	20000	2	8500	10500	0	0	0
2	EUROTEOREMA	Shkumbin	Karine	Peqin	6/23/2003	60000	2	25000	25000	0	0	0
4	BEHELULI	Shkumbin	Peqin	Peqin	6/23/2003	20000	2	3500	10500	0	0	0
5	FEBIUS	Shkumbin	Perparim	Peqin	1/15/2004	15000	1	6450	7550	0	0	0
6	ZEN-AST	Shkumbin	Peqin	Peqin	13/05/2005	15000	1					
7	RETO	Shkumbin	Sheze	Peqin	1/20/2005	15000	1	6500	4890	0	0	0
8	SINANI	Shkumbin	Pajove	Peqin	6/23/2003	50000	2	25000	0	0	25000	25000
9	AJEK	Shkumbin	Muriqan	Elbasan	7/23/2003	20000	2	5400	2700	2700	2200	2200
10	TERZIU	Shkumbin	Bradashesh	Elbasan	1/15/2004	20000	1	5400	2700	2700	7600	7600
11	DOKO	Shkumbin	Bradashesh	Elbasan	9/4/2003	20000	2	0	0	0	20000	20000
12	EKOBETON	Shkumbin	Shirgjan	Elbasan	6/23/2003	40000	2	18000	18000	0	0	0
13	KONSTRUKTEL AS-5	Shkumbin	Shushice	Elbasan	7/10/2003	20000	2	8550	10450	0	0	0
14	KAROLI BLOK	Shkumbin	Labinot Fushe	Elbasan	6/5/2003	50000	2	25000	25000	0	0	0
15	PESHTANJI	Shkumbin	Labinot Fushe	Elbasan	6/5/2003	30000	2	95000	19600	0	0	0
16	KRIVA	Shkumbin	Labinot Fushe	Elbasan	5/13/2005	10000	1	4000	5500	0	0	0
17	BAJRAMI "N"	Shkumbin	Labinot Fushe	Elbasan	6/23/2003	15000	2	7500	7500	0	0	0
18	GJEOD Po	Shkumbin	Kom. Qender	Librazhd	9/4/2003	15000	2	8600	5500	0	0	0
19	LOSHI	Shkumbin	Qukes	Librazhd	5/13/2005	6000	1	4000	2000	0	0	0
20	VELLEZRIT HYSA	Shkumbin	Gostime	Elbasan	2/5/2004	50000	1.2	45000	5000	0	0	0
21	LLUCA	Shkumbin	Fatish	Peqin	1/15/2004	30000	1	12500	14500	0	0	0
22	REPAI	Shkumbin	Pajo Sheze	Peqin	1/20/2005	15000	1	6450	7550	0	0	0

## 6.5 Impakti mjedisor nga shfrytezimi i inerteve

Shfrytezimi i inerteve ne shtratin e lumit te Shkumbinit dhe sidomos shfrytezimi intesiv ne disa sektore te tij (Peqin, qyteti i Elbasanit, etj) dhe moszbatimi i kushteve te projekteve gjeologo-minerare per shfrytezimin dhe rehabilitimin e ambjenteve jane shkaqet kryesore per demtimin e mjedisit . Me poshte po rendisim disa nga keto deme:

- Demtimin e veprave mbrojtese ne argjinature, penelat terthore dhe pritat (kryesisht ne Labinot –Fushe, Muriqan Hasmashaj, Kraste, Bradashesh, Pajove, Çërme etj)
- Demtimin e veprave te marrjes se ujit me rredhje te lire ose me ngritje mekanike si rezultat i uljes se nivelit te ujit te shtratit te lumit (nga Krasta ne Elbasan deri ne Divjake)
- Demtimin ne shkalle te ndryshme i urave sidomos ne uren e vjeter te Rrogozhines dhe uren e Cerrikut.
- Demtimin e brigjeve te lumit nga veprimi eroziv qe shprehet me gerryerjen e tokave bujqesore sidomos ne pjesen fushore ne zonat e Labinotit, Shushices, Cerrikut, Muriqanit, Bishqemit, Cengelajt, Peqinit, Sinaballajt, Thanasajt, Çermes, Boshtoves etj.
- Humbjet vjetoore te tokes si rezultat i erozionit ne afersi te Sinaballajt, ne nje sektor rreth 500 ml, jane rreth 23.000 ton. Afersisht po kaq eshte humbja dhe ne Çermen e Siperme.
- Ulja e nivelit te shtratit te lumit si pasoje edhe e nivelit te lumit ne periudhat me pak uje ka shkaktuar renien e nivelit te ujerave nentokesore dhe pakesimin e furnizimit me uje te zonave perreth.
- Demtimin e bimesise ne shtratin e lumit dhe peisazhet perreth si rezultat i shfrytezimit pa kriter dhe mosrehabilitimin gjate dhe pas shfrytezimit.

## 6.6 Vendburimet e objektet e shkembinjve karbonate dhe rezervat

Ne basenin e Shkumbinit shkembenjte karbonatike, te perfaqesuar kryesisht nga gelqeroret, kane perhapje te konsiderueshme ne rrethin e Elbasanit dhe te Librazhdit. Ata i perkasin zonave tektonike te Krujes, Krastes dhe Mirdites. Dalje te vecanta takohen edhe ne depozitimet Neogjenike te Ultesires PranAdriatike .

Ne zonen e Krujes ato perfaqesohen nga gelqeroret e Kretakut te siper dhe te Paleocene Eocenit, qe jane vazhdim i atyre vargmaleve Kruje-Dajt. Ne zonen e Krastes gelqeroret pllakore i perkasin Kretakut te siper dhe jane perhapur ne Kraste dhe ne Labinot - Ceruje.

Ne zonen e Mirdites takohen si gelqeroret shtresore e dolomite te Triasikut te siper - Jurasikut te poshem (Shushice-Derstile, Mirake), gelqeroret shtresore e pllakore te Triasikut te mesem e Jurasikut (Lunik-Klenje) dhe gelqeroret Kretak te Malit te Polisit.

Te gjitha shkembenjte karbonatike, qe permendem, kryesisht gelqerore jane shume te pershtatshem per prodhimin e inerteve, per nevojat e sektorit te ndertimit. Ato mundet te perdoren dhe per prodhimin e cimentos dhe te gelqeres. Perhapja e konsiderueshme e

gelqeroreve, ne afersi te qendrave te banuara perben nje baze te fuqishme per zevendesimin e inerteve te nxjerre nga shtrati i lumenjeve me inerte te shkembinjve karbonatike, te cilet jane edhe te nje cilesise me te mire.

Nga studimi dhe kerkim-vleresimi i bere nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar ne rrethin e Elbasanit dhe te Librazhdit, jane percaktuar shtate vendburime dhe objekte qe mund te perdoren per nxjerrjen e inerteve karbonatike per nevojat e sektorit te ndertimit. Duke perjashtuar objektin e Mirakes, mendojme se shfrytezimi me kariere i ketyre objekteve ndikon shume pak ne prishjen ekuilibre natyrore dhe demtimin e ambientit. Keto ndikime mund te riparohen lehte dhe me shpenzime te vogla nga subjektet qe shfrytezojne.

Ne tabelen 13 te objekteve dhe vendburimeve te gelqeroreve te basenit te Shkumbinit paraqiten shtate objektet e ketij baseni, me rezervat e llogaritura nga sherbimi Gjeologjik.

Nga objektet e studiuara nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar ne rrethet e Elbasanit dhe Librazhdit rezervat e inerteve karbonate arrijne rreth 59,260,000 ton (shiko tabelen 13).

Ne sheshet e karierave qe shfrytezohen, vetem per siperfaqet e vogla te tyre (shumica nen 0.04 km<sup>2</sup>), rezervat e shfrytezueshme arrijne 37,273,770 m<sup>3</sup> ose rreth 92.066.000 ton. (shiko tabelen 13). Keto rezerva qofte te vendburimeve te objekteve, qofte dhe te shesheve te kariera mundet te shumefishohen me studime e shpenzime te vogla.

Pervec objekteve te paraqitura ne tabelat 12 e 13 kemi veçuar edhe disa sektore perspektive me kushte te mira tekniko-ekonomike, me cilesi te mire dhe afer rrugeve kryesore, qe me shpenzime te pakta mund te vihen ne dispozicion te subjekteve per shfrytezim, per te rritur po te jete e nevojshme prodhimin e inerteve nga shkembinjte karbonate.

Sektoret me perspektive jane:

- Shushice-Derstile me gelqeroret e Triasikut te siperm- Jurasikut te poshtem
- Labinot-Cerruje me gelqeroret e pllakore te Kretakut te siperm.
- Letan - Lunik me gelqeroret e Triasikut - Jurasikut .
- Spathare -Dardhe - Qukes me gelqeroret e Kretakut te Polisit.

Rezervat e shkembinjve karbonate ne basenin e Shkumbinit te llogaritura nga studimet e punimet gjeologjike per vendburimet e objektet, nga karierat e hapura si dhe ato prognoze qe mundet te sigurohen nga sektoret perspektive perbejne nje mbeshtetje te fuqishme per zevendesimin e inerteve te shtreteve te lumenjeve me inerte karbonatike. Keto rezerva sigurojne prodhimin e inerteve per disa dhjeteveçare.

Tabela 13: Vendburimet dhe objektet e gelqeroreve ne basenin e Shkumbinit

Nr	Vendburimi, objekti,	Rajoni	Perberja litologjike	Përbërja mesatare kimike %				Rezervat ne ton	Perspektiva
				CaO	MgO	SiO <sub>2</sub>	Fe <sub>2</sub> O <sub>3</sub>		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1.	Letan	Elbasan	Gelqerore	53.50	0.85	0.25	0.10	17.500.000	e hapur
2	Krast e Madhe	Elbasan	Gelqerore	46.50	0.15	2.50	0.48	5.200.000	e hapur
3	Shushica	Elbasan	Gelqerore	51.00	1.70	2.50	0.50	>5.000.000	e hapur
4	Derstile	Elbasan	Gelqerore	53.36	0.80	0.05	0.45	1.560.000	e hapur
5	Mirake	Librazhd	Gelqerore	52.60	1.04	0.1	0.40	>10.000.000	e hapur
6	Dardhe	Librazhd	Gelqerore	53.40	1.02	0.60	0.70	>10.000.000	e kufizuar
7	Bushtrice	Librazhd	Gelqerore	53.00	0.68	0.40	0.70	>10.000.000	e hapur
<b>TOTALI</b>								<b>&gt; 59.260.000</b>	

## 6.7 Subjektet qe shfrytezojne shkembinjte karbonate

Ne basenin e Shkumbinit shkembinjte karbonate shfrytezohen nga 13 subjekte te licensuara. Ne rrethin e Elbasanit jane hapur tete kariera per shfrytezimin e gelqeroreve dhe prodhimin e inerteve dhe cimentos, per sektorin e ndertimit. Keto objekte jane shperndare si me poshte:

Ne objektin e malit te Letanit shfrytezojne subjektet “**Quarriese**” dhe “**IN-EL-2001**”

Subjekti “**Quarriese**” (1) shfrytezon ne afersi te fshatit Letan nje shesh me siperfaqe 0.473 km<sup>2</sup> dhe me rezerva 16,130,522 m<sup>3</sup>.

Subjekti “**IN-EL-2001**” me administrator Shkelzen Madani (2) shfrytezon ne afersi te fshatit Letan nje shesh me siperfaqe 0.033 km<sup>2</sup> dhe me rezerva 769,072 m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Karoli Bloc**” me administrator Romeo Karoli (3) shfrytezon gelqerore pllakore, ne afersi te fshatit Griqan ne nje shesh me siperfaqe 0.056 km<sup>2</sup> dhe me rezerva 1,230,000 m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Iliria**” me administrator Ilir Lçe (4) shfrytezon gelqerore pllakore ne afersi te fshatit Mengel nje shesh me siperfaqe 0.21 km<sup>2</sup> dhe me rezerva 1,234,040 m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Alb-Doni**” me administrator Saliko Jupa (5) shfrytezon gelqerore Triasike ne afersi te fshatit Shushice nje shesh me siperfaqe 0.058 km<sup>2</sup> dhe me rezerva 2,079,000 m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Shqiponja G**” me administrator Gentian Xhelili (6) shfrytezon gelqerore Triasike ne afersi te fshatit Shushice nje shesh me siperfaqe 0.051 km<sup>2</sup> dhe me 1,147,000 m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Ekobeton**” me administrator Pellumb Koçiasi (7) shfrytezon gelqerore litotamnik, ne afersi te fshatit Tudan nje shesh me siperfaqe 0.032 km<sup>2</sup> dhe me rezerva 334,347 m<sup>3</sup>.

Ne rrethin e Librazhdit gelqeroret shfrytezohen me kariera nga 6 objekte te licensuara e te shperndara si me poshte:

Subjekti “**Asfaltimi**” me administrator Zyber Hysa shfrytezon gelqeroret Triasike ne veri te Qarrishtes ne kufi me rrethin e Bulqizes. Sheshi ka siperfaqe 0.0417 km<sup>2</sup> dhe 45,167 m<sup>3</sup> rezerva

Subjekti “**Gega G**” me administrator Dashamir Gegen (9) shfrytezon gelqeroret triasike, ne afersi te Mirakes, ne nje shesh me siperfaqe 0.072 km<sup>2</sup> me rezerva 10,388,420 m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Loshi 1,2**” me administrator Bajram Loshin (10,11) ka shfrytezuar gelqeroret kretake ne dy sheshe, ne afersi te Quksit me siperfaqe respektive 0.67 km<sup>2</sup> (leje e vitit 1999) dhe 0.22 km<sup>2</sup> (leje e vitit 2005) me rezerva totale 2,708,402 m<sup>3</sup>.

Ne Qafen e Thanes ne kufi me rrethin e Pogradecit gelqeroret triasike shfrytezohen nga subjekti “**Kromollari**” me administrator Sallten Kromollari (12-13), ne afersi te fshatit Urake dy sheshe me siperfaqe 0.045 km<sup>2</sup> (12) dhe 0.003 km<sup>2</sup> (13) dhe respektivisht me rezerva 250,000 m<sup>3</sup> e 414.80 m<sup>3</sup>

Ne Basenin e Shkumbinit aktualisht shfrytezojne me karriere gelqeroret 13 subjekte te licensuar. Te dhena te sakta per sasite qe shfrytezojne nuk ka. Sipas sondazheve dhe llogarive te peraferta nga subjektet e mesiperme duhet te shfrytezohen 150 – 200 mije m<sup>3</sup> ne vit.



c

Rrethi	Emri i subjektit	Emertimi vendburimit	Vendodhja e Objektivit	Nr lejes	Date	Lloji Mineralit	Administratori	rrezervat licensuara	Siperfaqja	Lloji i lejes	
1	Elbasan	QUARRIES	Letan	Afer fshatit Letan	922	21.12.2005	Gelqeror		16.130.522	0.437	Shfrytezimi
2	Elbasan	IN - EL - 2001	Letan	Afer fshatit Letan	652	25.10.2001	Gelqeror	Shkelzen Madani	769,072	0.033	Shfrytezimi
3	Elbasan	KAROLI BLOC	Mreshta Madhe	Afer fshatit Griqan	684	09.12.2002	Gelqeror	Romeo Karoli	1,230,000	0.056	Shfrytezimi
4	Elbasan	ILIRIA	Mengel	Afer fshatit Mengel	574	05.09.2000	Gelqeror	Ilir Liçe	1,234,040	0.21	Shfrytezimi
5	Elbasan	ALB - DONI	Shushice	Afer fshatit Shushice	624	13.06.2001	Gelqeror	Saliko Jupa	2,079,000	0.058	Shfrytezimi
6	Elbasan	SHQIPONJA - G	Shushice		722	05.09.2003	Gelqeror	Gentian Xhelili	1,147,000	0.051	Shfrytezimi
7	Elbasan	EKOBETON	Kuqani	Afer fshatit Kuqan	658	15.05.2002	Gelqeror	Pellumb Koçiasi	334,347	0.032	Shfrytezimi
8	Elbasan	RR. URAS ASFALTIM NR.2	Shkemi Isakut, Klenje	Afer fshatit Klenje	860	20.05.2005	Gelqeror	Zyber Hasa	45,167	0.041775	Shfrytezimi
9	Librazhd	GEGA - G	Mirake	Afer fshatit Mirake Planc	667	16.07.2002	Gelqeror	Ismet Gega	10,388,420	0.072	Shfrytezimi
10	Librazhd	LOSHI		Afer fshatit Qukes	435	12.01.1999	Gelqeror	Bajram Loshi		0.067	Shfrytezimi
11	Librazhd	LOSHI BL	Bushtrece	Afer fshatit Qukes	839	21.01.2005	Gelqeror	Bajram Loshi	2,708,402	0.22	Shfrytezimi
12	Librazhd	KROMOLLARI	"Guri Toçkes" Qafe Thane	Afer fshatit Urakel	619	11.05.2001	Gelqeror	Salltem Kromollari	250,000	0.045	Shfrytezimi
13	Librazhd	KROMOLLARI	Qafe Thane	Afer fshatit Urakel dhe Kotodesh	771	28.06.2004	Gelqeror	Sallten Kromollari	414,800	0.003	Shfrytezimi

## 6.8 Permbledhje dhe rekomandime

Nga nje analize me e hollesishme mund te dalin ne keto konkluzione:

Shkalla e studiueshmerise se inerteve te shtratit te lumit Shkumbin ne pergjithesi eshte e larte. Ne basenin e Shkumbinit jane ngritur dhe funksionojne prej dhjetra vitesh, disa impiante perpunimi qe shfrytezojne inertet lumore.

Shfrytezimi ne pergjithsi eshte perqendruar ne sektoret Ura e Rrogozhines-Peqin-fshati Perparim, sektorin ne afersi te Elbasanit dhe sektorin ne Labinot Fushe, ku dhe operojne nje numur i madh subjektesh.

Po ti hedhesh nje sy hartes se shperndarjes te objekteve qe shfrytezohen ne Shkumbin, do te veresh se ne pergjithesi nuk mund te gjesh zona te lira ku nuk merren inertet.. Pra verehet nje shfrytezim intensiv i shtratit te lumit.

Nga vrojtimet e bera nga Ura e Rrogozhines deri ne Labinot Fushe ne lumin e Shkumbinit verehen gropa e ulluqe te krijuara ne shtratin e lumit, te cilat deshmojne per nje shfrytezim intesiv dhe pa kriter prej firmave te licensuara.

Nenvizojme faktin se pjesa dermuese e subjekteve shfrytezuese, e marrin materialin pa zbatuar projektet e shfrytezimit te hartuara per kete qellim, projekte te cilat normalisht garantojne nje shfrytezim ne sasi dhe ne metodike pa ndikime ne mjedis, pa zbatuar masat per rehabilitimin e siperfaqeve te shfrytezuara. Kjo le te kuptohet se mungon nje kontroll i specializuar dhe periodik ne shfrytezimin e inerteve.

Se fundi duhet te theksojme se sot nuk ka organe institucionale, per te kontrolluar ne vazhdimesi respektimin e projektetve teknike qe paraqesin vete keto firma, para se te paisen me licensa si dhe shtrirjen e tyre ne hapesine.

Duke u mbeshtetur ne materialet e siperpermendura per inertet e shtreterve te lumenjeve dhe objektet e shkembinjve karbonate si alternativ per zevendesimin e tyre mundet te nxjerrim keto perfundime:

- licensimi i firmave per shfrytezimin e inerteve lumore ne disa raste eshte bere pa respektuar kushtet teknike per mbrojtjen e veprave publike dhe ambientit si dhe shfrytezimi shpesh behet pa respektuar projekte teknike dhe sidomos sistemet e shfrytezimit dhe rehabilitimit te ambientit pas shfrytezimit.
- mungon koordinimi institucional per ushrimin e nje kontrolli te specializuar dhe penalizimin e subjekteve qe shfrytezojne per moszbatim te projekteve sidomos persa i perket ruajtjes se amjentit dhe ekosistemit natyror.
- si rezultat i shfrytezimit intesiv te inerteve lumore ne sektore te kufizuar te shtreterve te lumenjeve verehen keto pasoja :
  - *demtime te veprave mbrojtese, ne argjinatura*
  - *demtime te veprave ujites ( si rezultat i uljes se nivelit te lumenjeve)*
  - *demtime ne shkalle te ndryshme te veprave inxhinierike (urave, etj . ne disa raste nuk eshte respektuar distanca e lejuar nga kembet e ures)*
  - *ulje e nivelit te ujrave nentokesore dhe pakesimi i furnizimit me uje te fshatrave perreth.*
  - *Demtimi i bimesise ne shtratin e lumit*
- Shfrytezimi me karriera i gelqeroreve siguron ne vazhdimesi per nje kohe te gjate. ( dhjetra bile dhe qindra vjeçare)

- Duhet bashkepunim institucional dhe angazhimi me i madh i Ministrise se Mjedisit ne percaktimin e kriterëve per paisjen me leje te shfrytezimit te karrierve te karbonateve duke nxjerre ne plan te pare ruajtjen e ambientit dhe bukurive natyrore
- duhet nje bashkepunim institucional per kontroll rigoroz, nga nje personel i kualifikuar, i zbatimit te projekteve teknike sidomos per hapjen , shfrytezimin dhe rehabilitimin e sektoreve te shfrytezuar

Ne Basenin e Shkumbinit aktualisht shfrytezojne me kariere gelqeroret 13 subjekte te licensuar. Me ndonje perjashtim (Mirake e Qaf Thane) sheshet e shfrytezimit jane shperndare drejt ne vende ku ndikojne minimalisht ne prishjen e ekuilibrit natyror dhe ndotjes se ambientit.

Sasite e shfrytezuara sot jane te lidhura ngushte me nevojat e sektorit te ndertimit per inerte e materiale te tjera ndertimi. Me ndalimin e shfrytezimit te shtrateve lumenjve, prodhimi mund te rritet lehte me rritjen e kapaciteteve te shfrytezimit ne karrierat egzistuese si dhe me licensimin dhe dhenieve te lejeve te reja per shfrytezimin e gelqeroreve.

Problem kryesor per shfrytezimin e karbonateve ne basenin e Shkumbinit jane:

Ne dhenien e lejeve te reja per shfrytezim pervec aspekteve teknike per hapjen dhe sistemin e shfrytezimit duhet te vihen ne plan te pare dhe kerkesat per mbrojtjen e ambientit, ruajtjen e ekuilibrave dhe bukurive natyrore dhe rehabilitimin e sektoreve te shfrytezuar. Ne ligjin ekzistues minerar duhet qe te perfshihen patjeter dhe kushtet qe kufizojne hapjen e karrierve ne zonat turistike, parqet kombetare, afer qendrave te banuara, etj.

Ne bashkepunim institucional ndermjet Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes dhe Ministrise se Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te ujrave duhet te gjendet zgjidhja e duhur ligjore jo vetem per dhenien e licensave dhe lejeve te shfrytezimit por edhe per kontrollin e subjekteve per realizimin e projekteve per zbatimin e sistemeve te shfrytezimit, per rehabilitimin e sektoreve te shfrytezuar duke parashikuar dhe sanksione per mos respektimin e kerkesave te projekteve.

Subjektet qe shfrytezojne ne pergjithesi karrierat nuk respektojne projektet e hapjes dhe sistemet e shfrytezimit, pa mare asnje mase per rehabilitimin e sektoreve te shfrytezuar. Shume kariera sot kane pamjen e gropave.

## **Kapitulli i VII**

### **BASENI I VJOSES**

## 7.1 Karakteristikat gjeografike dhe gjeomorfologjike te lumenjve te Basenit

Baseni ujqor i Vjoses me nje siperfaqe rreth 4250 km<sup>2</sup> ndodhet ne Shqiperine jugore. Ky basen pershkrohet nga lumenjte e Vjoses, Shushices, Kalases dhe Pavllos. Ne ndarjen e kufijve te baseneve ujqore te Shqiperise, kufiri verior i basenit te Vjoses kalon, pothuajse gjate shtrirjes se tij, sipas lumit dhe vetem ne jug te Permetit, ai shmanget dhe kalon ne veri te Leskovikut, duke perfshire dhe deget e perrenjeve te Çarshoves, Radatit dhe Pobickes. Te gjitha deget e lumenjeve dhe perrenjeve, qe vendosen ne shpatet verilindore te lugines se Vjoses ( lumenjte e Dishnices, Luftinjes, Langarices, Levanit etj) sipas ndarjes se baseneve bejne pjese ne basenin ujqor te Semanit.

Lumi kryesor qe ben pjese ne basenin e Vjoses eshte vete lumi Vjosa i cili eshte dhe lumi me i madh i Shqiperise Jugore. Lumi Vjose ndan krahinen malore jugore te ndertuar nga nje seri vargmalesh me shkembinj karbonatike nga brezi malor flishor i Dangellise dhe atij fushor mollasik te Mallakastres. Eshte lumi me prurje me te shumta ujqore ne vendin tone. Prurjet mesatare vjetore jane nga 54.3 m<sup>3</sup>/sek ne Biovizhde deri ne 195 m<sup>3</sup>/sek ne grykederdhjen e tij. Prurjet sipas stineve ndryshojne 20-40 m<sup>3</sup>/sek ne korrik-tetor dhe 200-400 m<sup>3</sup>/sek gjate stines se dimrit.

Lumi Vjosa mbledh ujqrat e maleve te Pindit ne Greqi ku buron, ujqrat e baseneve nentokesore karbonatike te Nemerçkes, Lunxheri - Buretos, Malit te Gjere, te Rrafshnaltes se Kurveleshit e te krahut lindor te vargut malor te Çikes e Tragjasit ne krahun perendimor dhe ujqrat e krahines Leskovik, Erseke, etj Dangellise, Luftinjes e Mallakastres ne krahun lindor. Deget kryesore te lumit Vjosa jane Drinosi, Shushica, Bença, Lengarica, Ballabani (Lavdari), Luftirje dhe Pavlo.

Lumi Vjosa karakterizohet nga shtrati i stabilizuar dhe nga formimi i disa niveleve te terracave sidomos ne rrjedhjen e siperme te tij nga Tre Urat deri ne gryken e Kelcyres. Nga Kelcyra deri ne Dragot lumi ka shtrat te ngushte e te thelle, ne tarracat e Kalivaçit e Poçemit lumi Vjosa merr karakter te plote fushor me shtratin e hershem, shume te gjere dhe me meandra te shumta te shtratit te sotem. Poshte ures se Mifolit deri ne detin Adriatik ai merr pamjen e nje lumi te lundurueshem me uje te bollshem

Lumi Vjosa permban resurse kolosale te inerteve lumore te fraksioneve te ndryshme. Ne rrjedhjen e siperme deri ne gryken e Dragotit mbizoteron fraksioni i trashe, ndersa rera grumbullohet ne meandrat e lumit. Ne rrjedhjen e mesme deri ne gryken e Poçemit mbizoteron fraksioni mesatar, ndersa ne rrjedhjen e poshtme mbizoteron fraksioni i imet. Poshte Mifolit sedimentohet material i imet ranorik. Perbelja litologjike e reres dhe zhavorit eshte kryesisht karbonatike e ranorike e pak mergelore ne rrjedhjen e poshtme.

Lugina e Vjoses eshte nje nder me te medhate e me te rendesishmet ne vendin tone. Perberja komplekse litologjike shkembore, evolucioni morfologjik e morfogjenetik si edhe levizjet neotektonike kane shkaktuar kontraste midis sektoreve te ndryshem te lugines dhe te vete shtratit te lumit. Formimi i lugines ka filluar qysh ne Pliocen.

Gjeomorfologjia e lumit Vjosa karakterizohet nga elementet perberes te meposhteme:

- Terracat e vjetra
- Terraca e re ose shtrati i vjeter fushor i lumit.
- Shtrati i sotem.

Sedimentet e mesiperme jane transgresive mbi formacionet flishore, karbonatike e mollasike. Vetem ne rrjedhjen me te poshtme ne zonen e Mifolit ndoshta mund te kemi kalim

normal stratigrafik nga mollasat pliocenike detare ne sedimentet kuatemare te deltes ne Vjose. Sipas veçorive morfologjike shtrati i Vjoses ndalet ne pese sektore:

1. Nga kufiri ne Mesare e deri ne Kelcyre
2. Nga Kelcyre deri ne Dragot
3. Nga Dragoti ne Poçem
4. Nga Poçemi ne Mifol
5. Nga Mifoli ne det.

Terracat e lumit Vjosa deshmojne per levizjet neotektonike ngritese te shpatit ne sfond te te gjithë krahines malore jugore. Jane formuar disa nivele terracash. Lumi çan dhe shplan terracen e fundit duke formuar shpate shume te pjerrëta si mur e vende vende edhe te ngushte e te thella disa metra deri ne 10 -15m. Terracat jane formuar pergjate lumit ne te dy krahët nga kufiri ne gryken e Kelcyres por ato takohen me nderprerje edhe ne vende te tjera si ne Majkosh edhe ne shpatet Trevllazen e Varibob - Frakull, ku dallohet terraca e fundit me trashesi deri 25 - 30m. Terracat lumore ruhen e zhvishen me mire pikerisht ne sektorin e pare deri ne Kelcyre, ku dallohen pese nivele terracash te vjetra.


*Ne sektorin e dyte nga Kelcyra ne Dragot* shtrati i Lumit eshte shume i ngushte, shkembor midis formacionit karbonatik - silicor te Jurasikut te siperm deri ne Paleogen. Ketu jane formuar gryka madheshtore si ajo e Kelcyres e Mezghoranit. Ne shtratin e lumit dalin burime te medha si ato te Ujit te Ftohte te Kelcyres dhe "Syri i Zi" i cili del pikersiht ne shtrat te lumit si rezultat i zhvillimit te karstit ne shkembinjte anesore.

*Ne sektorin e trete* nga Dragoti ne Poçem Vjosa ka shtratin e sotem te gjere deri 1 -2 km e te rrafshete, me grumbullime ne meandra e sedimentim ne tere gjeresine e vjeter te shtratit te sasirave te medha te rerave e sidomos zhavoreve. Trashesia e inerteve ne shtratin e vjeter arrin deri ne 60 -80 m ne Kute e Poçem . Sedimentet lumore jane mjaft te zhvilluara sidomos ne krahun e djathte te lugines ne Dragot, Qesarat, Kute, Çorrush e Poçem . Nivelet terracore takohen rralle e me nderprerje kryesisht terraca dyte dhe e trete. Po ne keta sektore gjeomorfologjia e shtratit eshte nderthurur me konet e derdhjes e me depozitimet e shpatit siç jane konet e Luzatit, Bences, Salarise, Povles dhe me depozitimet e inerteve karbonatike te shperbera ne kushte liqenore te Mogilave ne te djathte te lumit ne zonen e Vasjarit. Te gjitha keto deshmojne per origjinen erozionale te lugines dhe per karakter thellues te shtratit te Vjoses.

*Ne sektorin nga Poçemi deri ne Mifol* gjeomorfologjia e shtratit te lumit Vjosa perbehet kryesisht nga dy elemente nga shtrati i gjere i vjeter, si dhe terraca e re. Ne shumicen e rasteve e mbuluar me argjila, toke vegjetale e bimesi duke formuar fusha dhe sedimente te shtratit te sotem te lumit qe meandron ne shtratin e gjere te vjeter. Vetem ne shpatet anesore dallohen te shkeputura mbetje te terracave te vjetra. Ne gjeomorfologjine e shtratit ne kete pjese kane ndikuar edhe perrenjte e shumte si Pavlo, Kalinori ne anen e djathte dhe perroi i Turrbullt, ai i Selenices e lumi i Shushices ne krahun e majte. Ne grykederdhjet e ketyre perrenjve ne Vjose jane formuar sedimente copezore me trashesi te konsiderueshme. Lumi Vjosa nga fshati Ada deri ne Uren e Mifolit (shih figuren ...) pershkon rjedhjen e poshteme te tij. Lugina e lumit paraqitet mjaft e gjere, me nje relief te sheshte e me pende te vogel drejt perendimit. Ne luginen e saj Vjosa dredhon duke krijuar meandrimet te shumta ku spikatin edhe perqendrimet e inerteve. Ky lum ka ndryshuar disa here shtratin e tij duke krijuar vende vende pjese te shkeputura ne trajte ishujsh. Brigjet e

lumit ngrihen nga te dy anet vertikalisht ne nje lartesi qe arrin nga 2-4 m mbi nivelin e tij. Faktoret qe karakterizojne regjimin hidrologjik te lumit Vjosa jane si rezultat i nje bashkeveprimit te kushteve klimatike ne veçorite fiziko-geografike te pellgut ujembledhes.

### *Pamje satelitore te segmentit fshati Ada ura e Mifolit, mbi lumin Vjose*



Duke vene ne evidence prurjet e lumit Vjosa theksojme se kjo ka te beje jo vetem me regjimin e ujrave te tij por edhe ne faktin se keta faktore ndikojne ne sjelljen dhe perqendrimiin e zhavoreve ne shtratin aktual te lumit. Ne sektorin nga Mifoli deri ne det shtrati i Vjoses eshte relativisht i gjere, me faqe vertikale dhe pothuajse teresisht i mbushur me uje. Vetem ne delten e derdhjes ne dete jane formuar ne te dy anet duna, pirqje e kreshta rere te formuara nga bahkepunimi i valeve te detit me rrjedhjen e lumit duke perpunuar me tej prurjet e lumit (shiko figuren e mesiperme).

### **7.2 Perberja granulometrike dhe litologjike e inerteve**

Studimet e perberjes litologjike dhe granulometrike te basenit te lumit Vjosa jane perqendruar kryesisht ne lumin e Vjoses dhe deges se tij, lumit Shushice. Nje permbledhje te ketyre te dhenave po e paraqesim si me poshte.



Granulometria e inerteve te shtratit te Vjoses varion ne varesi te pozicionit nga rrjedhja e siperme deri ne derdhjen ne det duke ruajtur nje ligjesi te pergjitheshme por jo shume te qendrueshme. Ne rrjedhjen e siperme mbizoteron fraksioni i trashe poplor deri ne Kelcyre e me pak ne shtratin e ngushte Kelcyrc - Dragot. Ne rrjedhjen e siperme nga Çarshova ne Petran, Permet takohen ne shtrat edhe popla me permasa gjigande ose shkembinj te medhenj te pa rumbullakosura te rreshqitur nga shpatet anesore.



***Pamje e nje subjekti privat qe shfrytëzon inerte mbi lumin Vjose***

Ne rrjedhjen e mesme nga Dragoti ne Poçem pakesohet fraksioni i trashe poplor dhe shtohet ai mesatar me diameter disa cm. Ne kete pjese ne meandrat e Vjoses sedimentohet edhe rere e imet e material shume i imet. Ne sasira te pakta materiali i imet sedimentohet se bashku me materialin mesatar me raporte me te vogla.

Me tej nga Poçemi ne Mifol shtohet ne shtrat materiali ranorik, i cili me poshte deri ne det edhe mbizoteron. Kjo ligjesi e pergjitheshme nuk ruhet pergjate tere shtratit per aresye se lumenjte e perrenjte sjellin ne Vjose material te trashe te pa perpunuar per aresye te shtrateve te pjerret te tyre dhe rrjedhjes se shpejte. Gjate punimeve fushore per realizimin e ketij studimi jane fiksuar ne disa pika te shtratit te Vjoses raporte granulometrike te meposhtme:

***Tek Ura e Mifolit:***

- Fraksioni 05mm - rreth 20 - 30%
- Fraksioni 05 - 2mm mbizoteron 60 - 70%
- Fraksioni 2 - 5 mm rreth 10%
- Fraksioni mbi 5mm rreth 10 %



**Ne Qesarat te Tepelenes,** para takimit me perroin e Krahasit:

- Fraksioni deri 05mm rreth 2 - 5%
- Fraksioni 05 – 2 mm 5%
- Fraksioni 2 - 5mm 15%
- Fraksioni 5 – 20 mm 20%
- Fraksioni 20 – 60mm 30 - 40%
- Fraksioni mbi 60mm 10%

**Ne Memaliaj,** tek Fabrika e mjellezimit te fosforiteve.

- Fraksioni nen 0.5mm rreth 1-2%
- Fraksioni 0.5 – 2mm 3 - 5%
- Fraksioni 0.5 – 2mm 3 - 5%
- Fraksioni 2 - 5 mm 5 - 8%
- Fraksioni 5 - 20mm 10- 15%
- Fraksioni 20 - 60mm 35 - 45%
- Fraksioni mbi 20mm 10 - 15%

**Ne Majkosh** tek sheshi i shfrytezimit te impiantit ne shtratin e hapur.

- Fraksioni nen 0.5mm rreth 2-3% ne meandren ku shfrytezohet 3 - 5%
- Fraksioni 05 - 2mm 5%
- Fraksioni 2 - 5 mm 5 - 8%
- Fraksioni 5 – 20 mm 10 - 15%
- Fraksioni 20 - 60mm 30 - 40%

**Perberja litologjike e inerteve te lumit Vjosa.** Lumi Vjosa dhe deget e tij pershkojne formacione te shumellojshme gjeologjike prandaj edhe perberja litologjike e rerave dhe zhavoreve eshte shume e larmishme. Ne shtratin e lumit Vjosa mund te gjenden ne te njejtin vend grimca, poplat, guralecat e rera karbonatike e ultrabazike, ranorike e mergelore, silicore e magmatike.

Nga vrojtimit e bera gjate punimeve fushore jane percaktuar ne pergjithesi disa raporte te perberjes litologjike te inerteve te shtratit te lumit Vjosa.

**Ne Uren e Mifolit,**

- Mikat arrijne deri ne 10% te mases se reres se imet,
- Kuarci i bardhe dhe felshpatet arrijne deri 20 - 30%.
- Mergelet 30 - 40%
- Karbonatet kryesisht gelqerore deri 10 - 20% te mases.

**Tek objekti Ura e Poçemit** kemi raportet e meposhtme:

- Karbonatet rreth 60 -70%
- Ranore e mergele 20 - 30%
- Lende silicore - stralle rreth 10% -
- Zajet magnetike 2 - 3%

**Ne objektin e Qesaratit.**

- Karbonatet 70 - 75%
- Masa ranorike mergelore rreth 15%
- Silicor 5 - 10%
- Zajet e grimcat magmatike deri 4 - 5%

**Ne Majkosh:**

- Ne shtratin e sotem aktiv predominon Karbonatet rreth 70 - 75%.
- Material ranor deri 15%
- Materiali silicor rreth 5%
- Materiali magmatik 5%

Ne shtratin e Vjoses me lart drejt Kelcyres e Permetit shtohet materiali magmatik i cili transportohet ne Vjose nga lumi i Lengarices dhe perenjte e tjere qe burojne nga krahina e Ersekës e Leskovikut, ndersa nga krahu i majte, nga shpatet e Nemerçkes - Dhembel - Trebeshinit shpelahen gelqerore e ranoret e flishit, te cilet gjithashtu furnizojne shtratin e Vjoses.

**Perberja granulometrike e inerteve te Lumit Shushice.** Granulometria ndryshon me tendence perpunimi me te plote e imtesimi te materialit nga rrjedhja e siperme drejt rrjedhes te mesme e me tej ,deri ne derdhjen ne Vjose. Por ne disa pjese te shtratit kjo rregullsi priset per aresye te prurjeve te perrenjve anesore e sidomos te prurjeve te lumit te Smokthines dhe perrenjve te Beunit ( i Vajzes) te Brusjes, i cili merr rrjedhje nga Mallkeqi e Amonica, te Skllapit e Vllahines ne krahinen e djathte te Shushices dhe atij te Pishes ne krahun e majte.

Nga vrojtimet ne terren ne disa pika jane shenuar raportet granulometrike te meposhtme:

**Ne meandren e Lapardhase**

- Fraksioni mesatar (rreth 3-5cm diameter) ze rreth 60 - 70%
- Fraksioni i trashe (mbi 5-6cm ) ze rreth 15 - 20%
- Fraksioni imet (me pak se 3 cm) ze rreth 10%

**Ne meandren e Skllapit:**

- Fraksion mesatar rreth 50-60%
- Fraksioni i trashe rreth 15 - 20%
- Fraksioni i imet rreth 15%
- Fraksion shume i imet 5 - 10%

**Ura e Drashovices:**

- Mbizoteron fraksioni mesatar rreth 50%
- Fraksioni i trashe 15 - 20%
- Fraksioni i imet 15 - 20%
- Fraksioni shume i imet rreth 10%

**Ura e Peshkepise:**

- Fraksioni mesatar rreth 60 - 70%
- Fraksioni i trashe 5 - 10%
- Fraksion i imet 10%
- Fraksion shume i imet 10%.

**Perberja litologjike e inerteve te Lumit Shushice.** Perberja litologjike e rerave dhe zhavoreve te lumit Shushice varion ne varesi te fonnacioneve qe lumi nderpret. Keshtu ne perrenjte e rrjedhjes me te siperme deri ne Kuç, takohen popla e zaje gelqerorësh dhe silicoresh. Poshte fshatit Kuç, me formimin e shtratit te qendrueshem lumor ne shtrat megjithe predominimin e litologjise karbonate shtohen edhe grimca e zajet ranorike. Me poshte mbas fshatit Brataj, ne perberjen e shtratit fillojne edhe grimcat mergelore dhe

argjilore mollasike, te cilat deri ne derdhjen ne Vjose shtohen sidomos ne meandrat e lumit. Nga vrojtimit e bera ne terren gjate punimeve fushore ne disa pika te grumbullimit te inerteve jane fiksuar raportet e perberjes litologjike si me poshte:

**Ne meandren e Lapardhase** ku shfrytezohet ne shtratin e lumit

Karbonate 70 - 75% e mases inerte te shtratit.

Ranore rreth 20%

Silicor (stralle) rreth 10%)

**Ne meandren perballe perroit Skllapit**

Karbonate rreth 50%

Ranore rreth 30 -40%

Silicore rreth 10 – 15%

**Ura e Drashovices:**

Karbonate rreth 60 - 70%

Silicore rreth 10% 15%

Ranore rreth

Argjila e mergele - 10%

**Ura e Peshkepise:**

Karbonate rreth 50%

Ranore 20 - 30% Silicore 10

Argjila e mergele 10 - 15%

Nga analizat e kryera mbi cilesine e materialeve inerte te lumenjve te pellgut te Vjoses qe perdoren per ndertime rezulton se materiali inert i ketij baseni ne lumenjte Drino dhe Shushic i ploteson kerkesat e standarteve per ndertim, kjo per faktin se raporti shkemb sedimentar-shkemb magmatik eshte i larte. S SH 504-87, 505-87, 509-87. Ne Shushice e Drinos si rezultat i rruges se shkurter te transportit, raporti i klasave te zhavorit me ato te reres eshte respektivisht 3:1 dhe 4:1.

### 7.3 Vendburimet, objektet dhe sheshet e inerteve qe shfrytezohen nga Subjektet

Ne basenin e Vjoses sot njihen shume objekte te inerteve lumore, te cilet shfrytezohen nga subjekte private te licensuara. Shfrytezimi i inerteve ka filluar nga viti 1996 dhe si rezultat i fuqizimit te sektorit te ndertimit, ka ardhur duke u intesifikuar nga viti ne vit.

Objekte me te shumte dhe me kryesore ndodhen gjate rrjedhjes se lumit te Vjoses, nga Permeti ne Uren e Milotit.

Ne sektoret nga Permeti ne Kelcyre, sot jane ne pune dy impiante me kapacitet te vogel (ne Permet e Kosine) per perpunimin e inerteve, ne te cilen mbizoteron materjali i trashe dhe poplor, per nevojat e kufizuara te ndertimit te rajonit perreth.

Objekte me te rendesishme per shfrytezimin e inerteve lumore te Vjoses takohen vetem mbasi kalon gryken e Kelcyres. Ne sektorin nga Dragoti deri ne Poçem, rekomandohen objektet:

**Objekti i Dragotit** me shtrirje nga fshati Dragot deri ne bashkimin e Vjoses ne lumin e Drinasit.

**Objekti i Majkoshit**, i vendosur mbas derdhjes se lumit te Bençes ne Vjoses deri ne perendim te Damesit. Ky objekt ka permasa te medha inertesh lumore ( $1\ 000\ 000\text{m}^3$ ), por duke qene se kerkesat e qyteteve te Tepelenes e Memaliajt dhe qendrave perreth tyre jane te vogla, impianti i perpunimit te inerteve, i vendosur ketu, prodhon vetem  $10\ 000\text{m}^3$  inerte ne vit.

Nje objekt tjeter perspektiv, me mundesi per te siguruar rezerva te medha inertesh, eshte ai i **Qesaratit** i vendosur ndermjet meandres se Vjoses dhe Qesaratit dhe grykes se perroit te Krahesit. Kerkesat e vogla per lende inerte te kesaj zone, kane bere, qe ne keto objekte te mos kryhen punime kerkim-vleresimi.

Ne lumin e Vjoses nga Poçemi ne Uren e Mifolit, shtrati i Vjoses zgjerohet shume dhe rezervat potenciale per inerte jane te konsiderueshme. Nga Poçemi deri ne Trevllazer mungojne studimet per vleresimin e rezervave. Ky sektor me teper shfrytezohet nga persona e subjekte te pa licensuare, pa impiante, duke perdurur rrjeta dhe sita, duke krijuar stoqe.

Mbas bashkimit ne Lumin e Shushices, ne meandren e Varri i Bobit, gjate vitit 2004 ka shfrytezuar sasira te vogla inertesh subjekti "JONES", i cili nuk ka rinovuar licensen dhe sot me sa duket, ka ndaluar veprimtarine e saj.

Shfrytezimi i inerteve lumore ne lumin e Vjoses eshte perqendruar ne sektorin nga Ada deri ne Uren e Mifolit. Ne kete sektor me gjatesi rreth 6km ne te dy anet e lumit, jane licensuar per shfrytezimin e inerteve subjektet "ALBION" sh.p.k (2 sheshe); "PALMIRI" sh.p.k. (2 sheshe); "INERTE E CO" sh.p.k., "MIFOL INERT" sh.p.k., "DOVAFA" sh.p.k. Tre te parat duke qene se jane ne anen e djathte te lumit, i perkasin Basenit uxor te Semanit, kurse dy firmat e tjera, qe vendisen ne krahun e majte, i perkasin Basenit uxor te Vjoses.

Subjekti "ALBION" me administrator Arjan Llakajn, shfrytezon objektin e inerteve lumore ne zonen e Cervenes, 1.2 km ne lindje te Ures se Mifolit, ne Komunen e Frakulles, te Qarkut te Fierit. Firma administron dhe impiantin per larjen, thyerjen dhe fraksionimin e zhavorreve dhe rerave. Ka marre dy sheshe shfrytezimi me nje siperfaqe te pergjitheshme  $0.46\text{km}^2$ . Rezervat llogariten rreth  $1,000,000\text{m}^3$  inerte. Ka filluar shfrytezimi me 18.08.2003, ka rinovuar lejen ne 2006.

Subjekti "PALMIR" me administrator Perparim Gropen, shfrytezon objektin e inerteve lumore ne lindje te Ures se Mifolit ne Komunen e Frakulles te Qarkut te Fierit. Ndodhet ne gjysmen lindore te meandrit tek Elektropompat, ne grykderdhjen e perroit te Kalinarit. Administron impiantin e perpunimit te inerteve, shfrytezon tre sheshe me siperfaqe te pergjitheshme  $0.28\text{km}^2$ . Rezervat llogariten rreth  $600\ 000\text{m}^3$ . Ka filluar shfrytezimin me 01.09.2003 dhe ka rinovuar lejen ne vitin 2005

Subjekti "INERTE CO" e 2K Grup (Koço Kokdhima) shfrytezon objektin e inerteve lumore ne jug te fshatit Ada, ne anen e djathte te lumit deri tek sheshi i firmes "PALMIR", ndodhet ne Komunen e Frakulles, te Qarkut te Fierit. Siperfaqja e sheshit eshte  $0.182\text{km}^2$ . Rezervat llogariten rreth  $400\ 000\text{m}^3$  inerte. Ka filluar shfrytezimi me 20.12.2003, ka rinovuar lejen me 20.10.2005.

Subjekti "DOVAFAT" me administartor Vasil Furrari e vendosur ne Mifol, ne ish impiantin e ndermarrjes se Bonifikimit, ne Komunen e Novoseles te Qarkut te Vlores. Siperfaqja e marre per shfrytezim eshte  $0.15\text{km}^2$ . Rezervat e llogaritura arrijne rreth  $600\ 000\text{m}^3$  inerte. Shfrytezimi ka filluar qe nga vitet 1990.

Subjekti “**MIFOL INERT**” e vendosur mbi ish piken e shfrytezimit te inerteve nga Ndermarrja Rruga Ura Elbasan, ne komunen e Novoseles te Qarkut te Vlores, shfrytezon sheshin me nje siperfaqe 0.1km<sup>2</sup>. Rezervat e llogaritura rreth 400 000m<sup>3</sup>.

Pervec firmave te mesiperme, qe operojne sot ne sektorin Ura e Mifolit- fshati Ada, subjekti “**ISUFAJ**”, ka marre lejen me 16.05.2006 dhe eshte ne tratativa per te marre lejen e shfrytezimit, per nje shesh me siperfaqe 0.102km<sup>2</sup>. Ky shesh eshte ne zonen e Kashishtit te lumit te Vjose ne komunen e Fralulles te Qarkut te Fierit.

Duhet te veme ne dukje se ne sektorin Ura e Mifolit-fshati Ada, shfrytezimi i inerteve te lumit behet dhe nga persona te tjere te pa licensuar.

Ne lumin e Shushices objektet e inerteve lumore shfrytezohen nga 4 subjekte te licensuara qe poseidojne dhe impiante te perpunimit:

Subjekti “**ERIS VLORA**” shfrytezon objektin e meandres se Lapardhase, ne komunen Kote te Qarkut te Vlores. Sheshi i shfrytezimit ka permasa te vogla (90x700) dhe ze siperfaqe rreth 0.063 km<sup>2</sup>. Rezervat e llogaritura nuk kalojne 100,000 m<sup>3</sup>.

Subjekti “**GJOLEK BUSHI**” shfrytezon objektin e meandrit ne derdhjen e perroit te Skllapit, ne Komunen e Kotes, Qarku Vlore. Siperfaqja e sheshit te shfrytezimit eshte 0.056 km<sup>2</sup>. Edhe ketu rezervat e llogaritura jane te vogla 112,000 m<sup>3</sup>.

Subjekti “**SHUSHICA**” me administrator Gezim Hoxhen, shfrytezon objektin me ane e nje impianti midis Ures se Drashovices dhe Ures se Peshkepise, ne Komunen e Kotes, te Qarkut te Vlores. Sheshi i shfrytezimit, i cili perfshin dhe Uren e Peshkepise, ka nje siperfaqe 0.6km<sup>2</sup>. Rezervat prognoze te llogaritura arrijne deri 6 00 000m<sup>3</sup> inerte. Licensa per shfrytezimi eshte dhene ne vitin 1996.

Subjekti “**SHEHU**” me administrator Perlat Shehun, shfrytezon objektin e shtratit te Lubenjes, ne krahun verior Ures se Peshkepise, ne Komunen e Qender, te Qarkut te Vlores. Impianti eshte vendosur poshte Ures se Peshkepise, ne anen perendimore te lumit, ne afersi te godinave te Thertores, Sheshi i shfrytezimit ka nje siperfaqe prej 1.25 km<sup>2</sup>. Rezervat e llogaritura arrijne deri 1,250,000 m<sup>3</sup> inerte. Leja per shfrytezimi eshte dhene nga Keshilli i Rrethit ne vitin 1995.

Ne rajonin e Peskepise pervec dy firmave (Shushices e Shehu), shfrytezojne inerte, zhavorre dhe rere dhe persona te tjere te palicensuar.

Ne Basenin e Vjoses inertet lumore shfrytezohen edhe ne Lumin e Dukatit nga subjekti “**MEHILLAJ**”, ne Lumin e Kalases nga subjekti “**SHAMETI**” dhe ne Lumin Drinos nga subjektet “**ARGJINI**” dhe “**SCAI**”:

Subjekti “**MEHILLAJ**” shfrytezon inertet ne jug te Orikumit, me nje shesh me siperfaqe 0.25km<sup>2</sup>, qe ndodhet ne Komunen e Orikumit te Qarkut te Vlores. Rezervat e llogaritura jane rreth 300 000m<sup>3</sup> inerte.

Subjekti “**SHAMETI**” shfrytezon inertet e Lumit te Kalases, ne afersi te Finiqit (Komuna e Finiqit ne Rrethin e Delvines). Shfrytezimi behet me nje shesh me siperfaqe 0.018km<sup>2</sup> me rezerva te vogla (rreth 100 000 m<sup>3</sup> inerte).

Subjekti “**ARGJINI**” shfrytezon inertet e Lumit te Drinos ne afersi te fshatit Palokaster ne Komunen me te njejtin emer ne Rrethin e Gjirokasteres. Sheshi shfrytezimit ka nje siperfaqe 0.11km<sup>2</sup>. Rezervat prognoze te llogaritura jane rreth 150 000m<sup>3</sup> inerte. Se fundi ne Lumin e Drinosit shfrytezon inertet dhe subjekti “**SCAI**” me nje shesh 0.08 km<sup>2</sup> me rezerva te llogaritura rreth 160,000 m<sup>3</sup> inerte

Ne tabelen 16 jepen te dhenat e shfrytezimit sipas subjekteve te licensuara. Nderkohe qe eshte e pamundur te evidentohet shfrytezimi i inerteve te lumenjeve nga subjekte pa licence, por duhet te theksojme se ne disa sektore, duke gjykuar nga relievi i krijuar shfrytezimi duhet te jete mjaft intensiv.

Nga vrojtimit e bera pergjate sektorit te Ures se Mifolit, ne lumin Vjosa, dhe ne sektorin e Peshkepise ne lumin e Shushices, liqenet, gropat, ulluqet e krijuara, ne shtratin e ketyre lumenjeve, deshmojne per nje shfrytezim intesiv dhe pa kriter prej firmave te licensuara, pa ndjekur projektet teknike te aprovuara dhe pa respektuar masat per mbrojtjen dhe rehabilitimin e mjedisit. Kjo te le te kuptohet se mungon nje kontroll i specializuar dhe periodik ne shfrytezimin e inerteve.

Per sa i perket shesheve te shfrytezimit, verehen mangesi qe ne paisjen me licensa te subjekteve. Jane licensuar subjekte per shfrytezimin e inerteve ne te dyja anet e veprave inxhinierike si urat. Sheshet e shfrytezimit te inerteve jane perqendruar ne sektore te kufizuar (si ura e Mifolit) pa pasur parasysh demet e mundshme qe mund te shkaktohen ne prishjen e ekuilibrave te ambientit dhe ne sektoret ku jane perqendruar firmat e licensuara, pervec ketyre te fundit operojne ne menyre informale dhe persona private.

Se fundi, duhet te theksojme se sot nuk ka organe institucionale, per te kontrolluar ne vazhdimesi respektimin e projektetve teknike qe paraqesin vete keto subjekte, para se te pajisen me licensa si dhe shtrirjen e tyre ne hapesine.

#### **7.4 Rezervat dhe kapacitetet e shfrytezimit te inerteve nga Subjektet**

Ne sheshet qe shfrytezohen nga firmat e licensuara ne lumenjte e basenit te Vjoses, jane llogaritur dhe rezervat e inerteve te cilat paraqiten ne tabelen 15 (3.472.000 m3). Duhet te kemi parasysh se ne shtratin e e lumit Vjosa, ne sektorin Dragot-Qesarat, jane te gjitha potencialet e mundshme qe te sigurohen rezerva te tjera te reja, ne objektet qe kemi permendur (Dragot, Qesarat etj). Por kerkesat per kete produkt natyror jane shume te kufizuara. Ne sektorin nga Dorzi ne Poçem, mungon infrastruktura per shfrytezimin e inerteve lumore ndaj e ben te pamundur shfrytezimin e ketij sektori per inerte edhe pse rezervat ekzistojne.

Problem per rezervat e llogaritura deri tani perben vetem sektori Ura e Mifolit-fshati Ada, si dhe sheshet ne uren e Peshkepise, ku jane perqendruar te gjitha subjektet qe shfrytezojne inertet e lumenjeve, per sigurimin dhe plotesimin e kerkesave te sektorit te ndertimit.

Ne basenin e Vjoses jane ngritur dhe funksionojne prej dhjetra vitesh, disa impiante perpunimi qe shfrytezojne inertet lumore.

Shfrytezimi ne pergjithsi eshte perqendruar ne afersi te Vlores, kryesisht ne sektorin Ura e Mifolit- fshati Ada, ku dhe operojne gjashte firma. Ne lumin e Shushices, subjektet operojne ne menyre te veçante ne rajonin e Peshkepise « SHEHU » dhe « SHUSHICA ».

Ne sektorin e lumit Vjosa, nga Permeti ne Kelcyre, shfrytezimi eshte i vogel si rezultat i kerkesave te vogla por dhe i cilesise jo te mire te inerteve. Arsye tjeter mbetet dhe sasia e kufizuar e rezervave.

Ne sektorin nga Ura e Mifolit ne Poçem, megjithese ndodhen objekte me rezerva te medha dhe cilesi te mire, shfrytezimi dhe perpunimi i inerteve si rezultat i kerkesave te ulta

te sektorit te ndertimit ne kete zone , eshte shume i ulet ne krahasim me rezervat potenciale qe ekzistojne (objektet e Drqagotit, Majkoshit, Qesaratit).

Mbasi kalon Poçemin, zgjerimi i shtratit te Vjoses, shoqerohet me shtimin e rezervave te mundshme te inerteve lumore. Por ne sektorin nga Poçemi deri ne derdhjen e Shushices, shfrytezimi behet vetem nga persona private dhe firma te vogla te palicensuara.

Edhe shfrytezimi ne lumenjte e Dukatit, Kalase e Drinosit eshte i permasave te vogla.

Ne tabelen nr.16 jepen kapacitetet e shfrytezimit sipas klasave per te gjithë subjektet. Eshte e pamundur te evidentohet shfrytezimi i inerteve te lumenjeve nga subjektet pa liçence, por duhet te theksojme se ne disa sektore, duke gjykuar nga relievi i krijuar, shfrytezimi duhet te jete mjaft intesiv.

Nga vrojtimit e bera pergjate sektorit te Ures se Mifolit, ne lumin Vjosa, dhe ne sektorin e Peshkepise ne lumin e Shushices, liqenet, gropat, ulluqet e krijuara, ne shtratin e ketyre lumenjeve, deshmojne per nje shfrytezim intesiv dhe pa kriter prej firmave te liçensuara, pa ndjekur projektet teknike te aprovuara dhe pa respektuar masat per mbrojtjen dhe rehabilitimin e mjedisit. Kjo te le te kuptohet se mungon nje kontroll i specializuar dhe periodik ne shfrytezimin e inerteve.

Per sa i perket shesheve te shfrytezimit, verehen mangesi qe ne paisjen me liçensa te firmave. Jane liçensuar firma per shfrytezimin e inerteve ne te dyja anet e veprave inxhinierike si urat.

Sheshet e shfrytezimit te inerteve jane perqendruar ne sektore te kufizuar ( si ura e Mifolit) pa pasur parasysh demet e mundshme qe mund te shkaktohen ne prishjen e ekuilibrave te ambjentit. Ne sektoret ku jane perqendruar firmat e liçensuara, perveç ketyre te fundit operojne ne menyre informale dhe persona private.

Se fundi duhet te theksojme se sot nuk ka organet institucionale, per te kontrolluar ne vazhdimesi respektimin e projektetve teknike qe paraqesin vete keto firma, para se te paisen me liçensa si dhe shtrirjen e tyre ne hapësire.

Perdorimi i burimeve natyrore te reja per perfitimin e gurit qelqeror per nevojat e sektorit te ndertimit dhe infrastruktures eshte domosdoshmeri he prioritet per ruajtjen e ambientit

Tabela 15: Rezeravat gjeologjike te inerteve lumore ne basenin e Vjoses

Nr.	Basen	EMERTIMI	LUMI	KOMUNA	RRETHI	DATASHFYT	SIP(KM2)	H(M)	REZ_GJEO M3
1	SEMAN	ALBJON	Vjose	Frakull	Fier	8/18/2003	0.45	0	1.000.000
2	SEMAN	ARGJINI	Drino	Palokast	Gjirokaster	11/27/2004	0.11	1.5	150.000
3	VJOSE	DOVAFAT	Vjose	Novesele	Vlore	4/20/2004	0.15	4	500.000
4	VJOSE	ERIS VLORA	Shushice	Kote	Vlore	4/20/2004	0.12	2.5	100.000
5	VJOSE	GJOLEK BUSHI	Shushice				0.055		112.000
6	SEMAN	INERTE&Co	Vjose	Frakull	Fier		0.1	0	400.000
7	SEMAN	JON	Vjose	Cakran	Fier	12/8/2004	0.053	0	
8	SEMAN	MAJKOSHI	Vjose		Tepelene		0.15		1.000.000
9	VJOSE	MEHILLAJ	L.Dukat	Orikum	Vlore	4/20/2004	0.25	1	300.000
10	VJOSE	MIFOL INERT	Vjose	Novosele	Vlore	4/20/2004	0.1	2.5	400.000
11	SEMAN	PALMIR	Vjose	Frakull	Fier	9/1/2003	0.28	0.2	500.000
12	VJOSE	SCAI	Drino	D.Posht	Gjirokaster	11/27/2004	0.08	2	150.000
13	VJOSE	SHAMETI	Kalase	Finiq	Delvine	4/20/2004	0.018	1	150.000
14	VJOSE	SHEHU	Shushice	Qender	Vlore	8/19/2003	0.2	2	1.250.000
15	VJOSE	SHUSHICA	Shushice	Vllahine	Vlore	4/20/2004	0.12	0	500.000



Perdorimi i burimeve natyrore te reja per perfitimin e gurit qelqeror per nevojat e sektorit te ndertimit dhe infrastruktures eshte domosdoshmeri he prioritete per ruajtjen e ambientit

**Tabela 16: Kapacitetet e subjekteve qe shfrytezojne inerte lumore ne basenin Vjose**

Basen	EMERTIMI	LUMI	KOMUNA	RRETHI	KAP.M3/VIT	S_MIR_5VJET	H(M)	RERE M3	GRANIL1_M3	GRANIL2_M3	ÇAKULL_M3	ZHAVOR
SEMAN	ALBJON	Vjose	Frakull	Fier	80000	0.46	0	80000	0	0	0	0
SEMAN	PALMIR	Vjose	Frakull	Fier	60000	0.28	0.2	60000	0	0	0	0
SEMAN	JON	Vjose	Cakran	Fier	0	0.053	0	4500	6300	7200	0	0
SEMAN	INERTE&Co		Vjose	Frakull	44000			27000	5000	12000		
VJOSE	SHEHU	Shushice	Qender	Vlore	60000	0.2	2	30000	15000	15000	0	0
VJOSE	MEHILLAJ	L.Dukat	Orikum	Vlore	40000	0.25	1	20000	10000	10000	0	0
VJOSE	ERIS VLORA	Shushice	Kote	Vlore	50000	0.12	2.5	36000	9000	5000	0	0
VJOSE	SHAMETI	Kalase	Finiq	Delvine	10000	0.018	1	3000	3000	0	0	0
VJOSE	DOVAFAT	Vjose	Novesele	Vlore	100000	0.15	4	60000	15000	15000	0	0
VJOSE	SHUSHICA	Shushice	Vllahine	Vlore	60000	0.12	0	26000	17000	17000	0	0
VJOSE	MIFOL INERT	Vjose	Novosele	Vlore	50000	0.1	2.5	24000	13000	13000	0	0
VJOSE	ARGJINI	Drino	Palokast	Gjirokaster	20000	0.11	1.5	10000	5000	5000	0	0
VJOSE	SCAI	Drino	D.Posht	Gjirokaster	20000	0.08	2	10000	5000	5000	0	0
VJOSE	MAJKOSHI		Vjose		10000			10000				
VJOSE	GJOLEK BUSHI		Shushice									

## **7.5 Impakti mjedisor nga shfrytezimi i inerteve**

Ne lumin e Vjoses dhe ate te Shushices behet nje shfrytezim intesiv i inerteve te shtratit te lumit, sidomos keto vitet e fundit.

Perqendrimi i shfrytezimit ne sektorin, Ura e Mifolit-fshati Ada ne lumin e Vjoses dhe ne uren e Peshkepise ne lumin e Shushices dhe mos zbatimi i projekteve teknike gjeologo-minerare dhe kerkesave te lejeve per rehabilitimin e ambientit jane shkaqet kryesore per demtimin e mjedisit. Keto demtime konsistojne ne:

- Krijimi i liqeneve, gropave dhe ulluqeve te thelle, ne shtratin e lumenjve sidomos ne sektorin Ura e Mifolit-Ada, Uren e Peshkepise etj.

- Demtimi i veprave mbrojtese ne argjinaturat mbrojtese(kryesisht ne segmentet Drinos-Odrie, Hekal Selishte Hambar, Uren e Mifolit-Ada, uren e Peshkepise etj)

- Demtimin e veprave ujtese (me ngritje mekanike ose rrjedhje te lire) ose nxjerrjen jashte perdorimit te tyre si rezultat i thellimit te shtratit te lumit.

- Demtimin ne shkalle te ndryshme i urave ne lumenjte Shushice, Vjose, Drinos, dhe Bistrice. Ketu mundet te permendim Uren e Peshkepise te ciles i kane dale themelet si rezultat i shfrytezimit te inerteve ne rrjedhen e Shushices mbi te dhe poshte saj.

- Ne sektoret me shfrytezim intesiv brigjet e lumenjve i jane nenshtruar nje erozioni te fuqishem, i cili ka pasoja negative ne gerryerejn e tokave bujqesore. Ne lumin Shushice (Peshkepi, Armen dhe Llakatund) ne Vjose (Varibob, Trevllazer, Mifol, Bishan etj)

- Ulja e nivelit te shtratit te lumit si pasoje edhe nivelit te ujit, sidomos ne periudhen me prurje te vogel, ka shkaktuar dhe uljen e nivelit freatik pjezometrik te shtresave ujembajtese te zonave fushore rreth tyre. Kjo situatë do te shkaktoje pakesimin e nxjerrjes se ujerave nentokesore.

- Demtimi i bimesise egzistuese ne shtreterit e lumenjve dhe peisazhit per rreth, si pasoje e shfrytezimit pa kriter te inerteve lumore dhe mos rehabilitimi i zones gjate dhe pas shfrytezimit.

## **7.6 Vendburimet e objektet e shkembinjve karbonate dhe rezervat**

Ne basenin e Vjoses shkembinjte karbonatike, sidomos ata gelqerore kane prhapje shume te madhe. Ato formojne prerje te fuqishme (1000-1500 m) dhe ju perkasin moshave:

- Triasik i Siperin (Dukat-Pilur, Vermik-Ftere, e Karkadhiq-Delvine)
- Jurasik i Poshtem e te Siperin (ne strukturat e Çikes, Tragjasit, Fterres, Malesise se Kurveleshit, Malit te Gjere, Butrintit, Bogazit,etj)
- Kretakut, ne malin e Karaburunit, ne strukturat qe permendem me lart dhe ato te Sarandes, Vagalatit, Qesaratit, Nemerçkes e Dhembelit.)
- Gelqeroret e Paleocen-Eocenit, mbyllin prerjet e te gjitha strukturave qe kemi permendur deri tani me lart.

Ne pergjithesi mundet te themi se te gjithë shkembinjte karbonatike qe permendem jane te pershtatshem per prodhimin e lendeve inerte per nevojat e sektorit te ndertimit dhe ne shume raste dhe per prodhimin e çimentos dhe gelqeres. Shkembinjte karbonatike ne Basenin e Vjoses, mbulojne pak me shume se gjysmen e siperfaqes te basenit. Ata perbejne nje baze te fuqishme per prodhimin e lendeve inerte per ndertim, shume me cilesore ne krahasim me ato te nxjerra nga shtreterit e lumenjeve.

Nga studime dhe kerkim-vleresimi i bere ne rrethet e Vlores, Sarandes, Delvines, Permetit dhe Tepelenes, te cilat jane pjese e basenit te Vjoses, jane evidentuar rreth 26 vendburime dhe objekte gelqeroresh qe mundet te perdoren per nxjerrjen e inerteve per plotesimin e nevojave per ndertime dhe infrastrukture. Por duhet nenvizuar se mjaft nga keto punime kerkim-vleresimi jane bere mjaft vite me pare dhe nuk kane marre parasysh kerkesat e sotme ne lidhje me ruajtjen dhe respektimin e ambientit, bukurive natyrore, gjeomonumenteve, ekosistemit etj, sidomos kjo persa i perket Rivieres shqiptare , nga Vlora ne Butrint. Si te tille mund te permendim objektet ne radhime, Llogara-Palase, Dhermi, Vuno, Qafe gjashte, Çuke etj. Keto objekte sipas mendimit tone nuk duhet te konsiderohen si rezerva potenciale per tu perdorur per shfrytezim. Disa nga keto objekte gelqeroresh pllakore te Paleocen\_eocenit shfrytezohen per nxjertjen e pllakave te mermerit per ndertime arkitektonike (trashesia e tyre arrin ne 15-30 cm)

Perhapja e madhe e shkembinjëve karbonate ne Basenin e Vjoses siguron rezerva te mjaftueshme per shfrytezimin e tyre, per nje periudhe shume te gjate. Rezervat jane ne gjendje te zevendesojne inertet lumore ne sektorin e ndertimit dhe te plotesojne kerkesat gjithmone ne rritje te ketij sektori.

Ne objektet e studjura nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar ne rrethin e Vlores jane llogaritur mbi 60 milion ton rezerva te gurit gelqeror (shiko tabelen 17), kurse nga karrierat dhe rezervat e licensuara per shfrytezim keto rezerva arrijne ne 85 milion ton. Ne rrethet e Tepelenes, Permetit dhe Gjirokastrës, ne objektet e studjuara nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar jane llogaritur mbi 45.8 milion rezerva kurse ne sheshet e karrierave te licensuara rezervat e shfrytezueshme arrijne ne rreth 3.8 milion m<sup>3</sup>. Por duhet vene ne dukje se karrierat shfrytezohen kryesisht gelqerore pllakore per prodhimin e pllakave. Ne rrethet e Sarandes e Delvines nga objektet e studjuara nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar jane llogaritur mbi 23 milion ton rezerva, kurse ne sheshet e karrierave te licencuara rezervat e shfrytezueshme arrijne ne rreth 55,306,791 m<sup>3</sup> (tabela 18).

Pervec vendburimeve e objekteve kryesore qe paraqiten ne tabelen 17 dhe rezervave gjeologjike te llogaritura per secilin prej tyre, duhet te permendim se ekzistojne dhe shume sektore perspektive per te siguruar te gjitha rezervat e nevojshme per zevendesimin e te gjitha sasive te inerteve qe merren nga shpreterit e lumenjeve , me materiale inerte nga shfrytezimi i shkembinjëve karbonatike.

#### **Si sektore perspektive mund te veçojme:**

Per rrethin e Vlores

- sektorin ne Gjorm
- sektori ndermjet Mazhar-Sevasteri-Dorez

Per rrethin e Gjirokastrës

- sektorin Kolonje-Golem etj.

dhe per rrethin e Sarandes

- sektorin Memoraq-Dhiver
- sektorin Bistrice-Krongji

Sigurisht qe per keta sektore ka nevojte te kryhen studime nga institucionet e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar.

Duhet te theksojme dhe njehere se rezervat e paraqitura ne tabelen e objekteve te karbonateve te basenit te Vjoses dhe tabelat e karrierave qe shfrytezohen ne territoret e rrethet qe bejne pjese ne kete basen, me studime e shpenzime te vogla mund te shumefishohen.

Shumefishimi mund te behet qofte ne objektet dhe karrierat ekzistuese, qofte dhe ne sektoret prespektive qe jane permendur me pare.

**Tabela 17: Vendburimet dhe objektet e shkembinjve karbonate ne basenin e Vjoses**

Nr	Vendburimi, objekti,	Rajoni	Perberja litologjike	Përbërja mesatare kimike %				Rezervat ne ton	Perspektiva
				CaO	MgO	SiO <sub>2</sub>	Fe <sub>2</sub> O <sub>3</sub>		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1.	Drashovice	Vlore	gelqerore	53.0	0.4	1.5	0.31	>10 000 000	e hapur
2	Kanine	Vlore	“	56.0	0.36	0.47	0.35	>10 000 000	“
3	Radhime	Vlore	“					>3 000 000	
4	Orikum	Vlore	“	55.8	0.25	0.01	0.10	>5 000 000	e hapur
5	Karaburun	Vlore	“	54.5	0.30	0.10		> 10 000 000	
6	Dukat	Vlore	“					>10 000 000	“
7	Gjorm	Vlore	Dolomit	38.00	14.6	0.9	0.34	> 10 000 000	“
8	Dorez	Vlore	Gelqerore	52.9	0.76	1.57	0.10	>10 0000000	“
9	Turhan	Tepelene	“					>10 0000000	“
10	Bençe	Tepelene	“					>4 000 000	“
11	Kelcyre	Permet	Gel pllakore	51.2	1.25	0.7	1.60	1 400 000	e kufizuar
12	Progonat	Tepelene	“	54.50	0.16	0.45	0.25	2 600 000	e hapur
13	Picar	Gjirokaster	“					>10 000 000	“
14	Derviçan	Gjirokaster	“	51.0	1.20	0.6	0.40	5 200 000	“
15	Grash	Gjirokaster	“	54.5	0.1	0.3	0.8	>10 000 000	“
16	Jorgucat	Gjirokaster	“	53.0	1.60	1.50	0.10	2 600 000	“
17	Dhrovjan	Delvine	Gelqeror	54.6	0.46	0.21	0.1	5 000 000	“
18	Q.Gjashte	Sarande	“					>10 000 000	
19	Çuke	Sarande	Gel pllakore	54.00	0.27	0.85	0.20	2 600 000	“
20	Shkalle	Sarande	Gel pllakore	53.7	0.22	0.82	0.1	1 560 000	“
21	Muzine	Delvine	“	45.60	0.35	6.5	0.32	2 600 000	“
<b>TOTALI</b>								<b>&gt; 60 milion</b>	

## 7.7 Subjektet qe shfrytezojne shkembinjte karbonate

Ne Basenin e Vjoses gelqeroret shfrytezohen nga 39 subjekte private te licencuara por duhet te veme ne dukje se ka dhe mjaft persona private qe ne menyre abuzive shfrytezoje gelqeroret pa marre licence.

Ne rrethin e Vlores shfrytezimi i gelqeroreve me karriera ka filluar qe ne vitin 1994 (Ndermarrja Asfaltim Rruge). Gjate viteve 1995-1999 eshte shtuar deri ne 13 numri i subjekteve qe shfrytezonin shkembinjte karbonatike, por sot nje pjese e mire e tyre kane nderprere aktivitetin (Asfaltim – rruga, Eurocement, Aquater etj)

Aktualisht ne kete rreth nga subjekte private jane hapur 13 karriera te shperndara si me poshte:

Ne objektin e Drashovices shfrytezojne gelqeroret e Paleocen-Eocenit me sheshe te vecante subjektet “**Nacional**” (1) me administrator z. Gani Alushaj; “**Sevast**” (2) me administrator z. Gramoz Haxhijaj; “**Shushica**” (3) me administrator z. Gezim Hoxha; “**I sh.p.k**” (4) me administrator z. Ridon Leskaj. Rezervat e llogaritura per te kater sheshet jane 15,280,000 m<sup>3</sup> ( rreth 36,400,000 ton).

Ne jug te Kanines shfrytezon subjekti “**Hytal**” (5) me administrator z. Altin Hyseni. Rezervat e llogaritura ne kete shesh jane 1,594,883 m<sup>3</sup>

Ne veri te Radhimes shfrytezojne gelqeroret e Jurasikut te poshtem subjekte “**Alba**” (6) me administrator z. Albert Bukurin. Ketu ka shfrytezuar dhe subjekti “**Alliaj**” me administrator z. Elmaz Alliaj te cilit i eshte hequr licenca. Rezervat e te dy shesheve jane llogaritur afersisht rreth 3,200,000 m<sup>3</sup>

Ne jug te Orikumit shfrytezohen gelqeroret kretake te Karaburunit. Ketu operojne subjekti “**Mehillaj**” (7) me administrator z. Tanush Mehillaj. Legalisht ketu kane shfrytezuar dhe subjektet “**S.I.A.V konstruksion**” (8) me administrator z. Apostol Qirko dhe subjekti “**Comercier**” (9) me administrator z. Castelo Gaetano te cilat aktualisht nuk disponojne leja shfrytezimi. Rezervat net e tre sheshet llogariten 8,000,000 m<sup>3</sup>

Ne sektorin Dhermi-Himare shfrytezohen gelqeroret e Jurasik-Kretakut nga subjektet “**Alfa**” (10), afer fshatit Ilias me administrator z. Koço Balen dhe “**FH**” (11) , afer fshatit Vishe me administrator z. Ferat Hasaj. Rezervat e llogaritura jane respektivisht 3.185.175 m<sup>3</sup> dhe 1.076.873 m<sup>3</sup>.

Se fundi ne rrethin e Vlores ne afersi te Kudhesit shfrytezohen gelqeroret e Eocenit nga subjekti “**Zoto-ZZ**” (12) me administrator z. Leonard Zoto.

Ne rrethin e Tepelenes pavaresisht nga perhapja mjaft e madhe e shkembinjeve karbonate, per shkak te kerkesave te kufizuara te sektorit te ndertimit ne kete rreth, shfrytezimi me karriera i gelqeroreve te Kretakut behet vetem nga dy subjekte:

Subjekti “**Cobial**” (13) me administrator z. Flamur Pazajn. Ai eshte pozicionuar afer fshatit Bençe dhe subjekti “**Besnik Koçi**” (14) me administrator z. Perparim Koçin i cili eshte afer fshatit Luzat. Rezervat e llogaritura ne sheshet e shfrytezimit jane te vogla (afersisht 280.000 m<sup>3</sup>) por ekzistojne te gjitha potencialet qe sheshet te zgjerohen dhe rezervat te shumefishohen.

Rrethi i Tepelenes furnizohen me inerte te shkembinjeve gelqerore dhe nga subjektet “**Vjosa V**” dhe “**Boka Axxh**” qe ushtrojne aktivitetin e tyre ne Basenin e Semanit.

Ne rrethin e Gjirokastres shfrytezimi i gelqeroreve me karriera ka filluar qe ne vitin 1995. Gjate periudhes 1996-1998 kane punuar per shfrytezimin e gelqeroreve me karriera,

tete subjekte private (“**Metotrerg**”, “**Janima**”, “**Vladas**”, “**Rreza**”, etj ) te cilat me vone kane nderprere aktivitetin e tyre.

Aktualisht ne rrethin e Gjirokastrës, nga Derviçani deri ne Vrisera, shfrytezohe ne afersi te rruges Gjirokaster-Kakavije, gelqeroret pllakore te Paleocen-Eocenit, nga pese subjekte te licencuare:

Ne afersi te Derviçanit shfrytezojne subjektet “**Laçe Koli**” (16) dhe “**Nacopullo**” (17). Sheshet e shfrytezimit jane te vegjel (0.015 dhe 0.01 km<sup>2</sup>) dhe rezerva te kufizuara (126.765 m<sup>3</sup> dhe 36.780 m<sup>3</sup>)

Me ne juglindje shfrytezojne:

Afer fshatit Frashtan subjekti “**Pirali**” me administrator z. Thoma Piralin (18). Rezervat ketu llogariten 93.000 m<sup>3</sup>

Afer fshatit Grapsh subjekti “**Margariti**” me administrator z. Thanas Margariti (19) rezervat e llogaritura arrijne ne 38.190 m<sup>3</sup>.

Afer fshatit Vodhino shfrytezon subjekti “**Molva**” me administrator z Vangjel Vaso (25). Rezervat e llogaritura 87.980

Te gjithë objektet qe permendem shfrytezohe kryesisht per nxjerrjen e pllakave dhe vetem nje pjese e vogel e prodhimit te tyre perdoret per plotesimin e nevojavë te qytetit per materiale inerte.

Ne rrethin e Sarandes shfrytezimi i gelqeroreve ka filluar qysh nga viti 1998 ( prej subjekteve “**Qiriaz**” dhe “**Kurti**” qe sot e kane mbyllur aktivitetin e tyre. Por gjate viteve 2003-2005 eshte intensifikuar shfrytezimi i gelqeroreve ne kete zone. Aktualisht ne kete rreth shfrytezohe gelqeroret me karriera nga 18 subjekte private te licencuara.

Ne afersi te fshatit Shendre (Mali Aravuno) shfrytezohe gelqeroret e Paleocen - Eocenit nga subjekti “**Kurti**” (21) me administrator Vasil Kurtin. Rezervat e llogaritura arrijne 30,205,172 m<sup>3</sup>.

Subjektet “**Dauti – S**” (22) me administrator z. Fimoleo Dauti dhe “**Boçi**” (23) me administrator z. Shpetim Boçi, shfrytezojne, ne dy sheshe, gelqeroret e Paleocen-Eocenit ne afersi te fshatit Bajkaj. Rezervat e llogaritura jane respektivisht 133,474 m<sup>3</sup> dhe 1,108,600 m<sup>3</sup>.

Ne sektorin Bubac-Nivice, ne gelqeroret eocenike, ne perendim te rruges nacionale Himare-Sarande, jane hapur kater karriera per shfrytezim nga firmat e meposhteme:

Subjekti “**Ikeral**” (24) me administrator z. Jorgo Sapunozhi shfrytezon nje shesh me rezerva 1,920,920 m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Dinamika**” (25) me administrator z. Jani Papajani shfrytezon nje shesh me rezerva 133,474 m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Prella**” (26) me administrator z. Leonard Llambrin ka ne shfrytezim nje shesh me rezerva te llogaritura ne 3,794,750 m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Arti**” (27) me administrator z. Arqile Papuçiu shfrytezon nje shesh me rezerva 921,405 m<sup>3</sup>.

Ne veri te fshatit Çuke subjekti “**Dinamika**” me administrator z Alqi Papajani (28) shfrytezon gelqeroret e Eocenit me nje shesh me rezerva 630,540 m<sup>3</sup>.

Ne sektorin ndermjet fshatrave Vurgu i Ri dhe Sopik gelqeroret e Paleocen-Eocenit shfrytezohe ne karriera nga gjashte firmat subjektet private te me poshtem:

Subjekti “**Shameti**” (29) me administrator z. Flamur Shametin shfrytezon nje shesh me rezerva 7,81,450 m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Stavro Inert**” (30) me administrator z. Llambro Stavron shfrytezon nje shesh me rezerva 877,580 m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Company**” (31) me administrator z. Simon Çipen shfrytezon nje shesh me rezerva 1,711,104 m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Arti**” (32) me administrator z. Arqile Papuçiu shfrytezon nje shesh me rezerva 921,405 m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Alie-B**” (33) me administrator z. Andrea Boçi shfrytezon nje shesh me rezerva 45,600 m<sup>3</sup>.

Subjekti “**Kalivjoti**” (34) me administrator z. Vangjel Kalivjoti shfrytezon nje shesh me rezerva 387,011 m<sup>3</sup>.

Afer fshatit Shkalle, ne te dy anet e rruges per ne Konispol, subjekti “**Zotaj –Z**” (35-36) me administrator z. Zyhdi Zotaj, shfrytezon dy sheshe me rezerva te pergjithshme rreth 412,700 m<sup>3</sup>.

Se fundi, ne afersi te Konispolit shfrytezohen me karriera gelqeroret e Kretakut te Siper nga subjekti “**Frali**” (37) dhe subjekti “**Palushi**” (38) me administrator Merimam Palushi me sheshe me rezerva respektivisht 2,272,149 m<sup>3</sup> dhe 8,092,317 m<sup>3</sup>.

Ne afersi te Leskovikut ne rrethin e Ersekës, afer fshatit Cereke, nga subjekti “**Janimar**” (39) shfrytezohe nje bllok gelqeroresh (olistolit) brenda flishit. Rezervat e llogaritura jane vetem 12,852 m<sup>3</sup>.

Ne basenin e Vjoses krahas subjekteve te licensuara, shfrytezimi i gelqeroreve per gure dhe inerte ne ndertim, behet dhe nga shume persona private, te palicensuar pa perfshire ketu ata individe qe i perdorin per nevoja personale .

Tabelat 18, 19, 20, 21 te shesheve te shfrytezimit me karriera per basenin e Vjoses jepen me poshte te ndara sipas rretheve.



Tabela 18: **Subjektet qe shfrytetojne me kariera shkembinjte karbonate ne rrethin e Vlores**

Nr.Rendori	Rrethi	Emri i subjektit	Emertimi vendburimit	Vendodhja e Objektivit	Nr lejes	Date	Rezervat licensuara m3	Siperfaqja	statusi
1	Vlore	NACIONAL	Drashovice	Afer fshatit Drashovice	594	25.01.2001	8,778,522	0.16	
2	Vlore	SEVAST	Azines	Afer fshatit Drashovice	552		1.200.000	0.025	
3	Vlore	SHUSHICA	Drashovice	Afer fshatit Sherishte	561	19.06.2000	3,517,875	0.057	
4	Vlore	ABDURAMANI shpk	Drashovice	Afer fshatit Drashovice	935	17.04.2006	1,745,500	0.168	
5	Vlore	HYTAL	Kanine	Afer fshatit Kanine	668	18.07.2002	1,594,883	0.065	
6	Vlore	ALBA	Rradhime (Katori)	Afer fshatit Rradhime	534	05.01.2000	2,902,350	0.04	
7	Vlore	ALLIAJ	Rradhime	Afer fshatit Rradhime	396	03.02.1998	281,200	0.022	hequr
8	Vlore	S.I.A.V.Konstruksior	Orikum	Afer Orikumit	467	07.07.1999	2,959,350	0.074	hequr
9	Vlore	COMERCIR	Rradhime	Afer fshatit Rradhime	468	07.07.1999	2,382,096	0.1	hequr
10	Vlore	MEHILLAJ	Dukat i Ri-Orikum	Afer fshatit Dukat I Ri	686	06.01.2003	2,650,000	0.01	
11	Vlore	ALFA	Kodra e Milese, Himare	Afer fshatit Ilias	582	13.11.2000	3,185,175	0.081	
12	Vlore	FLORIDA - FH	Vishe	Afer fshatit Vishe	683	26.11.2002	1,076,873	0.052	
13	Vlore	ZOTO - ZZ	Mali i Kolezes, Himare	Afer fshatit Kudhes	748	19.01.2004	2,150,000	0.29	

Tabela 19: Subjektet qe shfrytezojne me kariera shkembinjte karbonate ne rrethin e Gjirokastrës

Nr.Rendor	Rrethi	Emri subjektit	Emertimi vendburimit	Vendodhja e Objektivit	Nr lejes	Date	Rezervat licensuara m <sup>3</sup>	Njesia	Siperfaqja	statusi
16	Gjirokastrë	LACE KOLI	Perroi I Nikos	Afer fshatit Derviçan	716	28.07.2003	126,765	m <sup>3</sup>	0.015	
17	Gjirokastrë	NACOPOLLO	Derviçan	Afer fshatit Derviçan	772	28.06.2004	36,780	m <sup>3</sup>	0.01	
18	Gjirokastrë	PIRALI	Frashtan	Afer fshatit Frashtan	762	06.04.2004	93,000	m <sup>3</sup>	0.01	
19	Gjirokastrë	MARGARITI	Jergucat	Afer fshatit Grapsh	879	24.06.2005	38,190	m <sup>3</sup>	0.0072	
20	Gjirokastrë	MOLVA	Vodhino	Afer fshatit Vodhino	712	18.07.2003	87,980	m <sup>3</sup>	0.018	
<b>TOTALI</b>							<b>382,715</b>			

Tabela 20: Subjektet qe shfrytezojne me kariera shkembinjte karbonate ne rrethin e Sarandes

nr.	Rrethi	Emri i subjektit	Emertimi vendburimit	Vendodhja e Objektivit	Nr lejes	Date	Lloji Mineralit	Administratori	Rezervat licensuara	Siperfaqja	Lloji i lejes
21	Sarandë	Vellezerit Kurti	Mali Aravuna	Afer fshatit Shendrenj	820	10.10.2004	Gelqeror	Vasil Kurti	30,205,172	0.317	Shfrytezim
22	Sarandë	DAUTI - S	Qafa Breshërit	Afer fshatit Bajkaj	691	06.01.2003	Gelqeror	Fimoleo Dauti	133,474	0.033	Shfrytezim
23	Sarandë	SHPETIM BOÇI	Bajkaj	Afer fshatit Bajkaj	746	29.12.2003	Gelqeror	Shpetim Boçi	1,108,600	0.05	Shfrytezim
24	Sarandë	IKERAL	Volloderi Siperem	Afer fshatit Volloderi I Siperem	698	09.05.2003	Gelqeror	Jorgo Sapunas	1,920,920	0.06	Shfrytezim
25	Sarandë	DINAMIKA	Baxho, Nivice-Bubar	Afer fshatit Nivice	665	05.07.2002	Gelqeror	Jani Papajani	1,961,300	0.076	Shfrytezim
26	Sarandë	PRELLA	Volloderi Siperem	Afer fshatit Volloderi	661	03.07.2002	Gelqeror	Leonard Llambri	3,794,750	0.1	Shfrytezim
27	Sarandë	ARTI	Hamallo	Afer fshatit Nivice	662	03.07.2002	Gelqeror	Arqile Papuçiu	921,405	0.05	Shfrytezim
28	Sarandë	DINAMIKA	Mali	Afer fshatit Çuke	714	24.07.2003	Gelqeror	Alqi Papajani	630,540	0.03	Shfrytezim

Perdorimi i burimeve natyrore te reja per perfitimin e gurit qelqeror per nevojat e sektorit te ndertimit dhe infrastruktures eshte domosdoshmeri he prioritet per ruajtjen e ambientit

			Lekuresit								
29	Sarande	SHAMETI	Blerimas	Afer fshatit Blerimas	855	29.04.2005	Gelqeror	Flamur Shameti	7,812,450	0.193	Shfrytezim
30	Sarande	STAVRO - INERT	Blerimas	Blerimas	857	12.05.2005	Gelqeror	Llambi Stavro	877,580	0.035	Shfrytezim
31	Sarande	JODY KOMPANY	Fteri, Sopik	Afer fshatit Xare	800	22.09.2004	Gelqeror	Simon Çipa	1,711,104	0.12	Shfrytezim
32	Sarande	ARTI	Sorone	Afer fshatit Pllake	563	19.06.2000	Gelqeror	Arqile Papuçiu	27,406,000	0.625	Shfrytezim
33	Sarande	ALIE - B	Qafa e Sorones	Afer fshatit Blerimas	730	16.10.2003	Gelqeror	Andrea Boçi	455,600	0.03	Shfrytezim
34	Sarande	KALIVJOTI	Rreza e Milese	Afer fshatit Sopik	717	28.07.2003	Gelqeror	Vangjel Kalivjoti	387,011	0.048	Shfrytezim
35	Sarande	ZOTAJ - Z	Mali Mallaunes	Afer fshatit Shkalle	731	16.10.2003	Gelqeror	Zyhdi Zotaj	2,532,242	0.135	Shfrytezim
36	Sarande	ZOTAJ - Z	Shkalle	Shkalle	757	31.03.2004	Gelqeror	Zyhdi Zotaj	1,595,140	0.11	Shfrytezim
37	Sarande	FRALI	Konispol	Konispol	919	09.09.2005	Gelqeror	Bilbil Hysenaj	2,272,149	0.245	Shfrytezim
38	Sarande	PALUSHI	Faqja e Gjere Konispol	Afer Konispolit	925	19.01.2006	Gelqeror	Meriman Palushi	8,092,317	0.291	Shfrytezim

Tabela 21: Subjektet qe shfrytezojne me kariera shkembinjte karbonate ne rrethet e Tepelenes dhe Ersekës

Nr rend	Rrethi	Emri subjektit	Emertimi vendburimit	Vendodhja e Objektit	Nr i lejes	Date	Lloji i Mineralit	rrezervat e licensuara m <sup>3</sup>	Siperfaqja	Lloi i lejes
	Leskovik	JANIMAR	Cercke	Afer fshatit Cercke	710	08.07.2003	Gelqeror	12,852	0.047	Shfrytezimi
	Tepelene	Besnik KOÇI	Per zonen Luzat	Afer fshatit Luzat	265	16.04.1996	Gelqeror		0.01	Shfrytezimi
	Tepelene	Vjosa . V & S	Vagalat, Memaliaj	Afer fshatit Vagalat	747	19.01.2004	Gelqeror	39,000	0.012	Shfrytezimi
	Tepelene	BOKA - AXH	Gryka e Gones Toç	Afer fshatit Krahes	799	22.09.2004	Gelqeror	848,145	0.1	Shfrytezimi
	Tepelene	COBIAL	Rrypa e Kuqe Bençe	Afer fshatit Bençe	832	30.12.2004	Gelqeror	197,507	0.0332	Shfrytezimi
<b>TOTALI</b>								<b>1.097.504</b>		

Ne basenin e Vjoses aktualisht shfrytezojne gelqeroret me karriera 39 objekte te licensuara. Nuk mund te japim shifra te sakta per kapacitet aktuale qe shfrytezojne subjektet e ndryshme, mbasi mungojne te dhenat. Sidoqofte duhet te kemi parasysh se sipas disa sondazheve duhet te shfrytezohen rreth 400.000- 450.000 m<sup>3</sup>.

Siç e kemi permendur perveç shfrytezimit te lejuar qe behet prej disa subjekteve, shkembijnjte karbonatike shfrytezohen nga firma private te palicensuara si dhe persona private.

Sasite qe shfrytezohen sot jane te lidhura ngushte me kerkesat e sektorit te ndertimit per inerte e materiale te tjera ndertimi (gelqerore dekorativ, çimento, gelqere etj). Rritja e kapaciteteve te prodhimit eshte problem qe lidhet vetem me kerkesat e tregut dhe qe zgjidhet lehtesisht.

Nga shperndarja e karrierave ne hartën e basenit te Vjoses dhe nga vrojtimet e kryera ne disa prej tyre mund te renditnim keto probleme:

- 1- Ne percaktimi e shesheve per shfrytezim dhe leshimin e lejeve duhet tu kushtohet vemendje shume me e madhe problemeve qe shkaktojne hapjet e karrierave ne demtimin e ambjentit dhe prishjen e bukurive natyrore, sidomos kur behet fjale per zonat turistike te rivieres sone ose te gjeomonumenteve apo monumenteve kulturele. Te ben pershtypje hapja e karrierave ne sektorin bregdetar Dhermi-Himare, Nivice-Bubar, Çuke afer rruges Gjirokaster –Kakavije etj.
- 2- Kujdes i veçante duhet treguar dhe ne pozicionimin e tyre larg qendrave te banuara pasi plasjet e minave sjellin shqetesime per komunitetin e zonave rreth karrierave si p.sh. zhurmat e medha, plasje te mureve te banesave etj.
- 3- shfrytezimi i disa firmave, te vendosura shume afer njera-tjetres, ne zona te kufizuara, do te ishte mire te zevendesohet nga ai i nje firme te fuqishme ose bashikimi te tyre. Kjo do te krijonte mundesi :
  - per nje shfrytezim me te mire te sheshit
  - perdorimi e projekteve teknike me te plota
  - aplikimin e teknologjive bashkekohore
  - monitorim te vazhdueshem nga ana e institucioneve perkatese ne lidhje me zbatimin e projektit.
  - Nje sistem shfrytezimi me rentabel te drejtuar nga personel i kualifikuar.
  - Rehabilitim me te mire mjedisor dhe te sigurte sektoreve te shfrytezuara etj.
4. Duhet te vendosen rregulla dhe penalitete, per mos hapjen e karrierave sipas projekteve teknike, mos respektimin e sistemit te shfrytezimit dhe kushteve teknike, per rehabilitim e sektoreve te shfrytezuara.
5. Organizimi i kontroleve te rrepte prej personelit te kualifikuar, per zbatimin e projekteve per hapjen, shfrytezimin dhe rehabilitimin e ambjentit.
6. Duhet nje bashkepunim institucional ndermjet Ministrise se Ekonomise, Industrise dhe Energjitikes, Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave, dhe Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit, per te nderhyre dhe ne ligjin minerar ekzistues i cili nuk merr shume parasysh mbrojtjen e ambjentit dhe sanksione ndaj demtuesve.
7. Ne dhenien e lejeve per shfrytezim Ministria e Mjedisit duhet te luaje rol ndikues per mbrojtjen e ambjentit sidomos ne zonat turistike e parqet kombetare.

## 7.8 Permbledhje dhe rekomandime

Ne basenin e Vjoses jane ngritur dhe funksionojne prej dhjetra vitesh, disa impiante perpunimi qe shfrytezojne inertet lumore. Shfrytezimi ne pergjithsi eshte perqendruar ne afersi te Vlores, kryesisht ne sektorin Ura e Mifolit- fshati Ada, ku dhe operojne gjashte firma. Ne sektorin e lumit Vjosa, nga Permeti ne Kelcyre, shfrytezimi eshte i vogel si rezultat i kerkesave te vogla por dhe i cilesise jo te mire te inerteve. Arsye tjeter mbetet dhe sasia e kufizuar e rezervave.

Ne sektorin nga Ura e Mifolit ne Poçem, megjithese ndodhen objekte me rezerva te medha dhe cilesi te mire, shfrytezimi dhe perpunimi i inerteve si rezultat i kerkesave te ulta te sektorit te ndertimit ne kete zone, eshte shume i ulet ne krahasim me rezervat potenciale qe ekzistojne. Ne sektorin nga Poçemi deri ne derdhjen e Shushices, shfrytezimi behet vetem nga persona private dhe firma te vogla te palicensuara.

Duke u mbeshtetur ne materilaet e siperpermendura per inertet e shtreterve te lumenjeve dhe objektet e shkembinjve karbonat si alternativ per zevendesimin e tyre mundet te nxjerrim keto perfundime:

- licensimi i firmave per shfrytezimin e inerteve ne disa raste eshte bere pa respektuar kushtet teknike per mbrojtjen e veprave publike dhe ambientit si dhe duke e perfendruar kufizimin ne sektore te kufizuar.
- shfrytezimi shpesh behet pa respektuar projektet teknike dhe sidomos sistemet e shfrytezimit dhe rehabilitimit te ambientit pas shfrytezimit.
- mungon koordinimi institucional per ushtrimin e nje kontrolli te specializuar dhe penalizimin e subjekteve qe shfrytezojne per moszbatim te projekteve sidomos persa i perket ruajtjes se ambientit dhe ekosistemit natyror.
- si rezultat i shfrytezimit intesiv te inerteve ne sektore te kufizuar te shtreterve te lumenjeve (Ura e Mifolit – prane fshatit Ada, mbi dhe nen uren e Peshkepise etj) verehen keto pasoja :
  - demtime te veprave mbrojtese, ne argjinatura
  - demtime te veprave ujites ( si rezultat i uljes se nivelit te lumenjeve)
  - demtime ne shkalle te ndryshme te veprave inxhinierike (urave, etj . ne disa raste nuk eshte respektuar distanca e lejuar nga kembet e ures)
  - ulje e nivelit te ujrave nentokesore dhe pakesimi i furnizimit me uje te fshatrave perreth.
  - Demtimi i bimesise ne shtratin e lumit

Shfrytezimi ne karriera te gelqeroreve siguron vazhdimesi per periudha te gjata kohe ( dhjetra bile dhe qindra vjeçare), por per kete rekomandojme:

Te rritet bashkepunim institucional dhe angazhimi me i madh i Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave ne percaktimin e kritereve per paisjen me leje te shfrytezimit te karriera te karbonateve duke nxjerre ne plan te pare ruajtjen e ambientit dhe bukurive natyrore sidomos ne zonat turistike dhe parqet kombetare.

Shfrytezimi i nje sektori te kufizuar nga disa subjekte, (3-4) nuk ndihmon ne ruajtjen e ambientit, nuk eshte rentabel dhe pengon futjen e teknikave dhe teknologjive bashkekohore si dhe te nje personeli teknik te kualifikuar, per shfrytezimin e gelqeroreve.

Duhet nje bashkepunim institucional per kontroll rigoroz, nga nje personel i kualifikuar, i zbatimit te projekteve teknike sidomos per hapjen , shfrytezimin dhe rehabilitimin e sektoreve te shfrytezuar

]

## **Kapitulli i VIII**

### **BASENI I SEMANIT**

## 8.1 Karakteristikat gjeografike dhe gjeomorfologjike te lumenjve te Basenit

Baseni i Semanit eshte baseni me i madh persa i perket siperfaqes.

Semani eshte nje nder lumenjte e medhenj te vendit tone, me nje gjatesi prej 281 km. dhe nje pellg ujembledhes me siperfaqe 5649 km<sup>2</sup>. Ai rrjedh nga bashkimi i Devollit me Osumin. Lartesia mesatare mbi nivelin e detit eshte 863 m., gje qe flet per nje pellg ujembledhes me karakter thellesisht malor. Pjerresia e shtratit eshte 3.6 %

.Osumi ka nje gjatesi prej 161 km. dhe siperfaqe pellgu 2150 km<sup>2</sup>. Ai buron nga lartesite e malit te Rungajes dhe pasi kalon ne nje teren te thyer malor, hyn ne gropen e Kolonjes ku fuqizon prurjen e tij me perrenj te shumte qe rjedhin nga mali i Gramozit. Ne afersi te Kozares bashkohet me Devollin, icili perben dhe degen kryesore te Semanit. Buron nga ana juglindore e maleve te Moraves. Ka gjatesi 196 km. dhe siperfaqe pellgu 3130 km<sup>2</sup>. Pasi pershkon pjesen jugore te maleve te Moraves, ai hyn ne luginen e Devollit te siperm dhe me pas ne fushen e Korçes. Nga Maliqi deri ne Kokel, ai çan terthor kurrize malore ku formon gryka e kanione te shumta. Ne pjesen e poshteme lumi zgjerohet dhe merr karakter fushor. Pas bashkimit me Osumin, lumi rrjedh ne Ultesiren Bregdetare si nje lume tipit fushor me shtrat te gjere e meandrimet e shumta.



### *Pamje e pergjithshme satelitore e lumit te Semanit*

Rreth 21 % e pellgut ujembledhes te Semanit perbehet nga formacione te pershkueshme, 51 % gjysem te pershkueshme dhe pjesa tjeter prej 28 % nga formacione te papershkueshme. Dendesia e rrjetit uhor eshte 1.91 km/km<sup>2</sup> me rreth 600-2000 mm rreshje ne vit, ku 80 % e tyre bie ne periudhen e lagesht. Rreth 30% e siperfaqes se pellgut ujembledhes eshte e mbuluar me pyje. Prurja mesatare shume vjeçare e lumit Seman eshte 95.7 m<sup>3</sup>/s, koefiçienti i rjedhjes eshte 0.49 (Devolli 0.47 dhe Osumi 0.45), ndersa moduli i rjedhes 17 l/s/km<sup>2</sup>. Keto vlera te ulta percaktohen nga sasia e paket e rreshjeve dhe formacionet terigjene. Semani eshte nder lumenjte me errozive te vendit

tone, turbullira e ujit arrin ne Mbrostar  $4390 \text{ gr/m}^3$ , Devolli ne Kozare  $5500 \text{ gr/m}^3$ , Osumi tek Ura Vajgurore  $3510 \text{ gr/m}^3$ .

Ujrat e Semanit kane mineralizim mesatar  $200-500 \text{ mg/l}$  dhe ne pergjithesi jane bikarbonate. Vlerat me te vogla te ketij mineralizimi ne pjesen e poshteme vihen re ne muajin Mars,  $33 \text{ mg/l}$ , ndersa me te lartat ne Gusht  $440 \text{ mg/l}$ . Ne pjesen e sipërme te Osumit dhe Devollit mineralizimi mesatar i ujit eshte i vogel rreth  $300 \text{ mmg/l}$  ndersa temperatura e ujit lekundet nga  $2-7^\circ\text{C}$  ne Janar deri ne  $16-25^\circ\text{C}$  ne Gusht. Tokat me te perhapura ne te dyja luginat, jane ato livadhore, te kafejta livadhore, aluvionale, te hinjta kafe dhe livadhore aluvionale. Pellgu paraqitet mjaft i populluar per shkak te resurseve natyrore qe ai ofron.

**Lugina e Semanit.** Gjeomorfologjia e shtratit te Semanit eshte e thjeshte ne krahasim me lumenjte e tjere. Ne aspektin gjeomorfologjik shtrati i Semanit ndahet ne dy pjese:

Nga Kozara deri ne fshatin Seman gjeomorfologjia karakterizohet nga forma e shtratit te sotem te lumit ku sistemi i rjedhes ujore eshte i tipit mandriforme. Ne te dy krahet e shtratit, fusha aluviale perbehet nga sedimente argjilore e ranorike. Vetem ne ekstremet e meandrave te medha midis Kuçit e Fier-Sheganit dhe Sheqit e Mbrostarit lumi nderpret formacionet rrenjesore mollasike te Neogenit duke marre pamjen e grykave te buta kodrinore.

Pjesa e dyte i takon litoralit ku kemi gjeomorfologjine e deltes dhe te ambjenteve te tjera te sedimentimit. Delta eshte e tipit ndertues. Verehen te pranishme depozitimet e reres te shprehura me dunat e reres, depozitimet kenetore, te plazhit dhe detare. Si rezultat i pranise se dunave te reres per gjate bregut, lumi shpesh ka nderruar shtrat. Sedimentet kenetore organike i japin shtratit ngjyre te zeze. Aspekte te tjera gjeomorfologjike te veprimtarise lumore dhe modelimit te relievit prej saj, me te plota evidentohen ne deget kryesore te Semanit, ne Devoll dhe Osum.

**Lugina e Devollit** - Per qellimin e studimit do te pershkruajme shkurt vetem rjedhen e mesme dhe te poshteme te lumit te Devollit.

**Rjedha e mesme.** - Fillon nga Maliqi e deri ne grykederdhjen e Tomorrices. Eshte nder luginat me te medha terthore te vendit tone me gjatesi  $50 \text{ km}$ . Deri ne perendim te Lozhanit lugina zhvillohet ne molasa dhe ka formen "V". Eshte lugine obsekuente me pragje te shumta. Deri ne Gur-Shqipe lugina nderpret ultrabazike prandaj paraqitet e ngushte ne formen e nje gryke. Ne zonen e Moglices lugina kalon ne flishe te paqendrueshme me aktivitet te fuqishem te proceseve erozivo-denuduese. Ne masivin e Devollit lugina merr trajte kanioni me shpate shume te pjerret. Me pas hyn ne sinklinalin e Gramshit dhe zhvillohet ne shtrirje te tij. Dallohen deri pese nivele taracash lumore te tipit erozivo-akumulues dhe asimetrike. Rrjeti i lugines perbehet nga lumi i Devollit dhe perrenjte e Strelces, Zvarrishtit, Çermerices etj.

**Rjedha e poshteme** - Kjo lugine zgjatet nga grykederdhja e Tomorrices deri ne Kozare. Ka gjatesi  $35 \text{ km}$ . dhe gjeresi nga  $0.8$  deri ne  $3-4 \text{ km}$ . Kjo lugine formohet ne strukturat sinklinaline te Gramshit dhe ate te Linasit. Shtrihet ne lartesi nga  $60-70 \text{ m}$ . deri ne  $200-400 \text{ m}$ . Duke u nisur nga gjeneza dhe gjeomorfologjia lugina ndahet ne dy pjese. Tomorrice-Gostime dhe Gostime-Kozare.

